

Më në fund kultura shqiptare ka “librin e librave” të saj: *Bibliografinë Retrospektive të Librit Shqip* në dy pjesët e para, 1555-1912 (I) dhe 1913-1944 (II). Më bie detyra të pohoj me bindje se është fjala për një botim që përbën ngjarje historike. Në çdo kulturë flitet dendur për “ngjarje” në rastin e botimit të librave, pa qenë të sigurtë se sa jetëgjatë do të jenë ata, nga njëra anë, si edhe sa të shumëpritur mund të kenë qenë, nga tjetra. Ndërkaq botimi i *Bibliografisë Retrospektive të Librit Shqip* përbën një arritje të lakmuar ndoshta qysh këtu e 90 vite të shkuara, kur qeveria e ardhur në Tiranën kryeqytet nga Kongresi i Lushnjës mernte vendimin për themelimin e një “biblioteke kombëtare” në Shqipëri. E pamundur do të ketë qenë që ideatorët e institucionit në fjalë të mos kenë ëndërruar që shqiptarët të kenë një ditë për duarsh edhe regjistrimin e gjithçkaje që ishte shkruar e botuar deri më atëherë në gjuhën shqipe, nga Buzuku deri tek ata, në atë vit të largët 1920.

Aurel PLASARI

ISBN 978-99927-731-7-8



9 789992 177317

RAMAZAN VOZGA

BIBLIOTEKA KOMBËTARE

RAMAZAN VOZGA

LIBRI SHQIP 1555-1912

në fondet e Bibliotekës Kombëtare

BIBLIOGRAFI

Në kopertinë: Rrota e librit, sipas Agostino Ramelli-it, 1588

LIBRI SHQIP 1555-1912
BIBLIOGRAFI



BIBLIOTEKA
KOMBËTARE

BIBLIOTEKA KOMBËTARE

RAMAZAN VOZGA



LIBRI SHQIP

1555-1912

në fondet e Bibliotekës Kombëtare



BIBLIOGRAFI



Tiranë, 2010

*Në 90-vjetorin e Bibliotekës Kombëtare
nën kujdesin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
z. Ferdinand Xhaferaj*

REDAKSIA:

Aurel PLASARI (kryetar)
Afërdita SHARXHI
Etleva DOMI
Maksim GJINAJ
Nasho JORGAQI
Sherif DELVINA

© Biblioteka Kombëtare

ISBN: 978-99927-731-7-8

LIBRI SHQIP
1555-1912

në fondet e Bibliotekës Kombëtare

Shtypur në shtypshkronjën e Shtëpisë Botuese Onufri
Rr. "S. Pasha", Tiranë, Tel & Fax 00355 4 220 017
<http://www.Onufri.com>
E-mail: onufri@abissnet.com.al

PËRMBAJTJA

<i>Parathënie për këtë botim</i>	11
<i>Mbi bibliografitë dhe mbi këtë bibliografi</i>	17
Viti 1555	65
“ 1592	69
“ 1618	72
“ 1621	73
“ 1635	75
“ 1636	77
“ 1664	77
“ 1685	78
“ 1691	79
“ 1706	81
“ 1731	82
“ 1741	83
“ 1742	83
“ 1743	86
“ 1744	86
“ 1750	87
“ 1760	87
“ 1762	88
“ 1802	89
“ 1824	90
“ 1827	91
“ 1836	94

“ 1844	94
“ 1845	95
“ 1847	96
“ 1848	97
“ 1855	97
“ 1856	103
“ 1858	104
“ 1862	105
“ 1863	106
“ 1864	107
“ 1866	108
“ 1867	110
“ 1868	111
“ 1869	113
“ 1870	115
“ 1871	117
“ 1872	118
“ 1873	123
“ 1875	125
“ 1876	126
“ 1877	127
“ 1878	129
“ 1879	131
“ 1880	134
“ 1881	135
“ 1882	138
“ 1883	141
“ 1884	142
“ 1886	145
“ 1887	152
“ 1888	157
“ 1889	161
“ 1890	165
“ 1891	166
“ 1892	166
“ 1893	169
“ 1894	170
“ 1895	172
“ 1896	175

“ 1897	181
“ 1898	184
“ 1899	193
“ 1900	198
“ 1901	202
“ 1902	208
“ 1903	216
“ 1904	218
“ 1905	224
“ 1906	227
“ 1907	234
“ 1908	243
“ 1909	252
“ 1910	265
“ 1911	280
“ 1912	298
Pa vit botimi	325

Informacion bibliografik për tituj që nuk gjenden në koleksionet e Bibliotekës Kombëtare 333

Bibliografi 339

Tregues 347

Treguesi i autorëve 349

Treguesi i titujve 357

Treguesi lëndor 371

Treguesi i botuesve, tipografëve, libërshitësve, shtypshkronjave etj. .375

Vula, etiketa (ex-libris) etj. 381

PARATHËNIE PËR KËTË BOTIM

Më në fund kultura shqiptare ka “librin e librave” të saj: *Bibliografinë Retrospektive të Librit Shqip* në dy pjesët e para, 1555-1912 (I) dhe 1913-1944 (II). Më bie detyra të pohoj me bindje se është fjala për një botim që përbën ngjarje historike. Në çdo kulturë flitet dendur për “ngjarje” në rastin e botimit të librave, pa qenë të sigurtë se sa jetëgjatë do të jenë ata, nga njëra anë, si edhe sa të shumëpritur mund të kenë qenë, nga tjetra. Ndërkaq botimi i *Bibliografisë Retrospektive të Librit Shqip* përbën një arritje të lakmuar ndoshta qysh këtu e 90 vite të shkuara, kur qeveria e ardhur në Tiranën kryeqytet nga Kongresi i Lushnjës morri vendimin për themelimin e një “biblioteke kombëtare” në Shqipëri. E pamundur do të ketë qenë që ideatorët e institucionit në fjalë të mos kenë ëndërruar që shqiptarët të kenë një ditë për duarsh edhe regjistrimin e gjithçkaje që ishte shkruar e botuar deri më atëherë në gjuhën shqipe, nga Buzuku deri tek ata, në atë vit të largët 1920.

“Nuk mund të ketë *bibliotekë kombëtare* pa *bibliografi kombëtare*”: mbaj mend t’ua kem kujtuar këtë të vërtetë bashkëpunëtorëve të mi, këtu e vite të shkuara, kur fillova punën për të drejtuar Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë së toku me ta. Para se librat të përdoren dhe/ose të studiohen, duhet të dihet që ata ekzistojnë: ky është parimi lëvizës që shërben si shtysë në hartimin e çdo bibliografie. Dhe ata që e njohin mirë e bukur këtë parim janë pikërisht punonjësit e bibliotekave, - të çdo biblioteke me funksion publik, - sepse ato krijohen për t’u shërbyer nevojave të grupeve më shumë se atyre të një individi. Punonjësve të bibliotekave, dhe jo “mendjes njerëzore” në përgjithësi, u njihet në historinë e qytetërimit merita e shpikjes së mjetit universal për realizimin e këtij informacioni, që është *bibliografia*.

Afërmendsh: orvatjet për një *Bibliografi Retrospektive të Librit Shqip* kanë pasë nisur prej vitesh në Bibliotekën Kombëtare, e cila prej më se 50 vjetësh harton dhe boton *Bibliografinë Kombëtare të Librit Shqip*, d.m.th. atë të botimeve korrente. Se si dhe se pse ajo gjithnjë nuk përfundohej për t’ua ofruar përdoruesve,

përbën histori më vete: vështirësitë e kuptueshme të kohëve, të regjimeve tanimë të lëna mbrapa, të kushteve në përgjithësi, përfshirë pengime e shtrëngime etj., ngjajnë jashtë vendi për t'u kujtuar tani kur ajo quhet e kryer. Megjithatë ndër vështirësitë “objektive” dëshiroj të përmend dy: 1) Bibliografia, si disiplinë më vete e shkencës së librit, është njëherësh *art* dhe *shkencë*; si e tillë ajo parakupton një bazë dijesh dhe aftësi interpretuese nga ana e bibliografëve: janë kushte që nuk e bëjnë të lehtë hartimin e bibliografive dhe jo dokushdo “specialist” mund t’ia dalë mbanë kryerjes së tyre; 2) “Librat për librat” janë të kushtueshëm nga pikëpamja e investimit intelektual, shkencor dhe kohor, përkatësisht edhe financiar, duke qenë njëherësh ky investim që i bën ata bartës vlerash të paçmueshme.

Për kulturën shqiptare duhet quajtur fat i lumë fakti që pjesa zotëruese e botimeve shqipe, prej Buzukut unikal – të riprodhuar nga At Justin Rrota – dhe deri te ne, janë mbledhur dhe ruajtur në koleksionet e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, sikurse vijojnë të mbledhen e të ruhen: me sa rezultojnë prej dy pjesëve të para të *Bibliografisë* në fjalë, ato mund të llogariten përafërsisht në 95 % të totalit të tyre historik. E famshmja *British Library* dhe po aq e famshmja *Bibliothèque nationale de France* mund të konkurrojnë në epokën e sotme të globalizmit me koleksionet e tyre: nga 14 në 15 milionë libra. Kultura shqiptare i detyron mirënjohje Bibliotekës Kombëtare të saj për koleksionet unikalë të *Librit Shqip*. Këto koleksione kanë mundësuar përfundimin e këtyre dy pjesëve të saj. Dhe pikërisht falë tyre përdoruesve të saj tanimë u ofrohet një informacion pothuajse pranë maksimales: është fjala për një informacion i cili, përtej *bibliografisë*, do t’i qasë ata tek ai realitet ende i veshur me vagullti shekullore që është *historia* e Librit Shqip: qysh nga botimet më të hershme të tij, në Romë a në Venedik, në Padovë a në Milano, në Trieste e në Korfuz, në Athinë e në Stamboll, në Selanik e në Aleksandri, në Bukuresht e në Sarajevë, në Sofje e në Beograd, sa edhe në Paris e në Londër, në Vjenë e deri në Boston, derisa të vijë moti e të shfaqen në frontespacet e tyre qytetet tona, nga Voskopoja në Shkodër, nga Manastiri në Korçë, nga Elbasani në Kostur, kështu me radhë. Një yllësi e tërë karakteresh të alfabeve që mendja pjellore e shqiptarëve prodhoi përgjatë shekujsh do t’ia marrin sytë në *historinë* që tejkulet mbrapa kësaj *bibliografie*: “shenja epirote”, “shenja zodiakale”, alfabet latin me elemente greke, alfabet latino-italian, elemente glagolitike e cirilike, shenjat mbi të zëshmet, diakritike mbi ose nën shkronjat nistore, alfabet arab, “alfabet elbasanas”, këndeje alfabeti i “Agimit”, andej alfabeti i “Bashkimit”, një tjetër i Stambollit, deri edhe një i zotërisë së tij Faik bej Konica etj.

Pa u kaluar anash vlerave të veçanta që bart pjesa e dytë e kësaj *Bibliografie*, fryt i punës shumëvjeçare të atij që e kam quajtur “kryebibliograf” i sotëm shqiptar, z. Maksim Gjinaj, dhe kolegeve të tij znj. Margarita Mele e znj. Myrvete Elmazi, le të lejohem të nënvizoj rëndësinë e posaçme të pjesës së parë të saj, fryt gjithashtu i një pune shumëvjeçare të z. Ramazan Vozga. Përdoruesve të kësaj

Bibliografie u rekomandoj, me këtë rast, edhe punimin e tij në formë hyrjeje *Mbi bibliografitë dhe mbi këtë bibliografi*, dëshmi që specialisti i shkencës së librit nuk i ka ikur dot detyrës së mësimdhënësit të lëndës *Historia e Librit* për të na ofruar një informacion përplotësues që, përndryshe, zor se do ta kishim për duarsh.

Meritë të meritave, që ndoshta “përdoruesi masiv” nuk do të vërë re, por që mund ta dallojë çdo specialist i shkencës së librit, konsideroj zbatimin në këtë *Bibliografi*, rastin e botimeve që përfshin ndërkoha historike e librit shqip 1555-1912, të standardeve dhe rregullave përkatëse ndërkombëtare të katalogimit: konkretisht standardet e përshkrimit bibliografik ISBD (*International Standard Bibliographic Description*) dhe rregullat anglo-amerikane të katalogimit AACR2 (*Anglo-American Cataloguing Rules, 2nd Edition*). Sikurse e sqaron edhe autori i saj, kjo është e para bibliografi shqiptare e hartuar duke mbajtur parasysh edhe “Standardin Ndërkombëtar të Përshkrimit Bibliografik për Botimet e Vjetra Monografike” ISBD(A) (*International Standard Bibliographic Description for Older Monographic Publications*) me përshtatjet e nevojshme për rastin e librit shqip. Mund të vihet re se si një bazë e tillë ka qenë siguria e suksesit për një sërë zgjidhjesh racionale të disa çështjeve që, në historinë e bibliografisë së librit shqip, kanë përbërë “probleme bibliografike të hapura”, ndërsa tanimë mund të quhen “të mbyllura”. Në këtë kuptim interes të posaçëm do të paraqesë për përdoruesit zona e shënimeve ose ajo që autori e quan bukur “sheshi i mejdanit”. Po përzgjedh dy shembuj ilustrues:

a. Në rastin e botimit të veprës së Lekë Matrëngës, *Embsuame e chræsteræ*, Romë 1592, autori i *Bibliografisë* provon dhe mbështet në pikëpamje bibliografike kritikën e studiuesit Selman Riza ndaj tekstit *Histori e Letërsisë Shqipe* (1959 dhe 1983) dhe konkretisht pohimin që në këtë katekizëm “gjejmë edhe të parën vjershë që njohim shqip...”, çfarë bibliografit, nga këqyrja e ekzemplarit të BKSh të riprodhuar nga origjinali i librit nuk i rezultojnë i vërtetë: poezia në fjalë nuk gjendet në variantin e dorëshkrimit prej nga është bërë shtypja, por në një variant tjetër të tij, që ka mbetur i pabotuar; bibliografi ka pasur mundësinë të ndjekë edhe odisenë e botimit, humbjes, gjetjes, rihumbjes, rigjetjes e kështu me radhë e këtij libri: odise, me gjasë, e pashoqe në historinë e librit shqip.

b. Në rastin e veprës *Noctes pelagicae*, Athinë 1855, të albanologut Karl Reinhold, trajtohet gjerësisht problemi i shtojcave të litografuara, që ka pasë tërhequr me kohë vëmendjen e studiuesve të ndryshëm si “çështje e bibliografisë shqiptare” (Carlo Tagliavini etj.). Shtojcat në fjalë nuk pasqyrohen te *Bibliografia* e Legrandit, ndërsa tek ato të Manek-Pekmezit dhe të Lumo Skendos po. Konstatohet që studiuesit nuk kanë pasur informacion për ekzistimin në koleksionet e Bibliotekës Kombëtare të këtyre shtojcave. Gjatë punës për përgatitjen e ekspozitës “Autorë gjermanishtshkrues për Shqipërinë”, organizuar në këtë Bibliotekë në tetor të vitit 2007, pata rastin t’i identifikoj këto shtojca në koleksionet e saj: ekzistimi i tyre nuk ishte evidentuar nga një lajthitje ose pakujdesi në përshkrimin bibliografik

të tyre, mbase që nga hyrja e tyre në koleksionet e BKSh. Nën ekzemplarin Ar 54 E 30 të ekspozuar u vendos atëherë skeda e ideuar prej meje si më poshtë: “Shtesa e bërë nga autori më 1856 botimit të vitit 1855. Dorëshkrim i litografuar”. Edhe ky evidentim, për një pakujdesi të re, vijoi të mos pasqyrohej në skedarët përkatës deri në çastin kur ekzemplari në fjalë i *Noctes pelagicae*... u shqyrtua me vëmendje kur i erdhi radha për t’u regjistruar si pjesë e koleksioneve të BKSh në këtë *Bibliografi*.

Përdoruesit profesionistë të kësaj *Bibliografie* nuk do të humbasin rastin të dallojnë edhe “qëndrimet elastike” të autorit, të domosdoshme në një vepër të këtillë. Një shembull: në identifikimin e autorit të librit *Hija e Skanderbeut, Mretit Scypnies* (Elbasan 1907), që paraqitet me pseudonimin *Banucs Scpataraku*, autori respekton mendimin e studiuesve K. Bevapi dhe A. Ballhysa, simbas të cilëve kjo vepër është e Lef Nosit dhe e dhëna për vendin e botimit/shtypjes është *fals* (për ta Shkodra), por vëren edhe se “duke patur parasysh që vepra është shkruar në të folmen e Shkodrës dhe me alfabetin e shoqërisë “Agimi” të Mjedës, më duhet të shtoj si hollësi që mund të ndihmojë për identifikimin e mëtejshëm të emrit të autorit të këtij botimi faktin që në qytetin e Shkodrës ka familje ortodokse me mbiemrin Shpataraku”. Për të rënë në sy janë edhe rastet kur autori i shmanget me “mirësjellje bibliografike” përfshirjes në debate për probleme të ndryshme që, me gjasë, lidhen më shumë me *historinë* e librit shqip se sa me *bibliografinë* e tij.

Ndërkaq ky farë “elasticiteti” nuk e ka penguar autorin tonë, kur rasti e ka lypur, të hyjë edhe në polemika, si në rastin e veprës së albanologëve Armin Hetzer dhe Viorel S. Roman. Vepra e tyre *Albanien, Ein bibliographischer Forschungsbericht Mit Titelübersetzungen Standortnachweisen* (München 1983) është një bibliografi e standardeve të larta, e hartuar në Bibliotekën e Universitetit të Bremenit me mëtimin që të paraqesë “punën më gjithëpërfshirëse të llojit të vet në formë libri mbi Shqipërinë”. Ajo mbulon tri ndarje të tëra të dijes: filozofinë, ligjin dhe qeverisjen, studimet sociale. Mes të tjerash ka në të edhe një listë të pasur botimesh të bibliografisë shqiptare. Por autori ynë ka ta drejtë kur konstaton që prof. dr. Klaus-Detlev Grothusen, duke dashur të argumentojë që kjo vepër “paraqet me shkallën e lartë të trajtimit një punë pioniere”, në shënimin hyrës të botimit ekzagjeron kur shkruan se në Shqipëri kërkimi bibliografik “është i munguar në mënyrë të frikshme”. Siç del nga vetë lista e hartuar prej autorëve Hetzer & Roman, por edhe nga sfondi historik i paraqitur në hyrjen e këtushme *Mbi bibliografitë dhe mbi këtë bibliografi*, pohimi i profesor-doktorit gjerman në këtë rast nuk i përgjigjet të vërtetës. Dhe detyrohesh t’i japësh të drejtë autorit tonë: vetë albanologët e huaj në pjesën hyrëse të zërit *Burime* kanë pohuar se “po të kemi parasysh madhësinë e vendit dhe fatin e tij politik, ka (...) një numër të konsiderueshëm studimesh pararendëse që mund të listohen” dhe veçojnë përveç veprave bibliografike të Legrand-Gûys dhe Manek-Pekmezi-Stotz edhe atë të Shuteriqit, *Shkrimet shqipe ... 1976*” etj. Bibliografët e Bibliotekës Kombëtare të

Shqipërisë janë në të drejtën e tyre të vënë në dukje që, kur pohohej e pavërteta e mësipërme prej prof. dr. Grothusen-it, në Shqipëri kishte gati 25 vjet që hartohej dhe botohej *Bibliografia Kombëtare e Librit Shqip*, sikurse ishte botuar edhe *Albanica I* (1965), të dyja vepra madhore të punuara sipas rregullave dhe standardeve të kohës të përshkrimit bibliografik.

Një autori të tillë, si ky yni, do t’ia pranojmë me kërshtëri edhe shprehjet “emocionale”, por me peshën e vet në përshkrimin e vlerave estetike të do librave “të përveçëm”. Ja vetëm njëri nga rastet që kam qëmtuar: “Ndoc Nikaj, *Blëta e ree nner lulë t’parrixit*, Shkodër 1904. Ar 23 G 142 ekzemplar me vlera bibliofilike të veçanta: lidhje speciale me cohë të kadifenjtë në ngjyrë si të myshkut, zbukuruar me metal të çmuar dhe me një mbërtheckë po të tillë, paçka se e dëmtuar, si dhe me buzinat të lyera me ngjyrë bojë gjake” etj. Ta falënderojmë autorin deri edhe për këto përimiti informuese në botën e madhe e të stërndërlkuar të informacionit bashkëkohor.

Duke ua lënë tani për duarsh përdoruesve - *sic dissonantia* - këtë botim historik nuk mbetet veçse t’u urohet me formulën e vjetër tradicionale: “E punofshi gëzuar”!

Dr. Aurel Plasari

MBI BIBLIOGRAFITË DHE MBI KËTË BIBLIOGRAFI

Bibliografia “Libri shqip 1555-1912 në fondet e Bibliotekës Kombëtare” është pjesa e parë, ndër tri të planifikuara, për periudhën nga fillimet e librit shqip (1555) deri në pikëtakimin me botimin e institucionalizuar të bibliografisë kombëtare të tij (1959). Ajo mbulon një periudhë prej rreth 5 shekujsh të fjalës së shtypur shqipe dhe vjen të plotësojë një kërkesë të kahershme në një fushë të rëndësishme si ajo e informacionit bibliografik, por edhe në historinë e librit shqip. Është menduar t’u shërbejë, në radhë të parë, lexuesve që do të kenë më shumë se një interes të rastit në shkencat që flasin për trashëgiminë historike, kulturore, letrare etj., sidomos atyre që interesohen posaçërisht për dije në fushat e cituara. Pavarësisht kësaj, kjo bibliografi do mund të shfrytëzohet edhe nga një rreth më i gjerë lexuesish, të cilët, për ta përdorur me përfitim sa më të plotë, do të duhej të kishin paraprakisht njohuri në këto fusha. Janë bërë përpjekje që botimi të dalë sa më i dobishëm, por edhe sa më tërheqës, sidomos me informacionin e përfshirë në zonën e shënimeve të një numri relativisht të madh regjistrimesh bibliografike. Shpresohet që të mirëpritet nga lexuesit dhe bibliotekat sidomos për faktin se është unik në objektin që mbulon.

Fillimi relativisht vonë i veprimtarisë së organizuar bibliografike në vendin tonë ka diktuar nevojën e përgatitjes së bibliografive retrospektive me qëllim mbushjen e zbraztave dhe zonave gri, sidomos për librin shqip të periudhave të hershme të zhvillimit të tij. Mund të thuhet se tashmë në Shqipëri ka një traditë në përgatitjen e bibliografive të librit bazuar në parime profesionale bashkëkohore dhe të përditësuara, çfarë sigurisht përbën një mbështetje edhe për hartimin e bibliografive retrospektive, pavarësisht specifikave dhe delikatesës së tyre.

Qëllimi kryesor i bibliografisë retrospektive shqiptare në stadin e saj të sotëm është krijimi dhe qarkullimi i informacionit bibliografik të munguar. Projekti madhor i përpilimit të Bibliografisë Retrospektive të Librit Shqip -

BRLSh (1555-1958) zë fill me hartimin e platformës përkatëse në vitin 1988 nga një grup specialistësh të Bibliotekës Kombëtare (BK) dhe është strukturuar në tri pjesë: e para përfshin librin e periudhës 1555-1912, e dyta atë të 1913-1944 dhe e treta librin e 1945-1958. Ka qenë sigurisht një sipërmarrje përtej të zakonshmes për nga sasia e madhe e të dhënave që do të përpunoheshin, kompleksiteti i problemeve dhe përballjeve në planin bibliografik, vështirësia e bashkërendimit në formësimin e materialit dhe e trajtimit tekniko-organizativ dhe, jo më pak e rëndësishmja, sigurimi i mjeteve financiare të botimit. Por një bibliografi retrospektive ka qenë e pamundur të realizohej gjatë periudhës moniste edhe për shkak të autorëve “të padëshiruar” që do të duhej të pasqyroheshin dhe të cilët nuk ishin “pakica”. Edhe kur u vendos të punohej për hartimin e saj, në platformën e mësipërme ishte parashikuar që, për shkak të “qëndrimeve komplekse dhe reaksionare” të një numri autorësh, përkthyesish, redaktorësh etj., të bëheshin dy botime bibliografike: “një botim i plotë për përdorim të brendshëm dhe një i përpunuar për përdorim të lirë”¹.

Më në fund, pas më se dy dekadash pune të vështirë, pse jo edhe të mundimshme, por të pandërprerë, korpusi i bibliografisë retrospektive është gati të botohet. Me plot gojën mund të thuhet se ky nuk është thjesht një sukses i bibliografisë shqiptare, por, mbi të gjitha, një kontribut i ndjeshëm i Bibliotekës Kombëtare në shkencën dhe kulturën tonë.

Në të vërtetë ky korpus retrospektiv është një bibliografi kombëtare, e cila, siç dihet, është më e rëndësishmja e të gjitha llojeve të bibliografive, si element i domosdoshëm i sistemit të informacionit të një vendi. Bibliografitë kombëtare retrospektive që lidhen me prodhimin libror të një vendi a populli kanë të bëjnë me përgatitjen dhe menaxhimin e informacionit bibliografik universal të të gjitha dokumenteve të krijuara në procesin e zhvillimit historik të tij, pra vënien e tij në dispozicion të përdoruesve të mundshëm. Regjistrimi i dokumenteve bibliotekare në këto lloj bibliografish organizohet sipas kriteresh të ndryshme: vend ose territor, gjuhë etj. dhe kombinime të tyre (kriteret komplekse) në varësi të historisë së çdo vendi dhe populli të veçantë, por edhe të traditës dhe trashëgimisë së veprave bibliografike. Kësisoj, për librin shqip të 1555-1912 disa postulate të teorisë dhe praktikës së regjistrimit bibliografik retrospektiv amtar janë modifikuar. Për një vend si Shqipëria (me historinë e saj të ndërlikuar, kufijtë e ndryshuar dhe lidhjet e ngushta me trojet fqinje) kriteret *territor* dhe *gjuhë* kanë të njëjtën vlerë në regjistrimet e bibliografisë

¹ Mbi “*Bibliografinë Kombëtare Retrospektive të librit shqiptar 1555-1958*”, 12. 10. 1988 (dorëshkrim), f. 9.

retrospektive, ndaj edhe janë ndërthurur në mënyrë elastike në sistemin, të themi, global të kësaj bibliografie dhe në të gjitha elementet e saj të veçanta.

Libri shqip në fillimet e veta u përfshi në përpjekjet për ruajtjen e identitetit arbëror të kërcënuar nga invazioni osman dhe islamizimi, ndërsa në shek. XIX, krahu për krahu me shkollën shqipe, luajti rol të jashtëzakonshëm për zgjimin dhe emancipimin e popullit shqiptar, për rizgjimin e tij kombëtar, kulturor dhe shpirtëror. Kësisoj: përpunimi i informacionit bibliografik për koleksionet e tij në BKSh në këtë sipërmarrje tejte të rëndësishme në rrafsh kombëtar dhe kulturor pritet të rezultojë i dobishëm për bibliotekarët dhe studiuesit.

*

Objekt i punës bibliografike në këtë projekt ka qenë përshkrimi i librave, broshurave dhe çdo lloj shtypshkrimi tjetër në shqip (përfshirë përkthimet) dhe në çdo gjuhë tjetër botuar ose shtypur në trojet shqiptare, si edhe i librave shqip botuar jashtë këtyre trojeve para vitit 1959. Kjo vepër bibliografike demonstroi pasurinë e koleksioneve të librit shqip të kësaj periudhe në Bibliotekën Kombëtare, pjesë e trashëgimisë historike dhe kulturore të popullit shqiptar. Ajo synon kështu të lidhë informacionin bibliografik të munguar për këto koleksione me bibliografitë kombëtare standarde tashmë të botuara.

Përgjegjësia e hartimit dhe organizimit të të dhënave bibliografike të librit shqip të botuar në periudha të së kaluarës ka kërkuar gjetjen e rrugëve sa më të përshtatshme në mënyrë që studiuesit dhe lexuesit në përgjithësi të kenë qasje sa më të frytshme dhe sa më të lehtë në to. Për përgatitjen e pjesës I të kësaj bibliografie është dashur një ngjitje vertikale nga viti i mbarë për librin shqip 1555 deri te viti i plotësimit të aspiratave të shqiptarëve për një shtet të tyrin: 1912. Përshkrimi bibliografik shtrihet në vepra të botuara deri në këtë vit jo vetëm sepse ai shënon njohjen e një të drejte të ligjshme për shqiptarët, atë të krijimit të shtetit të tyre, por edhe sepse prodhimi libror i kësaj periudhe mundëson hartimin e një bibliografie të plotë të formatuar sipas të gjitha rregullave dhe teknikave profesionale të kërkuara.

Është ndjekur parimi sipas të cilit një bibliografi retrospektive nuk duhet të mbetet në një përshkrim të nivelit të zakonshëm; përkundrazi ajo duhet të synojë një nivel përshkrimi sa më të plotë, deri aty sa të konsiderohet bibliografi shkencore. Përgjithësisht, faktori kohë ndikon pozitivisht në një bibliografi të karakterit retrospektiv sepse, që nga dalja në qarkullim e librave të periudhave

të hershme, parakuptohet një informacion i bollshëm rreth tyre. Megjithatë, bibliografi të tilla, mbase më shumë se të tjerat, kërkojnë për përmbushjen e këtij synimi stofin e bibliografit, nga njëra anë, por edhe erudicion të gjerë, zell dhe përkushtim, nga ana tjetër. Si punë shkencore kërkohet gjithashtu debat dhe konsultim me specialistë të fushës, sqarime, saktësime ose shmangie të metash dhe pasaktësish teknike. Parakuptohet, pa tjetër, edhe njohje dhe shfrytëzim racional i përvojës pararendëse në fushën e kërkimit bibliografik të librit shqip, në të cilën veçmas bibliografitë retrospektive të studiuesve dhe bibliografëve Legrand dhe Shuteriqi janë objekt lavdërimi dhe admirimi, gjerësisht të ndikueshme në çdo projekt bibliografik si ky. E sigurt është, nisur nga përvoja bibliografike, se ka mjaft arsye t'u bëhet homazh përpjekjeve dhe punës së tyre, që mbetet edhe sot referim i rëndësishëm për librin shqip të periudhave që ata kanë elaboruar.

Përfshirja në ndërmarrje të tilla nënkupton vështirësi, madje edhe rreziqe të shumta, ndaj dëshirohet që frytet e kësaj pune të rezultojnë të mbara sa duhet. Metodologjia e zgjedhur - shfrytëzimi i informacionit bibliografik ekzistues të skedarëve të Bibliotekës Kombëtare dhe shqyrtimi një për një i të gjitha njësive bibliotekare si elemente të një mozaiku kaq heterogjen dhe shumëngjyrësh - ishte racionale dhe profesionale, por shpesh ajo çoi në ballafaqime dhe përsiatje që kërkuan kohë, debate dhe, jo rrallë, zgjidhje krejt të tjera. Por shpresojmë t'ia ketë vlejtur: tanimë kemi një pamje të përgjithshme të librit shqip të kësaj periudhe, si pjesë e qenësishme e trashëgimisë së shkruar të popullit shqiptar.

Personalisht, kam shpresë t'ia kenë vlejtur ecejaket e shpeshta mbi dhjetëvjeçare nëpër "katet e nëndheshme, gjashtëmbëdhjetë shkallare poshtë hollit të shërbimit publik të Bibliotekës", siç vëren deri në detaje të tilla të imta studiuesi dhe drejtori Aurel Plasari, ku ruhen thesaret e trashëgimisë së shkruar të kombit tonë, të cilat ai i quan "kërshëri të vyera historike"². Shpesh mëdyshje të hollësive dhe saktësimeve bibliografike ka qenë e mundur të zgjidhen aty në hapësirat e ngushta me ndriçim të zbehtë dhe ajër të pamjaftueshëm nën rrezikun e infektimit nga mikroorganizma që, në mënyrë të pashmangshme, bartin këta libra jo rrallë me moshë disa qindravjeçare, hapësira në të cilat punojnë të padukura, në heshtje dhe me përkushtim zonjat dhe zonjushat e nderuara që u mundësojnë lexuesve shërbimin e kësaj trashëgimie. Por shumë shpesh është dashur që botime të përfshira në këtë bibliografi të nxirren nga këto galeri ose katakombe, të ngjiten lart në katin përdhes dhe të vendosen mbi tryezën e punës së bibliografit aty pranë stërnipit të tyre kompjuterik për

² Aurel Plasari, *Alfabeti në Bibliotekë*, në 100-vjetorin e Kongresit të Manastirit, 2008.

të vijuar puna e verifikimit dhe kërkimit për ditë me radhë, ndonjëherë edhe me javë, të të dhënave bibliografike nëpër studime dhe monografi, diksionerë dhe enciklopedi të ndryshme. Në mjaft raste është dashur të "lundrohet" edhe në baza elektronike të dhënash të bibliotekave kudo nëpër botë dhe website interneti me informacion befasues edhe për hollësi bibliografike të botimeve tona të së shkuarës, - një shembull domethënës i idesë së bashkëjetesës midis librit tradicional dhe teknologjive të reja, ide që punonjësve të bibliotekave u pëlqen ta nënvizojnë kur debatohet për fatin e librit në kushtet e vërshimit të medimeve të reja të bartjes së informacionit, të cilat nuk shihen thjesht si konkurrentë, por edhe si partnerë funksionalë në shërbimet ndaj përdoruesve.

Në hartimin e kësaj bibliografie është dashur të gërshetohen dijet e bibliografit me ato të historianit të librit, ashtu siç është dashur të investigohet fondi i vjetër i librit shqip të BKSh, proces gjatë të cilit nuk kanë qenë të rralla befasitë bibliografike. Kalimi i disahershëm nëpër duar i gjithë atyre thesareve kombëtare ka shkaktuar shpesh emocione të forta dhe të patreguara si për të kompensuar të vërtetën e pranuar përgjithësisht se hartimi i një bibliografie është një punë pedante, e lodhshme dhe e vështirë.

E sigurt është një gjë: çuarja deri në fund e punës së karakterizuar nga dukuri të tilla, si: entuziazëm, vlerësim i çdo hollësie me domethënie për përshkrimin, kënaqësi nga zgjidhja e dilemave bibliografike. Po ashtu, gëzim për kryerjen e një pune që qe dukur se po zgjaste pa fund, por që ka pretendimin t'u përgjigjet kërkesave bashkëkohore të përshkrimit bibliografik me standardin e lartë të informacionit ndërkombëtarisht të përputhshëm.

*

Pavarësisht se, siç u tha më lart, veprimtaria e organizuar bibliografike në vendin tonë ka filluar relativisht vonë - fund i viteve '50 të shekullit të kaluar - duhet theksuar që bibliografia shqiptare³ ka nisur të formësohet jashtë Shqipërie nga albanologë dhe studiues të huaj dhe arbëreshë⁴ më herët, diku rreth mesit të

³Termi *bibliografi shqiptare* këtu ngërthen dy kuptime: 1. Bibliografi e librit shqip dhe 2. Bibliografi e librit shqip dhe të huaj mbi Shqipërinë dhe shqiptarët.

⁴ Ndër më të shquarit mund të përmendim: J. Ritter von Xyländer, *Die Sprache Albanesen oder Schkipetaren* (Frankfurt am Main, 1835); Franz Miklosich, *Die slavischen Elemente im Albanischen* (Wien 1870); Georg Petrovitch, *Scanderbeg. Essai de bibliographie raisonnée* (Paris 1881); Gustav

shek. XIX. Mes punimeve bibliografike të botuara janë bibliografi të mirëfillta ato të autorëve G. Petrovitch, N. Jokl, F. Nopcsa, G. Petrotta, M. Roques dhe të ndonjë tjetri. Ndërkohë, pavarësisht se shpesh thjesht lista me numërime titujsh, me vlera të rëndësishme paraqiten edhe kontributet bibliografike të studiuesve të tjerë të përmendur në shënimin 4. Kështu në veprat e cituara në këtë shënim: F. Miklosich ka një listë bibliografike veprash albanologjike; G. Meyer një sprovë bibliografike me tituj librash shqip dhe albanologjike; A. Stratico një listë me veprat e cituara në *Manualin* e tij; A. Galanti një sprovë për një bibliografi të gjeografisë, etnografisë dhe historisë së Shqipërisë; ndërkohë që veprat e Zef Valentinit përmbajnë të dhëna të shumta bibliografike etj.

Megjithatë me të drejtë është konstatuar se bibliografia shqiptare, të paktën deri në shpalljen e pavarësisë kombëtare më 1912, nuk është shumë e pasur⁵. Nga kjo periudhë padyshim lartohen punimi i Franz Manek-ut, Gjergj Pekmezit dhe A. Stotz-it *Albanesische Bibliographie* (Wien 1909) dhe sidomos vepra *posthumous* e Émile Legrand-it *Bibliographie albanaise, Description raisonnée des ouvrages publiés en albanais ou relatifs à l'Albanie du quinzième siècle à l'année 1900* (Paris - Athènes, 1912), një bibliografi vërtetë shkencore, përgatitur për botim nga Henri Gûys, i cili botoi 25 vjet më vonë një bibliografi⁶ të vetën që mund të konsiderohet si shtojcë e *Bibliographie albanaise* të Legrandit⁷. Vepra e Legrandit është një bibliografi e arsyetuar⁸ përpiluar me shumë kujdes dhe kompetencë me 724 regjistrime librash shqip dhe mbi Shqipërinë që nga shek. XV deri më 1899.

Meyer, *Etymologisches Wörterbuch der Albanesischen Sprache*, (Strassburg 1891); Alberto Stratico, *Manuale di letteratura albanese* (Milano 1896); Arturo Galanti, *L'Albania*, notizie geografiche, etnografiche e storiche (Roma 1901); Norbert Jokl, *Geschichte der indogermanischen Sprachwissenschaft* (Strassburg 1917-1940); Ferencz Nopcsa, *Az albániaórol szó ló legujabb irodalom* (Budapest 1918); Zef Skiroi, *Della lingua albanese e della sua letteratura, anche in rapporto alle Colonie albanesi d'Italia* (1918); Gaetano Petrotta, *Popolo, lingua e letteratura albanese* (Palermo 1931); Mario Roques, *Recherches sur les anciens textes albanais* (Paris 1932); Zef Valentini, *Fjalor bio-bibliografik iliro-shqiptar / nomenklator* / (Shkodër 1937); Zef Valentini *Contributi alla cronologia albanese* (Roma 1942); Marco Petta, *Appunti di Bibliografia albanese. Opere non segnalate nella Bibliographie Albanaise di Legrand-Gûys dalla Biblioteca Criptense* në: Boll. Grott. 1955 etj.

⁵ Marco Petta, *Appunti di Bibliografia albanese. Opere non segnalate nella Bibliographie Albanaise di Legrand-Gûys dalla Biblioteca Criptense* në: Boll. Grott. 1955.

⁶ *Bibliographie albanaise, Description raisonnée des ouvrages publiés en albanais ou relatifs à l'Albanie de 1900 à 1910* (Tirana 1938).

⁷ D. Beratti, po aty, *Preface*.

⁸ Një bibliografi e arsyetuar ose e adnotuar përmban shënime “... që synojnë të përshkruajnë, shpjegojnë ose vlerësojnë botimin të cilit i referohen” (*The ALA glossary of library and information science*, Chicago: American Library Association, 1983, p. 8).

Duke folur për dobësi dhe të meta të bibliografive apo sprovave bibliografike të disa prej autorëve të përmendur pak më sipër⁹ albanologu M. Roques shkruan: “Bën përjashtim këtu *Bibliographie albanaise* e Legrand-it, përshkrimet e të cilës janë të shkëlqyera dhe vijnë si rezultat i kërkimeve të shumta dhe të gjata”¹⁰. Ndërsa Faik Konica, pasi theksonte se “Një bibliografi e përgjithshme është e një rëndësie të veçantë”, lajmëronte më 1898 në revistën *Albania* se “Emile Legrand *erudit eminent francez* ka ndërmarrë një punë të tillë dhe do të ishte e panevojshme të thuhej se një punë e tillë ka rënë në duar të sigurta”¹¹.

Pak vite më vonë Lumo Skendo, një figurë tjetër e shquar e studimeve, por edhe e bibliografisë dhe bibliofilisë shqiptare, do të shkruante: “Për fat të keq një bibliografi shqiptare e plotë akoma s’ka dalë dot në dritë; sa për tani më e mira dhe më seriozja është ajo e të ndjerit profesor Emile Legrand, shtypur më 1912 në Paris...”¹². Pasi konstaton se “nga të 724 librat e kataloguara prej Legrandit gjer në mot 1900 (...), vetëm 125 janë të shkruar shqip; të tjerat janë ose studime mbi gjuhët të bëra prej të huajve ose libra historie shetitjeje mbi kombin dhe vendin tënë”, L. Skendo me skrupulozitetin dhe njohjen e jashtëzakonshme të vlerave bibliografike shqiptare është në gjendje të gjejë mungesa edhe në një punë si ajo e Legrandit: “Për të kupëtuarë njeriu metësin e bibliografisë së Legrand-it arrin shumë herë të kthejë fletët e një katalogu librari; për shëmbllë, katalogu No 611 i librarit Joseph Baer & Co në Frankfurt, numëron 9 vepra që mungojnë në librët të profesorit frances”¹³.

Kurse bibliografia e Manek-Pekmezit përmbledh burime që nga antikiteti deri më 1909. Është një listë e pasur, por titujt nuk janë cituar gjithnjë me

⁹ Mario Roques, pasi vlerëson kontributin e autorëve të tillë si J. Xylander, G. Meyer, N. Jokl dhe Z. Skiroi, vë në dukje si dobësi të punës së tyre pamundësinë e njohjes së drejtpërdrejtë të teksteve origjinale apo riprodhimeve të njëjësive bibliografike të regjistruara, pra ndryshe nga ç’kishte vepruar ai në veprën e vet të shquar bibliografike: “Kërkimet e nisura që prej shumë vitesh më kanë çuar të rishoh tekste tashmë të sinjalizuara dhe më kanë lejuar të zbuloj disa botime ose ekzemplarë të panjohur apo të neglizhuar. Kam pasur kënaqësinë dhe gëzimin të gjej tekste të reja, ndër të cilët disa, të paktën, të rëndësishëm” (*Recherches sur les anciens textes albanais*, Paris 1932, f. 5).

¹⁰ Po ai: po aty.

¹¹ Rev. *Albania*, nr. 5-1898, f. 79. Më tej po aty Konica shkruan: “Një dijetar albanofil, duke folur për z. Emile Legrand na shkruante para ca kohësh: “Është një punëtor që i merr të gjitha seriozisht, ka shpirt kritik dhe është bibliograf i radhës së parë; mund të jeni i sigurtë që çdo gjë që do t’ju komunikojë ka një vlerë shkencore të patundur”.

¹² Rev. *Diturija*, 1916, nr. 2, f. 21.

¹³ Po aty. Më tej, nisur nga informacioni që dispononte si edhe nga nuhatja e bibliografit, L. Skendo shkruan se “... në qytetet e ndryshme: Shkodër, Bukuresht, Sofje, Korçë, Selanik, Stamboll, Bruxelles, Paris, Athinë, Vjenë, Itali, Misir, Amerikë do të jenë shtypur afër 400 libra dhe broshura në shqip, pa numëruar gazetat...”.

besnikëri dhe integralisht; ka edhe përshkrime të pamjaftueshme – dobësi këto nga fakti se jo gjithmonë autorët kanë mundur të sigurojnë ekzemplarë të njësive që përshkruhen. Por aty gjen shpesh të dhëna të vlefshme që mungojnë te Legrandi.

Autorë vendës që shquhen në këtë fushë janë pa dyshim dy nga figurat qendrore të kulturës sonë: Faik Konica¹⁴ dhe Lumo Skendo¹⁵, por edhe Benedikt Dema¹⁶ etj. Një veprimtari e dendur dhe cilësore bibliografike u zhvillua sidomos në Shkodër në një periudhë kohore të gjatë, e cila kulmon veçanërisht me rubrikat dhe punimet e posaçme në revista të shquara si *Hylli i Dritës* dhe *L.E.K.A.*

Në periudhën pas Luftës II Botërore vijoi tradita e punimeve bibliografike të ndërmarra nga individë të ndryshëm, kryesisht studiues të albanologjisë, si Jup Kastrati (*Bibliografi shqipe, 31.XI.1944-31.XII.1958*, 1959; *Bibliografi albanistike*, 2001 etj.), Dh. S. Shuteriqi (*Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*, 1976; *Tekstet shqipe dhe shkrimi i shqipes në vitet 879-1800*, 2005 etj.) etj., por edhe nga bibliografë profesionistë si Zyber Bakiu (*Bibliografi e zgjeruar e veprave të Sami Frashërit*, 1982); Faire Tabaku (*Bibliografi e letërsisë për fëmijë 1945-1984*) etj.

Kur studiuesi Gaetano Petrotta shkruante në fillim të viteve '30 të shekullit të kaluar se "... një bibliografi shqiptare është tashmë e nevojshme, sepse ato të disa autorëve dhe studiuesve të çështjeve shqiptare janë të paplota dhe ato të Manek-Pekmezi-Stotz (1909) dhe Legrandit (1912) janë vjetruar"¹⁷ ai kishte hedhur idenë për një veprimtari bibliografike që t'u përgjigjej si duhej kërkesave për informacion bibliografik sa më të plotë. Angazhimi i Bibliotekës Kombëtare në veprimtari të mirëfillta bibliografike në fund të viteve '50 të shekullit të kaluar shënon fillimet e një punë bibliografike shkencore dhe të organizuar në nivel institucional. Përveç disa kontributeve modeste me punime kryesisht të karakterit "të brendshëm" - Dodona Dhima *Bibliografi e librit shqip e pas çlirimit 1944-1955* (1956), *Bibliografi e librit shqip për vitet 1945-1957* (1959), Idajet Bejtja *Bibliografia retrospektive e librit shqip 1945-1960* (1973) etj. - si qendër kombëtare bibliografike BKSh ndërmori një veprimtari bibliografike të standardeve ndërkombëtare duke realizuar me sukses vepra të

¹⁴ Në rubrikën *Libra të ra*, por edhe te *Fleta e drejtorit* (ku njoftohej për botimet që i vinin redaksisë) te rev. *Albania* (Bruxelles-London 1896 - 1909).

¹⁵ Në rubrikat *Bibliografi* (1909), *Bibliografi shqipëtare. Shtim ne radhoj i Emile Legrand-it* (1926-1929) dhe *Libra të shtypura në Rumani* (1927) (rev. Diturija Selanik-Bukuresht-Tiranë 1909, 1916, 1926-1929).

¹⁶ *Veprimi letrar i A. Gjergj Fishtës* (Shkodër 1943).

¹⁷ Gaetano Petrotta, *Popolo, lingua e letteratura albanese*, Palermo 1932, f. 540.

tilla madhore si botimin vjetor *Bibliografia kombëtare e librit shqip /korrente/* (nga viti 1959 e në vijim), korpusin albanologjik *Albanica /retrospektive/* (që nga viti 1965 e në vijim¹⁸); *Gjergj Kastrioti Skënderbeu, bibliografi, 1454-1835* nga Kasem Biçoku dhe Jup Kastrati (1997) për të ardhur, më së fundmi, te kjo *Bibliografi retrospektive e librit shqip*, në tre vëllime, 1555-1958. Paralel me këto vepra shkencore bibliografike në Bibliotekën Kombëtare është punuar për hartimin dhe botimin e llojeve të ndryshme bibliografish etj., siç janë katalogët apo bibliografitë enumerative *Vepra të autorëve dhe studiuesve italianë për Shqipërinë dhe shqiptarët, shek. XV-XX* nga Afërdita Sharxhi dhe Nermin Basha (1995), *Vepra të autorëve dhe studiuesve francezë mbi Shqipërinë dhe shqiptarët, shek. XVI-XX* nga Etleva Domi dhe Afërdita Sharxhi (1997) etj.

Ndërkaq ka vijuar angazhimi i studiuesve të huaj të sotëm në punime të bibliografisë shqiptare, ku spikatin, si edhe në të kaluarën, përfaqësues të shkollës prestigjioze gjermane. Kështu, vepra e albanologëve Armin Hetzer dhe Viorel S. Roman *Albanien, Ein bibliographischer Forschungsbericht Mit Titellübersetzungen Standortnachweisen*, München 1983, hartuar në Bibliotekën e Universitetit të Bremenit, paraqet "punën më gjithëpërfshirëse të llojit të vet në formë libri mbi Shqipërinë"¹⁹. Ajo mbulon ndarje të tilla të dijes, si: filozofinë, sociologjinë, ligjet etj. Po ashtu ka edhe një listë me botime të bibliografisë shqiptare²⁰.

Një tjetër kontribut, që i shtohet traditës gjermane në këtë fushë, është edhe *Bibliografia kronologjike e botimeve të shtypshkronjës "Zoja e Paperlyeme" të Shkodrës (1870-1945)* në monografinë *Der Älteste Verlag Albaniens und sein Beitrag zu Nationalbewegung, Bildung und Kultur: die "Buchdruckerei der Unbefleckten Empfängnis" zu Shkodra: (1870-1945)*, Hamburg 2007, kapitulli

¹⁸ *Albanica I*. Bibliografi e shekujve XV-XVIII, punuar nga Aldo Çoba dhe Zef Prela (1965); *Albanica II*. Bibliografi e viteve 1800-1849, përgatitur nga Shpëtim Mema dhe Lindita Bubi (1987); *Albanica I*, ribotim i zgjeruar (1988) dhe *Albanica III*, Bibliografi e viteve 1850-1900, në proces përgatitjeje.

¹⁹ A. Hetzer & V. S. Roman, *Albanien, Ein bibliographischer Forschungsbericht...* München 1983, në *Parathënie*, f. 11.

²⁰ Duke dashur të argumentojë që kjo vepër "paraqet me shkallën e lartë të trajtimit një punë pioniere", në shënimin hyrës të botimit Prof. Dr. Klaus-Detlev Grothusen ekzagjeron kur shkruan se në Shqipëri kërkimi bibliografik "është i munguar në mënyrë të frikshme" (vepër e cituar f. 5), çfarë, siç del edhe nga kjo listë, por edhe nga sfondi historik i paraqitur shkurtazi pak më sipër, nuk i përgjigjet të vërtetës. Madje, vetë autorët e veprës në pjesën hyrëse të zërit *Burime* pohojnë se "po të kemi parasysh madhësinë e vendit dhe fatin e tij politik, ka (...) një numër të konsiderueshëm studimesh pararendëse që mund të listohen" dhe veçojnë, përveç veprave bibliografike nga Legrand-Gûys dhe Manek-Pekmezi-Stotz, edhe atë të Shuteriqit, *Shkrimet shqipe ... 1976* (po aty, f. 41). Kujtojmë që kur pohohej kjo e pavërtetë prej Prof. Dr. Grothusen-it, në Shqipëri kishte afro 25 vjet që hartohej dhe botohej *Bibliografia kombëtare e librit shqip*, ishte botuar edhe *Albanica I* (1965), që të dyja vepra madhore të punuara sipas rregullave dhe standardeve bashkëkohore të përshkrimit bibliografik.

9.2, f. 534-634 të studiuesit Markus W. E. Peters. Duke studiuar historinë e shtypshkronjës, dhe njëherësh shtëpisë botuese, më të vjetër dhe më cilësore në Shqipëri dhe posaçërisht ndihmesën e saj në lëvizjen kombëtare, arsimore dhe kulturore, pas kërkimesh në biblioteka dhe arkiva brenda dhe jashtë vendit tonë, pas konsultimesh me bibliografi dhe lista bibliografike të botuara ose jo, autori ka dhënë për herë të parë një “inventar” të plotë dhe të saktë të këtyre botimeve shpesh duke identifikuar autorë, përkthyes, vite botimi etj. deri më tash të panjohur.

*

Pas digresionit të mësipërm në historinë dhe arritjet e *bibliografisë shqiptare* është me interes të shihet për nga afër lënda bibliografike e këtij botimi. Në ato vite (1555-1912), për rrethana të njohura penguese të pushtimit osman, është prodhuar një numër modest librash, por me vlerë për historinë dhe kulturën tonë. Shtypur dhe botuar në vende të ndryshme, informacioni i shpërndarë për to shpesh është i vështirë të gjendet. Kjo është bibliografia e parë gjithëpërfshirëse në këtë fushë sepse përmban librat e botuar në hapësirën territoriale që korrespondon me atë të shtetit të sotëm shqiptar dhe trojet shqiptare jashtë saj në periudhën kohore që ka për objekt hulumtimi. Janë përfshirë në të jo vetëm librat në kuptimin e mirëfilltë të fjalës²¹, por edhe broshura²² ose libërtha me numër të vogël faqesh, fashikuj²³, ekstrakte me numërtim faqesh etj., pavarësisht nga alfabeti me të cilin janë shkruar²⁴.

²¹ Ndonëse është përdorur fillimisht në funksion të standardizimit ndërkombëtar të statistikave të prodhimit libror, merret në konsideratë përcaktimi i UNESCO-s sipas të cilit libër është “një botim i shtypur joperiodik me të paktën 49 faqe, pa përfshirë kopertinat” (Procesverbalet e Konferencës së Përgjithshme, sesioni XIII, UNESCO, Paris 1964, Rezolutat, f. 144). Njësinë e përkufizuar kështu bibliotekarët e quajnë *monografi*.

²² Broshura, sipas këtij përcaktimi, përmban më pak se 49 faqe (po aty).

²³ Janë konsideruar njësi bibliotekare dhe janë bërë objekt përshkrimi në këtë bibliografi edhe fashikujt e botuar dhe shitur si të tillë fillimisht. P.sh. regjistrimi nr. 182 [*Pjetri edhe Vasili*] Pa vd. [1896], 16 f. për nga paraqitja tipografike dhe nga numërtimi 1 (1-16) rezulton të jetë fashikulli i parë i lidhur më vete i botimit të përshkruar në regjistrimin bibliografik nr. 180 *Mësime të-vëjyerë a fjalë shpirtërishte* Të-folura ndë mësonjëtoret të çupave ndë Korçë, Konstandinupojë, Ndë shtypshkronjët të A. H. Bojaxhianit 1896, 96 f. Pra, termi “libër” në këtë bibliografi u referohet monografive, por edhe broshurave dhe fashikujve botim më vete.

²⁴ Sipas studiuesit Neil Harris, me “libër” kuptohet çdo objekt i shkruar, i shtypur ose krijuar në çfarëdo mënyre dhe në çfarëdo mediumi me qëllim komunikimin e një teksti, në dallim nga “regjistrimi

Me fjalë të tjera, pjesët e veprave që dihet ose mendohet që janë botuar veças janë regjistruar po veças. Kriter për të konsideruar ekzistencën e pavarur të një veprë ka qenë përgjithësisht fleta e titullit e veçantë (me të dhënat e botimit) dhe numërtimi i veçantë.

Janë përfshirë gjithashtu edhe katalogë të enteve botuese (regjistrimi nr. 371 *Radhua për librat e shtypshkronjës “Mbrothësija”*, shtypshkronja dhe librarija “Mbrothësija” Kristo Luarasi-Selanik 1909), prospekte (botime reklamë para botimit të librit kur paraqiten si botime më vete: regjistrimi nr. 365, *Stërvitjetore për nxënësit shqiptarë* prej N. Lako, Paris 1909) etj.

Kujdes i posaçëm është treguar për identifikimin dhe përshkrimin e njërive bibliografike të përfshira në *miscellanea*²⁵ të ndryshme duke dalluar qartazi bashkëlidhjet nga bashkështypjet, renditjen, numërtimet e faqeve dhe diferenca të tjera mes tyre, që kërkojnë vëmendje dhe saktësi të njëjlojtë me ato të njërive të prezantuara në mënyrë individuale.

Botime për të cilat ka informacion bibliografik, por që nuk gjenden në koleksionet e BKSh, nuk janë përfshirë në këtë bibliografi, por gjithsesi janë njoftuar duke u grupuar më vete në fund të saj²⁶. Në pikëpamje të vlerave kulturore dhe historike ndoshta jo të gjithë titujt e munguar në koleksionet e BKSh, rrjedhimisht edhe në këtë bibliografi, kanë të njëjtën rëndësi; por si njësi bibliotekare / bibliografike që të gjithë ata kanë secili vendin e vet në historinë e librit dhe të editorisë shqipe.

Duke kaluar nga njëra ndarje kronologjike te tjetra e kësaj bibliografie, pra nga *Meshari* (1555) i Buzukut dhe *Çeta e profetëve* (1685) e Bogdanit tek *akoluthitë / shërbesat* (1731-1744) e Voskopojës dhe *Eisagōgiki didaskalia / Mësime fillestare* [Venedik] (1908) me ushtrime gramatikore ose fjalorthin greqisht, arumanisht, bullgarisht dhe shqip të Dhanil Voskopojarit; nga *Fort i shkurtër e i përdorçim ëvetar shqip* (1844) i Veqilharxhit dhe *Alfavitari shqip* [1867] i Kristoforidhit të *Këngët e Milosaos* (1836) e De Radës, *Bagëti dhe bujqësia* (1886) e Naim Frashërit dhe *Lahuta e Maltsiis* [1904/1905] e Fishtës; nga *Vargënimi n’ gjuhë Shcypé* [1906] i Gurakuqit dhe *Israilitë dhe filistinë* (1907) e Nolit te *Ndollina historijet t’ motshme* (1911) e Mati Logorecit, *Prisi*

arkivor”, i cili është bërë dhe konservuar për të treguar një ngjarje të ndodhur ose veprim të kryer (*Analytical bibliography: an alternative prospectus*, kurs titulluar “*Introduction à la bibliographie matérielle: bibliographie détaillée*” mbajtur në Ecole de l’Institut d’Histoire du Livre, Lyon, 5-8 April 2004).

²⁵ Njësi të ndryshme ose vepra të shkruara të mbledhura së bashku; përmblendje njësisht të ndryshme, sidomos veprash, ekstraktesh, fragmentesh letrare në formë libri.

²⁶ Informacioni për libra që rezultojnë të munguara në koleksionet e BKSh është siguruar nga konsultimi sidomos me punime të Legrandit, Manek-Pekmezit, Lumo Skendos, Dh. S. Shuteriqit, Markus W. E. Peters, Luigj Shestani etj.

n' Lâmet' Letratyrës (1912) e Anton Xanonit dhe *Gramatikë elementare* (1912) e Sevasti Qirjazit dhe kështu me radhë lexuesi ose përdoruesi i kujdesshëm do të vërejë gjendjen e librit shqip në faza të ndryshme zhvillimi, evoluimin e pozitës së autorit, të tipografit dhe të botuesit, funksionimin e kanaleve të shpërndarjes së librit, madje edhe klimën e përgjithshme sociale dhe kulturore të kohës.

Është me interes të ravijëzohet gjeografia e shtypshkronjave/botuesve të librit shqip të kësaj periudhe, e cila, për shkaqe të njohura që u përmendën më lart, shtrihet më shumë jashtë Shqipërie se brenda saj. Bien në sy sidomos botimet e shumta të realizuara në disa nga qytetet kryesore të Italisë, si Romë, Venecia, Firenze, Milano, Napoli, Palermo, Padova, Trieste etj. ose ato të shoqërive patriotike-kulturore shqiptare në Bukuresht, Sofje, Kajro, madje edhe në Stamboll; botimet në qytete të Greqisë fqinje si Athinë, Selanik dhe Korfuz ose ato të Vjenës si qendër e perandorisë që kishte të drejtën e protektoratit të fesë katolike në Perandorinë Osmane, prej së cilës aq shumë përfitoi edhe Shqipëria; botimet në kryeqendra si Parisi, Londra dhe Brukseli ose ato në Aleksandri, në Beograd dhe Sarajevë, deri në Bostonin e përtej Atlantikut etj. Ndërsa brenda Shqipërisë spikatin sidomos botimet në qendra të tilla si Voskopoja dhe Shkodra, por edhe ato në Manastir, Korçë, Kostur, Elbasan.

Duke punuar për identifikimin e botimeve që janë përfshirë në këtë bibliografi vetiu është bërë një kontroll bibliografik i tyre, pra puna për hartimin e kësaj bibliografie praktikisht ka rezultuar edhe në një “inventar” relativisht tërësor të koleksioneve të librit shqip të këtyre viteve në BKSh. Me fjalë të tjera, përmes një hulumtimi të përimitë të njësive bibliografike është ekzaminuar edhe një herë gjithë pasuria librare e koleksioneve të saj që do të ishin objekt i kësaj bibliografie.

Për identifikimin e titujve që i përkasin kësaj periudhe janë bërë kërkime si në skedarin e autorëve, pra atë alfabetik, ashtu edhe në atë lëndor (sistematik), por edhe në skedarët kronologjik dhe topografik, skedarët e librit albanologjik dhe të librit të huaj. Pra, informacioni bibliografik fillestar mbi të cilin mbështetet kjo vepër është, pa dyshim, ai që bartin skedarët manualë të BKSh, informacion që është përpunuar dhe pasuruar në një proces të gjatë dhe të përgjegjshëm kontrolli, shqyrtimi dhe njësimi. Në mjaft raste pasaktësitë e tyre kanë ndihmuar në zgjidhjen e përshkrimit të botimeve problematike, në saktësime, qartësime dhe gjetje interesante jo vetëm në fushën e regjistrimit bibliografik, por edhe në atë të historisë së librit shqip. Saktësimet dhe plotësimet sidomos në kryetitull, në informacionin e munguar të të dhënave të botimit dhe në zona të tjera të përshkrimit bibliografik, pavarësisht se të

rëndësishme, nuk i zbehin konkordancat e kësaj bibliografie me këta skedarë. Gjithashtu, pavarësisht se informacioni i tyre u është nënshtruar verifikimeve të duhura dhe unifikimit të përsëritjeve të skedave me standarde dhe rregulla përshkrimi nga më të ndryshmet, regjistrimet ekzistuese shpesh kanë qenë të vlefshme për të krahasuar të dhënat bibliografike dhe për të hartuar versionin përfundimtar që është hedhur në këtë bibliografi.

Konsultimi i një numri të konsiderueshëm botimesh bibliografike në burime të shtypura ose elektronike krijoi mundësinë e pasurimit dhe saktësimin të bazës bibliografike ekzistuese të skedarëve manualë. Mund të përmendet shfletimi integral i mjaft punimeve bibliografike, mes të cilave më të dobishmet rezultuan bibliografitë e Legrandit, Manek-Pekmezit, Shuteriqit etj., por edhe ndonjë punim jo shumë i njohur si materiali enumerativ i pabotuar i Luigj Shestanit për veprat e shtypura dhe të botuara nga Shtypshkronja e Zojës së Paperlyeme²⁷. Sidomos në fazën përfundimtare janë bërë krahasime ballafaquese, integritime dhe plotësime me katalogë të tjerë përmes kërkimit në Internet në site të bibliotekave jashtë Shqipërisë (biblioteka kombëtare të vendeve të ndryshme Itali, Austri etj., biblioteka italiane me botime të arbëreshëve etj.), por edhe përmes kërkimit në punime bibliografike të botuara në variant elektronik ose të digjituara.

Librat e përshkruar në këtë bibliografi janë prekur të gjithë me dorë, jo vetëm titull për titull, por edhe çdo ekzemplar i tyre, çfarë do të thotë se ajo u është shmangur gati plotësisht “fantomave bibliografike”²⁸. Totali i punës së kryer nga viti 1998 deri në atë 2010 mund të sintetizohet në disa shifra: për identifikimin e titujve që tashmë gjenden të fiksuar në këtë bibliografi u “shfletuan” dhe u konsultuan mijëra skeda në skedarët e gjithëllojshëm të Bibliotekës Kombëtare, prej të cilëve janë nxjerrë dhe janë shqyrtuar rreth 900 tituj librash dhe janë ekzaminuar rreth 20.000 ekzemplarë të tyre ose njësi bibliografike. Përfundimisht kanë rezultuar gjithsej 558 tituj librash të periudhës 1555-1912, pra kjo bibliografi përmban 558 regjistrime bibliografike (përfshirë edhe regjistrimin nr. 19/1). E gjithë kjo punë të sjell ndër mend

²⁷ *Katalogu i librave të botuara nga shtypshkronja “Zoja e Paperlyeme” të etëve jezuitë në Shkodër prej vjetit 1871-1928*, Shkodër 1965.

²⁸ George Watson Cole (1850-1939), një ndër bibliografët më të shquar amerikanë, shkruan se bibliografitë janë plot me të dhëna të gabuara ose të pasakta botimesh për dy arsye: së pari, për shkak të shkrimit të paqartë ose të palexueshëm të autorëve të veprave, dorëshkrimet e të cilave ndodhte që të deshifroheshin gabim ose jo saktë prej radhitësve në shtypshkronjë dhe, së dyti, për shkak të leximeve të hamendësuar të të dhënave të dëmtuara, deri në atë shkallë sa të jenë bërë të palexueshme, ose të shtypura jo qartë në vetë librat e botuar (*Bibliographical Ghosts*, The University Chicago Press 1920, f. 4).

përcaktimin e Neil Harris-it për bibliografinë si shkencë “që siguron gjak nga guri, (...) që nxjerr nga artifaktet çdo gram informacioni”²⁹.

Mungesat në një periudhë kohore kaq të shtrirë janë të pakonsiderueshme. Nga ky “kontroll bibliografik”, ballafaquar me informacionin e siguruar nga burime të ndryshme, rezultojnë të munguar në koleksionet e BKSh 46 tituj librash: shqip, në gjuhë të huaj, tekste shkollore në italisht dhe disa tituj kolanash ose serish, pra rreth 8% e botimeve të atyre viteve³⁰. Thënë ndryshe, plotëria e kësaj bibliografie konsiderohet rreth 92%. Mendohet që zbrazëtitë do të vijojnë të mbushen dhe, në këtë kuptim, ky botim do t’u ofrojë të interesuarve një shans për të marrë pjesë në plotësimin e tij. Kjo bibliografi mbetet e hapur sidomos për kontributin e ekspertëve dhe dashamirëve të librit shqip në mbledhjen e informacionit mbi materiale të papasqyruara këtu që do ta bëjnë atë edhe më të vlefshme. Përpjekje të mëtejshme, përkushtim dhe kohë për të zbuluar dhe listuar çdo njësi bibliotekare të ruajtur sidomos jashtë vendit do të nevojiten në të ardhmen.

Që kjo nuk është, dhe nuk do të mund të ishte, një bibliografi tërësisht e plotë kjo është e vetëkuptueshme kryesisht për shkak të rrethanave historike të pafavorshme në të cilat është përvijuar e kaluara e kombit tonë dhe fatit të trishtë, shpesh tragjik, të librit shqip. Ndërkohë që kombet e tjera kishin gjetur mekanizma ligjorë për grumbullimin e botimeve të tyre shekuj më parë³¹, libri shqip kishte mbetur i pambledhur dhe vetëm shumë vonë, pas ngritjes së Bibliotekës Kombëtare më 1920, u bë e mundur nxjerrja e një ligji për dorëzimin e detyruar të ekzemplarëve dhe, si rrjedhojë, krijimi dhe pasurimi i një arkivi të tij. Puna gjithë pasion dhe përgjegjësi e brezave të tërë drejtuesish dhe specialistësh të BKSh, por edhe e disa prej personaliteteve të kulturës shqiptare, më i spikaturit mes tyre Mithat Frashëri, ka mundësuar që përmes dorëzimit të detyruar të ekzemplarëve, blerjeve dhe dhuratave të arrihej kjo plotësi relativisht e kënaqshme e librit shqip në koleksionet e institucionit tonë kombëtar të librit.

Kjo bibliografi, përveç se nuk mëton se përmbledh gjithçka, nuk mëton as se paraqet një punë të kompletuar dhe të perfeksionuar. Krahas limiteve të caktuara të pasurisë librare të kësaj periudhe, mund të ketë edhe limite që lidhen

²⁹ Analytical bibliography: an alternative prospectus, f. 7.

³⁰ Shih *Informacion bibliografik* për tituj që nuk gjenden në koleksionet e Bibliotekës Kombëtare, në fund të kësaj Bibliografie.

³¹ P.sh. kopja legale në Francë e ka burimin nga një rregullore e viti 1537 nxjerrë nga mbreti François I, e cila detyronte që një ekzemplar i çdo libri të botuar në vend të dërgohej falas në Bibliotekën Mbretërore, e cila gjatë Revolucionit Francez mori emrin Biblioteka Kombëtare e Francës.

me një traditë jo fort të konsoliduar të kulturës dhe shkencës bibliografike në vendin tonë, madje mbase edhe limite të vetë punës sime. Por vlera e kësaj bibliografie nuk qëndron thjesht në sasinë e titujve që ofron. Përveç faktit që shërben si një instrument organik konsultimi për gjithë prodhimin libror shqiptar deri më 1912, duke u kursyer studiuesve për hulumtimet e tyre kohë dhe punë me instrumente pjesore ose të kufizuara, njëherazi ajo ofron një shërbim të ri të kualifikuar për ta, sidomos në dijet albano-balkanologjike. Historia e librit shqip në kompleksitetin e vet, si pjesë integrale e kulturës sonë kombëtare, por edhe depërtimi dhe përthithja e kulturave të huaja³² do të sigurojnë edhe ato një bazë kërkimi dhe gjetjeje efektive të kjo bibliografi.

Hartuar me mjete të metodave shkencore dhe me përshkrim ekskluzivisht *de visu* kjo bibliografi është një burim i besueshëm të dhënash për shumicën dërmuese të librave të kësaj periudhe³³. Ajo ofron për studiuesit një numër të konsiderueshëm të dhënash të reja: shpjegime të inicialeve, emrave të paplotë, pseudonimeve dhe anonimeve; emra të shtëpive botuese, vende dhe vite botimi, tirazhe, çmim etj. të një numri të konsiderueshëm librash ku të gjitha këto elemente të domosdoshme të përshkrimit bibliografik kanë munguar. Por, duke mos qenë një bibliografi e karakterit analitik, nuk janë pjesë e përshkrimit bibliografik shqyrtime të plota analitike si dhe adnotimet e përmbajtjes së librave³⁴.

Regjistrimet në të gjitha rastet janë krijuar mbi bazën e ekzemplarëve të ekzaminuar. Në raste të veçanta, sidomos të librave me vit botimi të hershëm, regjistrimet synojnë të përshkruajnë, sa më saktë të jetë e mundur, atë që në teorinë dhe praktikën bibliografike njihet nën termin “ekzemplar ose kopje ideale” përmes krahasimit dhe integritetit të të dhënave të disponuara, por edhe

³² Janë evidentuar dhe regjistruar 24 tituj në gjuhë të huaja (greqisht dhe italisht) botuar në Shqipëri (Voskopojë dhe Shkodër), kryesisht tekste fetare, libra gjuhësorë, gjeografikë, tekste dhe dokumentacion shkollor etj. të kësaj periudhe.

³³ Zbatimi me rreptësi i këtij parimi bazë të përshkrimit bibliografik ka çuar në mjaft saktësime, sqarime ose korrigjime, ndonjëherë të rëndësishme, për historinë e librit shqip, të letërsisë shqipe etj. P.sh. në mjaft autorë, madje edhe në tekste akademike, gjendet mendimi se vjersha e parë shqipe e botuar është ajo e Lekë Matrëngës në *E mbsuame e krishterë* (1592). Shqyrtimi i imtë i ekzemplarit të BKSh të fotografuar nga origjinali i Bibliotekës Vatikane i këtij botimi nuk e provon një gjë të tillë. Në të vërtetë ajo vjershë gjendet vetëm në një variant të dorëshkruar të këtij libri, variant që nuk pa dritën e botimit (për më shumë shih regjistrimin nr. 2 në këtë bibliografi).

³⁴ Bibliografia analitike, ndonjëherë e quajtur edhe *kritike*, ka të bëjë me studimin e librave si objekte fizike, të hollësive të prodhimit të tyre, të ndikimeve të metodës së prodhimit mbi tekstin. Ajo lidhet me historinë e tipografëve dhe libërshitësve, me përshkrimin e letrës dhe të lidhjeve ose me probleme tekstuale gjatë procesit të kalimit të dorëshkrimit të autorit në librin e botuar (Terry Belanger *Descriptive bibliography*, në *Book Collecting: A Modern Guide*, New York and London: R. R. Bowker, 1977, f. 97-101).

atyre të njoftuara dhe të verifikuara. Termi “ekzemplar ideal”³⁵ përdoret vetëm për libra të shtypur para vitit 1800 kur zakonisht nuk bëheshin korrigjime në shtypshkronjë gjatë procesit të shtypjes. Çdo dallim i verifikuar midis “kopjes ideale” të një edicioni³⁶ dhe kopjeve të tjera të tij sinjalizohet në zonën e shënimeve të bibliografit³⁷ (shih, p.sh., një sinjalizim të kësaj natyre te regjistrimi nr. 2, pra ai për librin e Lekë Matrëngës *E mbsueme e krishterë*). Kjo ka ndihmuar punën për trajtimin dhe paraqitjen e veçorive dhe të dhënave fizike që janë pjesë e përshkrimit bibliografik, e cila bazohet në krahasimin e ekzemplarëve që gjenden në koleksionet e BKSh, por edhe në informacionin e siguruar nga burime të tjera në medime tradicionale, si edhe në katalogë elektronikë të bibliotekave në vende të tjera. Përgjithësisht është synuar përfshirja e sa më shumë informacioni në regjistrim.

Është synuar, gjithashtu, që informacioni për të gjitha elementet e zonave të përshkrimit bibliografik, përveç se në fletën e titullit, të sigurohet edhe prej burimeve të tjera brenda vetë librit (parathënie, pasthënie, shënime etj.), por edhe në burime të besueshme jashtë tij, kryesisht në monografi, artikuj etj. autorësh të tillë si vendës: Eqrem Çabej, Xhevat Lloshi, Aurel Plasari, Palok Daka, Jup Kastrati, Justin Rrota, Zef Valentini (ai vetë mbahej *vendës*), Selman Riza, Injac Zamputi, Mentor Quku, etj. ose të huaj: Gustav Meyer, Mario Roques, Gaetano Petrotta dhe Matteo Mandalà (këta të dy nga të *gjakut të shprishur* arbëresh), Fulvio Cordignano, Markus Peters, Max Demeter Peyfuss etj. Në formën e një liste të referencave bibliografike janë renditur në bibliografinë e vendosur në fund të këtij punimi bibliografik jo vetëm studimet e autorëve të mësipërm, monografi ose artikuj, por edhe ato të dhjetëra autorëve të tjerë. Sqarojmë se në këtë *bibliografi të bibliografisë*³⁸ përmbahen vetëm vepra që janë cituar në zonën e shënimeve të bibliografit si burime informacioni shtesë.

³⁵ “Kopja më perfekte e shtypjes së parë të një edicioni, bazuar në një këqyrje të plotë të të gjitha kopjeve të disponuara, me të cilën krahasohen të gjitha kopjet e tjera të të njëjtës shtypje dhe të ndonjë shtypjeje tjetër pasardhëse.” (John Carter *ABC for Book Collectors*, Oak Knoll 1995, f. 28) ose “kopja e një vepre në paraqitjen më perfekte, ashtu siç ka dashur ta realizojë tipografi ose botuesi fillimisht...” (Philip Gaskell, *A new introduction to bibliography*, Oxford University Press 1972, f. 321).

³⁶ “... edicioni përfshin të gjitha kopjet e një libri të shtypur njëherësh nga një radhitje shkronjash pa ndryshim substancial”, ndërsa një shtypje “përmban gjithë numrin e kopjeve të një edicioni të shtypura njëherësh, pa e hequr radhitjen ose ilustrimet nga makina e shtypit (...) Nëse botuesi i shet të gjitha kopjet e realizuara dhe prodhon të reja pa bërë ndryshime, atëherë edicioni nuk ka ndryshuar, por kemi një shtypje të re” (John Carter, *vepër e cituar*, f. 29).

³⁷ Gjatë shek. XVI-XVII variante të tilla ishin shpesh rezultat i lejimit të autorit të vizitonte sallën e makinerisë kur shtypi ishte në vijim (Joan M. Reitz, *Dictionary for Library and Information Science*, Libraries Unlimited 2004, në zërin *State*).

³⁸ Në dukje si lojë fjalësh, kjo sintagmë e pazakontë mbase kërkon një sqarim. Termi *bibliografi* përmban dy kuptime: 1. listë e shkrimeve të përdorura apo të konsultuara prej një autori gjatë përgatitjes

Në pjesën e parë të saj janë renditur bibliografi, katalogë, enciklopedi, botime dokumentare, vepra me autorë kolektivë, vepra pa autorë, periodikë etj.; ndërsa në të dytën monografi, studime dhe artikuj të autorëve të veçantë.

Siç u tha, burim i kësaj bibliografie është pasuria librare e BKSh, në të cilën ka mjaft botime të rralla. Do të shihet edhe në këtë “inventar” të njërive bibliografike të koleksioneve të saj që një shumicë titujsh gjenden vetëm në një ekzemplar, pra kanë statusin e “djalit të vetëm” dhe si të tillë ruhen “si sytë e ballit” në Arkivin e Librit Shqip. Ndërkaq mjaft tituj të këtij Arkivi kanë në fondin e përgjithshëm dhe në fonde të tjera të koleksioneve ekzemplarë “motra dhe vëllezër”, në ndonjë rast 8-15 të tillë, shpesh secili me vlerën e vet të vulës, autografit, shënimit etj. që përmban. Si për bibliotekarin, ashtu edhe për studiuesin e sotëm koleksionet e BKSh janë kësisoj me interes jo vetëm si “magazina” më e madhe e librit shqip të periudhës 1555-1912, por edhe sepse paraqiten si përpjekje të ndërmarra për të grumbulluar sistematikisht, brenda mundësive të kohës, të gjitha veprat, produkte të kulturës së shkruar shqiptare, të realizuara në periudhën para lindjes së shtetit shqiptar.

Vetiu lind pyetja: cilat janë burimet nga vijnë librat e pasurisë së sotme librare të BKSh? Përgjigjja e kësaj pyetjeje gjendet në këtë bibliografi, përmes së cilës tërthorazi njoftohemi me rrugët e krijimit dhe pasurimit të këtyre koleksioneve nga burime të ndryshme: blerje sistematike, dhurime nga autorë ose personalitete të jetës shqiptare, ndër ta studiues të huaj dhe miq të Shqipërisë, konfiskime dhe sekuestrime të bibliotekave private dhe atyre të institucioneve fetare etj., shkëmbime dhe huazime kombëtare e ndërkombëtare etj.

Është menduar që në këtë punim përshkrimi bibliografik i njërive të mos shoqërohet me klasifikimin e tyre për shkak të ngushtësisë relative të dijeve që përfshihen në botimet e kësaj periudhe të hershme të librit shqip³⁹. Sidoqoftë, në këtë drejtim përdoruesve të kësaj bibliografie do t’u vijë në ndihmë *Treguesi lëndor* i vendosur në fund të saj bashkë me treguesit e tjerë. Një pasqyrë e tematikës së botimeve të kësaj periudhe do të na paraqiste një tablo me dy pamje: *e para*, me botime të shumta nga fusha të tilla, si historia e Shqipërisë (por edhe e vendeve të tjera), gjuha shqipe dhe folklori, letërsia shqipe (përfshirë letërsia e arbëreshëve të Italisë dhe Greqisë), letërsia e huaj (mbizotërojnë përkthimet nga gjuhë perëndimore, si italisht, frëngjisht,

së një vepre ose të cituara në këtë vepër; 2. përshkrimi dhe identifikimi i edicioneve, viteve të botimit, autorësisë dhe veçorive tipografike të librave ose materialeve të tjera të shkruara; hartimi i këtij informacioni. Në këtë konstrukt stilistik janë të përfshira të dy kuptimet e termit; pra kemi të bëjmë me listën e titujve të veprave të cituara në këtë bibliografi të hartuar për dhënien e informacionit bibliografik për librin shqip të periudhës 1555-1912.

³⁹ Mbi “*Bibliografinë Kombëtare Retrospektive të librit shqiptar 1555-1958*”, f. 4-5.

gjermanisht etj.), botime fetare, tekste shkollore etj.; *e dyta*, me botime më të pakta nga fusha jo shumë të rrahura dhe delikate për kohën dhe hapësirën shqiptare si antropologjia kulturore, etnologjia, filozofia, sociologjia, teoria e letërsisë, trajtesa politike, statistika etj. Në dy fazat vijuese të librit shqip: 1913-1944 dhe 1945-1958, tematika e këtyre fushave do të thellohet, por edhe zgjerohet dhe pasurohet me elemente të reja.

Dobinë e kësaj bibliografie e rritin sidomos treguesit, si instrument i rëndësishëm në ndihmë të përdoruesve. Në formën e listave, ato përmbajnë informacion bibliografik të një rëndësie të dorës së parë. Nisur nga fakti që, për një shfrytëzim më të shpejtë dhe më efektiv të këtij informacioni, shpesh leximi i bibliografive ndodh që fillon nga fundi, pra nga treguesit, është bërë kujdes që ata të punohen me të njëjtën përgjegjësi.

Përveç *Treguesit lëndor*, që përmban nocione nga fusha të ndryshme të dijes dhe krijimtarisë njerëzore, kjo bibliografi është pajisur edhe me *Treguesin e emrave të autorëve* dhe të bashkautorëve, të përkthyesve, editorëve, përmbledhësve, përgatitësve, autorëve të parathënies, hyrjeve, shënimeve, pasthënies etj., emra që janë shënuar në të gjitha format e ndryshme, përfshirë edhe pseudonimet dhe inicialet me të cilat janë gjetur në burimet e të dhënave; por numri i regjistrimit bibliografik të veprës së një autori me trajta të ndryshme emri është vendosur te *Treguesi i autorëve* tek ajo më e njohura, ashtu siç edhe është shënuar në vetë regjistrimin.

Po me kaq rëndësi paraqitet edhe *Treguesi i titujve* të veprave të përshkruara. Këtu është bërë kujdes që, në raste të veçanta, siç janë përmbledhjet *miscellanea*, të jepet indikacion për secilën njësi bibliografike të përfshirë në to. Kurse në rastin e botimeve me më shumë se një titull ose me tituj paralelë është dhënë indikacion edhe për ta në mënyrë që përdoruesi ta gjejë librin për të cilin interesohet në cilëndo formë që ta ketë informacionin për titullin e tij.

Evidentimi i vulave, etiketave (ex-libris) etj. të hasura në ekzemplarët e njësive të përshkruara është më shumë se një kërsëri ose interes i rastësishëm, sidomos për studiues të fushave të tilla si politologji, sociologji, kulturologji, bibliologji (përfshirë edhe historinë e librit dhe të institucioneve të tij) etj.

II

Duke pasqyruar në mënyrë koncize në formën e të dhënave faktike përpjekjen për dije, bibliografitë paraqiten ndër shfaqjet më objektive të

studimit shkencor. Këto të dhëna, natyrisht, duhen qëmtuar dhe paraqitur në mënyrë të organizuar për të qenë të shfrytëzueshme prej dijetarëve të fushave përkatëse, sepse dihet që askush prej tyre nuk do të ishte në gjendje të kishte informacion për gjithçka që është botuar në disiplinën e veçantë në të cilën punon. Thënë ndryshe, asnjë studiues nuk mund të punojë pa bibliografitë. Nga ana tjetër, regjistrimi dhe renditja e materialit, analiza e tij në pikëpamje bibliografike, por edhe historia dhe autenticiteti i tij, janë që të gjitha probleme që lidhen me efektivitetin e përdorimit të tij, të cilat asnjë bibliograf nuk do të guxonte t'i shpërfillte.

Gjatë qindra viteve bibliografia gjithnjë e më shumë erdh' e u bë shkencë dhe u plotësua me metodat dhe paraqitjen e vet të veçantë. Duket e mistershme për ata që nuk janë familjarizuar me të, por për ata që ia dinë vlerën është një mjet i pazëvendësueshëm këshillimi, mbi të gjitha kursim kohe, aq e vlefshme për çdo dijetar kjo, sidomos në fazën përgatitore të punës shkencore.

E konsideruar edhe shkencë edhe art, bibliografia është një disiplinë më vete me disa degë dhe që u shërben disiplinave të tjera, pra është një mbështetje themelore për dijen. Si çdo disiplinë, ajo parakupton një bazë dijesh dhe aftësi interpretuese nga ana e bibliografit. Bibliografia, ose libri bibliografik, në vetvete është një burim i shkëlqyer informacioni. Por ç'është një bibliografi të mirë? Si mund të përdoret ajo me efektivitet? Teoria dhe praktika bibliografike pohojnë se, për të qenë cilësore, bibliografia duhet të plotësojë disa kritere: autori të jetë i kualifikuar, mundësisht edhe i lidhur me ndonjë institucion të specializuar bibliografik, dhe të përdorë standarde bibliografike; të jetë botuar nga botues i njohur dhe jo i vetëbotuar⁴⁰. Dy janë detyrat themelore të bibliografit: të përshkruajë me saktësi dhe plotësisht⁴¹. Në se dyshon në cilësinë e një bibliografie (saktësi, plotshmëri etj.), lexuesi i mençur i referohet pa entuziazëm dhe, në rastet që druhet se citimi i prish besueshmërinë, gjen si rrugë më efektive shmangien e saj...

*

Është me interes të hedhim një vështrim të shpejtë në rrugën nëpër të cilën ka ecur veprimtaria bibliografike, për të patur kështu një vizion të përgjithshëm të zhvillimit të saj historik.

⁴⁰ David Armstrong, *Bibliography for Beginners*, në IOBA (Independent Online Booksellers Association).

⁴¹ Carl Spadoni, *What Historians of the Book Need to Know about Bibliography*, në rev. *History of Intellectual Culture*, 2007, Vol. 7, No. 1, f. 8.

Mes guidave bibliografike të materialit të bollshëm që ishte akumuluar në fund të periudhës së librit të dorëshkruar disa prej tyre dallohen për cilësitë e veçanta ose për rëndësinë lidhur me epokën në të cilën ato ishin përpiluar. Një ndër më të hershmet është *Liber de scriptoribus ecclesiasticis* (1531) e një abati të dioqezës së Mainz-it të quajtur Johannes Trithemius: ajo përfshin shkrimet e rreth 1000 autorëve klerikë në një rend kronologjik; një nga punimet e para bibliografike që gjeti rrugën e shtypit, fakt që tregon rëndësinë që ato filluan të kenë.

Vijuan më vonë punime të tilla, si *Bibliotheca Universalis* (1545) i zviceranit Conrad Gesner, babai i bibliografisë, i quajtur gjithashtu “monstrum eruditionis”⁴²; *Annales Typographici, ab Artis inventae origine ad annum 1664* (1733) i bibliograf Michael Maittaire. U shqua edhe antikuariani anglez Josef Ames me *Typographical antiquities* (1749), që përshkroi botimet e shtypura në Angli nga 1471 deri më 1600, një monument i punës sistematike i mbajtur ende sot një burim i konsiderueshëm informacioni bibliografik etj. Por arritja më e madhe e kohës ishte *Annales typographici* (që filloi të dalë më 1793 me inkunabulat) e bibliografit gjerman Georg Wolfgang Franz Panzer. Nuk mbeti pas as bibliografia franceze me vepra të tilla, si *Bibliographie instructive ou Traité de la connaissance des livres rares et singuliers* (1763-1768) e bibliografit Guillaume-François Debure, e cila fillon traditën e bibliografive të librave të rrallë dhe të çmueshëm, ose *Manuel du libraire et de l’amateur de livres* (1810) e bibliografit Jacques Charles Brunet, që përbën kulmin e një vargu veprash bibliografike bazuar në interesa antikuariane të periudhës pararendëse. Francezët spikatën në këtë fushë si një komb me ndjeshmëri të lartë për librin dhe me tradita bibliotekare të fuqishme.

Një hap tjetër përpara në studimet bibliografike, mbase më i rëndësishmi i të gjithëve, u hodh rreth shek. XIX, kryesisht në Angli, dhe çoi në një kuptim më të thellë të problemeve bibliografike që një libër mund të paraqesë. Zuri vend ideja që libri nuk ishte më vetëm një objekt për t’u listuar. Nëse i nënshtrohej një studimi të thellë, ai shpesh zbulonte një sasi detajesh me rëndësi për historinë e vet, por edhe të kulturës në përgjithësi. Ky studim i thelluar filloi në nivel thjesht historik ose antikuar, pra me libra të vjetër dhe të rrallë, por shpejt e kapërceu këtë dukuri, ndonëse botime të tilla gjithnjë vijuan të mbeten të përfshira. Ajo që ndodhi në studimet bibliografike ishte kryesisht pasojë e kalimit nga kërkime dhe punime bibliografike diletante në një veprimtari mbi baza profesionale të hulumtimit dhe organizimit të përshkrimit

⁴² Sirkka Havu, *Conrad Gesner: father of bibliography*, 71st World Library and Information Congress, Järvenpää, Finland 11-12 August 2005.

të librit, çfarë solli me vete afirmimin e mjaft figurave të shquara bibliografësh profesionistë.

Ishte anglezi Henry Bradshaw ai që provoi të jetë një pikë e rëndësishme kthese: një fushë e re e punës bibliografike, krejt e ndryshme nga bibliografia enumerative, filloi të shfaqet me të. Metoda e Bradshaw-ut lindi teknikat e asaj që sot zakonisht quhet *bibliografi analitike* ose *kritike* dhe mbulon investigimin e natyrës fizike të librit, rrethanat e prodhimit dhe të historisë së tij.

*

Bazat teorike të veprimtarisë bibliografike hidhen tanimë me shek. XX. Është shekulli kur mund të flitet për përpunimin e filozofisë së bibliografisë prej një grupi personalitetesh të fushës, por me vizione dhe formim përtej saj.

Përkufizimi më gjerësisht i pranuar i bibliografisë është ai i Sir Walter W. Greg, njërit prej etërve të bibliografisë moderne, i cili e përcakton atë si “studimi i librave si objekte materiale”⁴³. Mendimet e Gregut mbi bibliografinë, natyrën e saj, funksionet dhe metodat me të cilat ajo zbatohet janë me mjaft interes sot e gjithë ditën. I cituar shpesh mbetet sidomos postulati i tij “se ajo për çka bibliografi interesohet janë copat e letrës ose të pergamenës të mbuluara me shenja të caktuara të shkruara ose të shtypura. Me këto ai lidhet thjesht si shenja arbitrarë; kuptimi i tyre nuk është punë e tij”⁴⁴. Ky përkufizim klasik i bibliografisë, ose së paku i bibliografisë së “pastër”, është në thelb bazë e pretendimit të të qenit shkencore të procedurave bibliografike.

Një përkufizues tjetër i madh i qëllimeve, metodave dhe mjeteve të bibliografisë është Fredson Bowers i universitetit të Charlottesville (Virginia). Ishte i pari që ofroi një organizim bindës dhe praktik të terminologjisë që përcakton dhe përshkruan llojet e ndryshme të bibliografisë⁴⁵. Ai formuloi një strukturë 5-pjesëshe që mbulon të gjitha proceset e veprimtarisë bibliografike: *enumerative* (listë librash si një dokument ndihmës ose regjistër); *historike* (konteksti në të cilin dokumenti bibliotekar është prodhuar); *analitike* (në të cilin simbolet e shtypura, që janë shkronja dhe fjalë, trajtohen në aspektin fizik

⁴³ Walter W. Greg, *The present position of Bibliography* në rev. *The Library*, vol. 11 (1930), f. 241-262.

⁴⁴ Po ai: po aty, f. 121-122.

⁴⁵ *Bibliography, Pure Bibliography and Literary Studies* në *Papers of the Bibliographical Society of America*, vol. 46 (1952), f. 186-208.

dhe jo atë alfabetik); *deskriptive* (bibliografi që përshkruan atë që është gjetur) dhe *tekstuale* (aplikimi i të dhënave të bibliografisë analitike për probleme tekstuale). Në të vërtetë, të gjitha bibliografitë janë njëherazi enumerative, historike dhe analitike, megjithëse pranohet që ato deskriptive dhe tekstuale, duke qenë aplikative, më tepër se bibliografi të mirëfillta, duhen konsideruar disi më ndryshe⁴⁶.

Në të gjitha rastet duhet të dimë si ta analizojmë librin dhe si ta shqyrtojmë atë. “Çdo libër paraqet problemet e veta dhe duhet të shqyrtohet me metoda të përshtatshme për rastin e tij të veçantë”, shkruante Ronald B. McKerrow 80 vjet më parë në një vepër klasike shumë të rekomanduar ende sot⁴⁷. P.sh. në rastin e bibliografisë *historike* synohet një pamje e gjerë e shtypjes dhe publikimit: ajo është kryesisht histori e librit, por nga një perspektivë bibliografike, dhe nuk përqendrohet aq shumë te ndikimi i librave në shoqëri dhe kulturë, por në të kundërtën e kësaj.

Të gjitha janë diskutime që nxjerrin, në fund të fundit, te raporti i bibliografisë me historinë e librit. E para është shumë e rëndësishme për të dytën, madje të dyja disiplinat, duke ruajtur dallimet thelbësore të njëra-tjetrës, ndërlihen funksionalisht dhe ndërfiten në kufijtë që i ndajnë/bashkojnë. Bibliografia dhe metodat e historisë së librit nuk janë në kundërshti, por plotësojnë njëra-tjetrën.

Historianët e librit përdorin qasje të ndryshme ndaj objektit të punës së tyre studimore në varësi të qëllimit dhe audiencës së parashikuar. Si profesionistë, çdokush prej tyre e kupton që edhe në këtë fushë historia duhet bazuar në një varg burimesh themelore: arkiva, dëshmi gojore, gazeta, revista dhe, natyrisht, libra. Të shpërfillësh librat si e dhënë themelore ose të mos kuptosh rëndësinë e elementeve bibliografike që ata bartin do të thotë të dobësosh bazat e punës shkencore. Në këtë drejtim historiani e ka të domosdoshme të kuptojë koncepte themelore rreth librit: editimi, shtypja, hedhja në qarkullim dhe variantet⁴⁸. Sigurisht, historiani i librit nuk mund dhe nuk duhet të shndërrohet në bibliograf, por, nga ana tjetër, në punën e tij ai nuk bën të reflektojë naivitet bibliografik ose përfillje të bibliografisë si një fushë të parëndësishme studimi⁴⁹.

Debati për qasjet divergjente ndaj librit, të bibliografit përkundrejt historianit të librit, “ndizet” kur flitet për shkrimin e historisë së librit. Në të

⁴⁶ Neil Harris, *Analytical bibliography: an alternative prospectus*, f. 5.

⁴⁷ *An Introduction to Bibliography for Literary Students*, Oxford: Clarendon Press 1927, f. 5

⁴⁸ Pjesë e një edicioni që ndryshon nga kopjet e tjera të të njëjtës shtypje për shkak të ndryshimeve të parëndësishme në radhitje apo faqosje të bëra gjatë procesit të shtypit ose libërlidhjes, zakonisht shtesa, heqje, ndreqje dhe zhvendosje. Gjatë shek. XVI-XVII variante të tilla ishin shpesh rezultat i lejitimit të autorit të hynte në sallën e makinerisë kur shtypi ishte në vijim.

⁴⁹ Carl Spadoni, *What Historians of the Book Need to Know...* f. 5.

vërtetë, interesat kryesorë të shumicës së bibliografëve nuk janë më kryekëput dhe vetëm te përshkrimi, por edhe te studimi i historisë së realizimit dhe përdorimit të librave dhe dokumenteve të tjera bibliotekare. Pra, historia e librit nuk është e huaj për bibliografin, sado që ai është i vendosur mirë në llogoren tradicionale të përshkrimit. Disiplinat e tjera si historia dhe, veçanërisht, historia kulturore po bëhen çështje të bibliografisë. Nga ngurrimi për pranimin e *bibliografisë historike* si bibliografi e mirëfilltë po kalohet te mendimi që e gjithë bibliografia ka një thelb historik në vetvete. A nuk është ajo e vetmja disiplinë që pa ndërprerë ka studiuar kompozimin, shprehjen formale dhe transmetimin e teksteve nga autorët, tipografët dhe botuesit; shpërndarjen nëpërmjet shitësve të librit me shumicë dhe me pakicë; grumbullimin dhe klasifikimin e tyre prej bibliotekarëve; kuptimin, madje rigjenerimin krijues të tyre, prej lexuesve? Sido që ta përkufizojmë bibliografinë, asnjë pjesë e këtij vargu ndërveprimesh njerëzore dhe institucionale nuk është e huaj për të. Ajo nuk përshkruan vetëm proceset teknike, por edhe ato sociale të transmetimit të teksteve. Kësisoj ajo i vlen historisë së librit si regjistrim i ndryshimit kulturor në mbarë njerëzimin, por edhe në popuj të veçantë⁵⁰.

Në rastin e bibliografisë *deskriptive*, e cila paraqitet si përshkrim i hollësishëm i librave si objekte fizike duke regjistruar madhësinë, formatin, lidhjen dhe kështu me radhë, bibliografi mbërrin në kufijtë e *bibliofilisë*. Ai duhet të gërshetojë dijen bibliografike me dashurinë për librat. Përshkrimi për hir të përshkrimit është si të ndërtohet një banesë në të cilën nuk do të jetojë njeri. Një bibliografi deskriptive bëhet më e dobishme kur kombinohet me kërkim shkencor përkatës në histori. Kjo e bën këtë lloj bibliografie komplekse dhe interesante, vepër shkencore dhe vepër arti.

Shpesh është e vështirë, madje edhe sot, të heqësh një vijë të qartë demarkacioni midis shkencës së bibliografisë dhe pasionit bibliofilik. Në krye të herës bibliografia ose dija mbi librin nuk ishte zhvilluar më tej se një dashuri e madhe për librat, e cila i çonte të pasionuarit pas tyre të kërkonin të rrallën, uniken, interesanten, të bukurën. Profilizimi, ky instrument i mrekullueshëm i zhvillimit të dijes njerëzore, pa i larguar nga njëra-tjetra këto dy drejtime të punës me librin, solli me vete dallimin qartazi të objektit dhe metodës së tyre. Ishte një prirje që erdhi duke u rritur dhe që më vonë u zhvillua në studime bibliografike më të organizuara, të cilat luajtën rol në identifikimin dhe përshkrimin e edicioneve, shtypjeve, ekzemplarëve dhe të çdo elementi tjetër

⁵⁰ Donald Francis McKenzie, *Bibliography and sociology of texts*, Cambridge University Press, 1999, f. 13.

që ka të bëjë me të qenët të informuar rreth asaj që koleksionet bibliotekare, të mëdha ose të vogla, përmbajnë.

Bibliografitë shkojnë që nga listat e veprave të cituara në fund të një libri ose artikulli, thënë ndryshe edhe *lista të burimeve*⁵¹ të përdorura ose të marra në konsideratë në përgatitjen e një vepre, deri te botime të plota, të veçanta. Këto të fundit, pra veprat bibliografike, nuk janë tjetër veçse studim dhe përshkrim sistematik i librave si objekte të prekshme, në të cilët listimi i njësive bibliografike bëhet sipas një sistemi apo rendi të caktuar, - thënë shkurt veprat bibliografike janë produkt i këtyre veprimtarive bibliografike. Ato pasqyrojnë përpjekjet krijuese të një populli, bartës i një kulture kombëtare të veçantë, në fusha të ndryshme si letërsi, mendim shoqëror dhe politik, shkencë etj. dhe, së këtejmi, progresin shpirtëror të shprehur në mënyrën e vet në fjalën e shtypur. Njëherazi, këto bibliografi janë burim i pazëvendësueshëm informacioni dhe njohurie për të gjitha fushat e veprimtarisë krijuese të njeriut. Pikërisht ky fakt provon atë që rëndom pohohet në teorinë e përpunimit të informacionit bibliografik: që bibliografia në thelb është jo vetëm një formë dokumentacioni që depoziton dëshmitë e shkruara të ngjarjeve dhe zhvillimeve që kanë ndodhur, por edhe një instrument efektiv për përdoruesit e saj në përvijimet e zhvillimeve të ardhshme: sociale, letrare, kulturore, shkencore etj.

Jeta me zhvillimet e saj provon dita-ditës rëndësinë e shifrave dhe të dhënave statistikore në të gjitha fushat e studimeve dhe të kërkimit shkencor. Nuk bëjnë përjashtim as bibliotekat, të cilat, gjithashtu, krijojnë dhe përpunojnë “evidencat” e njësive bibliotekare që shërbejnë apo, thënë me një gjuhë më të kohës, të burimeve të informacionit që disponojnë në asetet e veta. Kësisoj ato krijojnë lista me të dhëna numerike për të matur masën e materialit të shkruar dhe të autorëve të tij, si shprehje e arritjeve në të gjitha degët e veprimtarisë njerëzore.

Bibliografia e përgjithshme kombëtare mund të jetë *korrente*⁵², kur ka të bëjë me prodhimin libror bashkëkohës, ose *retrospektive*⁵³, kur ka të bëjë me prodhimin libror të një periudhe të kaluar.

⁵¹ Ndonjëherë të quajtura edhe *lista referencash*.

⁵² Shumica e kombeve europiane i patën bibliografitë e tyre *korrente* që në shek. XIX; veçojmë këtu Francën dhe Gjermaninë, të cilat i praktikuan këto gjetje të mendjes njerëzore që në shek. XVIII. E organizuar kjo lloj bibliografie fillimisht u shfaq si mjet i tregtisë së librit për të lehtësuar shpërndarjen e tij, por që në shekullin e kaluar regjistrimi i rregullt i botimeve të reja u konceptua si funksion i veçantë i një agjencie kombëtare, që zakonisht operon në bibliotekën kombëtare.

⁵³ Bibliografitë e përgjithshme retrospektive qenë shfaqur më herët (shek. XVI) dhe kulmi i tyre në nivel evropian arriti në shek. XIX. Qëllimi i këtyre bibliografive ishte të mbulonin të gjithë periudhën që nga libri i parë i shtypur deri te shfaqja e bibliografive korrente.

Megjithëse këto dy lloje bibliografish duket të kenë mjaft gjëra të përbashkëta, hartimi i bibliografive retrospektive është pakrahasimisht më kompleks. Një bibliografi korrente⁵⁴, si rregull, ndjek ligjin e ekzemplarëve të detyruar (në mjaft vende shfaqja e bibliografive korrente përkon me daljen e këtij ligji), të cilët automatikisht arrijnë në bibliotekën kombëtare ose në institucionin e ngarkuar me hartimin e bibliografisë, kështu që problemi i gjetjes së materialit dhe i përcaktimit të lëndës që do të përfshijë bibliografia nuk ekziston. Ndryshe ngjet me hartimin e një bibliografie retrospektive, e cila nënkupton një kërkim të gjatë dhe të lodhshëm të materialit dhe një studim mjaft të komplikuar për të qartësuar elemente të veçanta bibliografike shpesh të pashënuara në materialin që përshkruhet (probleme të autorësisë, të vendit dhe vitit të botimit, të botuesit etj.)⁵⁵. Është i njohur fakti që hartimi i bibliografive korrente është detyrë e institucioneve të specializuara të ngritura për këtë qëllim ose e departamenteve të specializuara në institucionet ekzistuese, kryesisht bibliotekat kombëtare; ndërkohë që hartimi i bibliografive retrospektive është kryesisht fushë e individëve (theksojmë që kohët e fundit gjithnjë e më tepër kjo po bëhet detyrë e institucioneve - përsëri, si rregull, e bibliotekave kombëtare).

Veç të tjerash, problem kryesor i një bibliografie korrente është të jetë e azhurnuar dhe të sigurojë informacion të shpejtë për të gjithë librat e botuar brenda një periudhe që shtrihet deri në kohën kur ajo botohet; ndërsa detyra kryesore e një bibliografie retrospektive të përgjithshme është të jetë sa më shteruese dhe sa më e saktë që të jetë e mundur brenda rrethanave të dhëna. Është e kuptueshme që koha është një faktor me domethënie të ndryshme për njërin dhe tjetrin bibliografi.

*

Zbrazëtitë në bibliografinë tonë kombëtare kanë qenë njohur me kohë dhe nevoja për plotësimin e saj ka ardhur duke u shtuar. Ndër të parët që hodhi idenë për një bibliografi retrospektive (që në vitin 1916) ishte Mithat Frashëri:

⁵⁴ Një bibliografi korrente regjistron dokumente bibliotekare të botuara momentalisht ose së fundmi me synimin e pasqyrimin të literaturës së sapo dalë nga botimi.

⁵⁵ Në dallim nga ato korrente, bibliografitë retrospektive kanë të bëjnë me identifikimin dhe përshkrimin e materialeve të botuara në të shkuarën, zakonisht duke u kufizuar në një periudhë të caktuar kohore. Më fort janë gjithëpërfshirëse, pra joselektive, si një përpjekje për të listuar të gjitha veprat që plotësojnë kriteret për përfshirje të vendosura nga bibliografi apo agjencia bibliografike që ndërmerr hartimin e saj. Edhe këto bibliografi paraqiten si një rreshtim regjistrimesh, të cilat përfaqësojnë njësi të veçanta bibliografike që përmbajnë të gjitha elementet e të dhënave të nevojshme për një përshkrim.

“Më parë le të shohim sa libra kemi në gjuhët tënë, të ditura dhe të ruajtura; me një fjalë të bëjmë një radhua të monumenteve tanë literarë dhe historikë, një bibliografi”⁵⁶.

Në periudhat që pasuan pati një progres të caktuar në fushën e librit shqip. Ky progres u bë i vështirë të ndiqej, sepse mungonin ose po rriteshin me ngadalësi instrumentet bibliografike të nevojshme. Diskutimet dhe artikujt për domosdoshmërinë e një qasjeje të organizuar dhe sistematike në hartimin e bibliografive erdhën duke u shtuar sidomos në periudhën pas Luftës II Botërore. Ndërkaq, ideja e nevojës së një bibliografie retrospektive ka qenë gjithnjë e pranishme në BKSh dhe institucionet e tjera bibliotekare të vendit. U vendosën rregulla dhe instruksione të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin bibliografik të materialit bibliotekar, sidomos atij që përfshinte librat e shtypur në territorin e Shqipërisë (në shqip, por edhe në gjuhë të huaj), librat shqip të shtypur jashtë vendit etj.

Me rëndësi, sidomos për evidentimin e librave të disponuar, ka qenë përgatitja e materialit *Katallog i arkivit të librit shqip të Bibliotekës Kombëtare. Periudha e paraqirimit deri 1944* (1978). Ai ishte i rezervuar dhe “për përdorim vetëm nga punonjësit e bibliotekës për qëllimin e caktuar” dhe i mbushte vetëm pjesërisht zbrazëtitë, sepse nuk ishte hartuar me pretendimet e një pune bibliografike, por për një qëllim të dobishëm praktik⁵⁷. Ai përfaqësonte thjesht një radhitje në shtyp të ulët të skedave ekzistuese të skedarit kronologjik të BKSh me pluset dhe minuset e atyre skedave dhe skedarëve.

Përgjithësisht, katalogët ose skedarët e bibliotekave përbëjnë pasuri bibliografike. Por, pavarësisht se kompilime bibliografike të rëndësishme, duke mos qenë bibliografi në kuptimin e vërtetë të fjalës, paraqesin probleme në rastin e konsultimit me ta në procesin e hartimit të bibliografive retrospektive. Në të gjitha rastet vlera e shfrytëzimit të regjistrimit që ata bartin varet nga dy faktorë: rëndësia e vetë koleksionit dhe cilësia e katalogut⁵⁸.

⁵⁶ [Lumo Skendo], *Për shkrime të haruarë dhe të pa-diturë*, në *Diturija*, 1916, nr. 2, f. 21.

⁵⁷ Duke konstatuar mungesat e fondit të Arkivit në botimet e periudhës nga fillimet e librit shqip deri më 1945 ky katalog qe hartuar për një qëllim praktik: t’u shpërndahej bibliotekave të tjera në Tiranë dhe rrethe për të evidentuar tituj të munguar, por që ato mund t’i kishin, në mënyrë që pastaj të bëhej riprodhimi i tyre për Fondin e Arkivit të BKSh.

⁵⁸ Dallimi midis një katalogu dhe një bibliografie është i qartë jo vetëm në objektin dhe procedurat e regjistrimit bibliografik, por edhe në qasjen e përdoruesve ndaj tyre. Në të dy rastet kemi të bëjmë me regjistrime ose lista. Në se librat e listuar i bashkojnë elemente të përbashkëta të jashtme, p. sh. të ruajturit fizikisht në të njëjtët rafte të të njëjtës strukturë, të cilën e quajmë bibliotekë, rezultati është një katalog; por, në se librat e listuar kanë elemente të brendshme të përbashkëta p. sh. të njëjtin autor, të njëjtin tipograf/botues, të njëjtën temë, të njëjtën periudhë kohore botimi etj., atëherë lista është ose bibliografi ose i ka cilësitë e nevojshme të bëhet e tillë.

Katalogët ekzistues nuk duhen fetishizuar dhe informacioni bibliografik që ata bartin nuk duhet besuar në mënyrë të verbër. Pasaktësitë e tyre jo të pakta shkojnë nga më të lehtat deri te më të mëdhatë. Ja vetëm tre raste të ndeshura gjatë punës për këtë Bibliografi.

Më i lehti: një shkronjë e shtuar në përshkrim. Skeda ekzistuese për librin *Gjella e Shën Mëris s’ Virgjër* të Jul Varibobës (1762) ka një transliterim të pasaktë të fjalës së parë të rreshtit të fundit të faqes së titullit: *Scitten Mbussat caa Noffi*, e cila është shkruar në trajtën *Scritten*. Fonema *r* e shtuar nuk është se thjesht i ndryshon kuptimin fjalës nga *Shiten* në *Scritten*; është më shumë se kaq, sepse përdoruesi i skedarit/katalogut këtë informacion bibliografik do ta vlerësonte të lidhur jo me *shitjen*, por me *shkrimin*, që të dyja elemente të veprimtarisë librore. Transliterimi i saktë do të ishte *Shiten Mbuzat kā Nofi*⁵⁹, ku *Mbuzati* është emri i vendbanimit arbëresh ku shitet libri dhe *Nofi* është libërshitësi, kuptim ky që i intereson historianit të librit ose bibliofilit në mënyrë të posaçme.

Një rast më i rëndë, në të cilin është tjetërsuar autori:

KENDIMÉT É DYTA / PER ÇUNAT / PRÉJ / D. H. / ATHINE / 1912.

143 f. : me il.; 20 cm. - (MOT I TRÉTE).

Nisur nga inicialet D. H., në kryetitull është shënuar si autor Dervish Hima (!) Por këto inicialet janë të botuesit Diogjen Harito, nën kujdesin e të cilit ishte botuar po në Athinë më 1904 edhe *Fjalori* i Kristoforidhit (rev. *Albania*, nr. 9-1904, f. 109). Autor i këtij teksti është Luigj Gurakuqi, sipas Vehbi Hoti, *Luigj Gurakuqi për shkollën shqipe dhe arsimin kombëtar*, Shkodër 2002, f. 250.

I treti rast shumë i rëndë dhe ja sepse: në skedarët ekzistues figuronte skeda me të dhënat *Ar 21 F 52 Gjuha shqipe. Bukuresht 1888, 48 fl.* Në zonën e shënimeve ishte shkruar se njësia ishte *fotorapid*, se origjinali gjendej në “Bibliotekën e Shtetit Elbasan” dhe se të dhënat e botimit ishin marrë nga faqja e parë ku ishin “shkruar me shkrim dore”, sepse mungonte fl. tit. Nisur nga rregulli sipas të cilit duhen marrë në konsideratë vetëm të dhënat bibliografike të fl. tit. të shtypur (dhe jo ato të dorëshkuara), dyshimi filloi që te titulli. U konstatua, nisur nga tekstet në prozë që libri përmbante, se ai nuk ishte një tekst shkollor i gjuhës shqipe. Dyshimi u rrit kur u konstatua edhe se proza e parë e librit mbante titullin *Ghuha shqip*. Mos vallë, sipas një rregulli tjetër, titulli ishte vënë nga bibliografi ngaqë kishte qenë e pamundur të gjendej? Nga konsultimi i bibliografive të besueshme që mbulojnë botimet e asaj periudhe

⁵⁹ Giulio Variboba, *Vita della Beata Vergine Maria*, Edizione critica e traduzione italiana a cura di Vincenzo Belmonte, Rubbettino Editore 2005, f. 38.

rezultoi që ky titull nuk gjendej në asnjërën prej tyre. Pas njëfarë kohe, mbase me ndihmën e regjistrimit në kujtesë të disa elementeve të parathënies dhe të titullit të prozës së parë, u arrit në përfundimin që nuk kishim të bënim me një njësi bibliografike të veçantë, por me një ekzemplar të njësisë: Terova, Jovan. LEÇITJEA / ŞQIPE ... BUCURESCI / TIPO-LITOGRAFIA DOR. P. CUCU / 1887, 48 f. Pra, rezultoi që libri kishte autor, titullin e kishte ndryshe, kishte tjetër vit botimi dhe kishte jo 48 fletë, por 48 faqe – shkurt bibliografi kishte sajuar një botim që nuk ekzistonte, thënë ndryshe, një botim fantomë. Ekzemplari u hoq nga Fondi i arkivit të librit shqip dhe kaloi në Fondin e përgjithshëm, ku edhe mori nr. përkatës të vendit. Duke mos u marrë me gabimin e bibliografit të bibliotekës së Elbasanit, si mund të kishte ndodhur ky gabim në BKSh, pra që ekzemplari i një botimi ekzistues në koleksionet e saj të shndërrohej në botim më vete? Në shën. 57 të këtij studimi u tregua për një katalog të Arkivit të Librit Shqip në BKSh të vitit 1978, i cili u qe shpërndarë bibliotekave të tjera për të verifikuar mungesat në atë arkiv. Nisur nga data e hyrjes së këtij libri në BKSh (22.3.1978) me siguri, biblioteka e Elbasanit ka konstatuar që libri me titullin e sajuar prej punonjësve të saj mungonte në atë katalog, kështu që e ka nisur atë në BKSh për t’u riprodhuar; nga ana e tyre punonjësit e BKSh nuk kanë qenë në gjendje të konstatojnë se ai libër nuk ishte tjetër veçse ekzemplar i një libri të cilin ata e dispononin me kohë. Po me këtë logjikë, libri ishte futur në Fondin e Arkivit.

III

Identifikimi i botimeve, madje edhe i ekzemplarëve, përmes përshkrimit të përimtuar është qëllimi i çdo përshkrimi bibliografik. Ndaj, si të gjitha punimet bibliografike, edhe kjo Bibliografi synon në radhë të parë identifikimin dhe përshkrimin e veprës në mënyrë të dallueshme nga veprat e tjera ose nga edicione të tjera të vetë asaj. Edhe këtu qëllimi kryesor i përshkrimit të një vepre të shtypur ka qenë pasqyrimi i përgjegjësisë autoriale dhe, aty ku ka qenë e mundur, vendi i saj në historinë e librit shqip. Ka në këtë bibliografi mjaft elemente të historisë sociologjike të librit, vështrim të tij si artifakt kulturor dhe të mënyrës si e pasqyron ai shoqërinë - të gjitha këto të konsideruara si argument për rëndësinë e një libri. Por gjithsesi, si në të gjitha bibliografitë, më shumë rëndësi i është kushtuar përshkrimit fizik të ekzemplarëve sesa përcaktimit të rolit të teksteve në historinë intelektuale.

Si bibliografi kryesisht e karakterit *deskriptiv*, edhe këtu detyrë kryesore ka qenë regjistrimi i të gjithë informacionit bibliografik përkatës, pra shqyrtimi i hollësishtëm i natyrës bibliografike të librit në një formë të paracaktuar. Ky karakter deskriptiv, disa herë i “ekzagjeruar”, ka çuar në një vëmendje gati pedante sidomos ndaj detajeve të ekzemplarit themelor ose përfundimtar të librit, i cili në terminologjinë bibliografike, siç është thënë më lart, thirret *ekzemplar ideal*. Meqenëse ekzemplarët e ndryshëm të një edicioni mund të ndryshojnë nga njëri-tjetri në disa drejtime, bibliografi shqyrton sa më shumë syresh të jetë e mundur me qëllim që të krijojë një përfytyrim-ide të ekzemplarit ideal të edicionit që hulumton⁶⁰. Pra, edhe në këtë Bibliografi është përfshirë çdo informacion bibliografik që ndihmon në përcaktimin e rëndësisë së librit, por duke mos harruar parimin që informacioni, i paktë a i bollshëm qoftë, mbi të gjitha duhet të jetë instruktiv dhe i dobishëm, më shqip: të hyjë në punë.

Nga ana tjetër, u është kushtuar vëmendje e posaçme edhe elementeve fizike-materiale të librave duke patur parasysh që punime të tilla bibliografike, përveç se *deskriptive*, janë edhe *materiale (bibliographie materielle)*, çka tradita anglo-amerikane e quan bibliografi *analitike* dhe që, siç u tha, ka të bëjë me studimin e librave si objekte fizike, me publikimin dhe ndikimin e mënyrës së prodhimit tyre mbi tekstin. Objekt është edhe për këtë punim burimi bibliografik, pra libri, por, në këtë rast ai i vjetër, si *manifestim* i një vepre në të cilën bazohet përshkrimi bibliografik. Këto *manifestime* janë paraqitur në përshkrime bibliografike më vete, pra janë trajtuar si entitete të veçanta sipas kërkesave të FRBR (*Functional Requirements for Bibliographic Records / Kërkesat funksionale për regjistrimet bibliografike*⁶¹). Të gjitha njësitë e një manifestimi normalisht përmbajnë të njëjtin tekst dhe janë identike në formën fizike, por mund të ndryshojnë njëra nga tjetra, si në rastin e një monografie të rilidhur nga biblioteka, siç ndodh rëndom me librat e vjetër edhe të koleksioneve të Bibliotekës sonë Kombëtare.

Ka patur opinione të ndryshme lidhur me procesin e përshkrimit në bibliografitë retrospektive, të cilat përgjithësisht fokusoheshin në dy qëndrime: i pari kërkonte besnikëri të rreptë në përshkrim ndaj origjinalit; i

⁶⁰ Philip Gaskell, *A new introduction to bibliography ...* f. 321.

⁶¹ Entitete të tilla si *vepra, shprehja, manifestimi* dhe *njësia* janë produkte të punës intelektuale të përshkruar në regjistrimet bibliografike. Objekt i punës së bibliografit janë kryesisht entiteti i tretë dhe i katërt, pra *manifestimi*: konkretizimi fizik i *shprehjes* së veprës dhe *njësia*: një ekzemplar i vetëm i *manifestimit* (IFLA, UBCIM Publications – New Series Vol 19, *Functional Requirements for Bibliographic Records*, Final Report, IFLA Study Group on the Functional Requirements for Bibliographic Records. Approved by the Standing Committee of the IFLA Section on Cataloguing, K.G. Saur München 1998, IFLA Cataloguing Section, f. 15 dhe 24).

dyti, përkundrazi, zbatimin e standardeve të përshkrimit. Së këtëjmi edhe dy opsione: njëri, kopjimi me përpikmëri i të dhënave nga botimi që përshkruhet; tjetri, zbatimi i strukturës së ISBD (*International Standard Bibliographic Description*).

Teksti i parë i ISBD(M), pra i standardeve të përshkrimit të monografive⁶², u botua më 1971 si grup rekomandimesh. Ai u përqaftua nga një numër agjencish të bibliografive kombëtare dhe me përkthimin e tekstit origjinal anglisht në gjuhët e tjera filloi të merret në konsideratë nga një numër gjithnjë më i madh vendesh në punën e tyre për rishikimin e rregullave kombëtare të përshkrimit.

Ndërkaq u vu re që librat e vjetër paraqitnin në përshkrim probleme specifike, të cilat nuk trajtoheshin nga ISBD(M). Lindi diskutimi nëse rregullat e tij ishin të mjaftueshme për përshkrimin e tyre apo duheshin bërë amendime dhe rishikime me shënime ose rregulla alternative. U diskutua edhe nëse ishte e nevojshme një ISBD e veçantë. Në fund fitoi mendimi për një ISBD(A) të veçantë: "A" në kuptimin *Ancien, Antique, Antiquarian, Alt* etj., dhe më 1980 u botua edicioni i parë i saj.

ISBD(A)⁶³ është hartuar për përshkrimin e librave të vjetër në skedarë, bibliografi retrospektive ose baza të dhënash. Në të jepen opsione të ndryshme lidhur me elemente të tilla, si pikësimi, botimi, palosja e fletëve të letrës, shënimet etj. Por, nga ana tjetër, çdo agjenci bibliografike është e lirë që, për arsye pragmatike, të bëjë përshtatjen e zgjedhjes së saj të opsioneve.

ISBD(A) specifikon kërkesat për përshkrimin dhe identifikimin e botimeve të vjetra; pra, qëllimi i saj është të sigurojë një transkriptim plotësisht të saktë të informacionit bibliografik që përmban fleta e titullit, të mundësojë identifikimin e veprave të ndryshme, si edhe të edicioneve të ndryshme të të njëjtës vepër etj.

Përse njësi të caktuara të një mediumi si ai i fjalës së shkruar u gjykua të kenë një trajtim të veçantë? Përgjigjja është se përshkrimet e librave të vjetër⁶⁴ zakonisht formulohen për një qëllim disi të ndryshëm nga ai i regjistrimit të informacionit bibliografik të botimeve korrente. Këtu synohet që veçanërisht struktura e zërit bibliografik të jetë e përshtatshme dhe e dobishme për

⁶² Termi *botim monografik* si një edicion njëpjesësh në bibliografi ka një kuptim ndryshe nga ai në fushën e studimeve apo të botimeve (Robert L. Maxwell, *Doracaku që shpjegon dhe ilustron rregullat anglo-amerikane të katalogimit*, Shoqata Amerikane e Bibliotekave, botim shqip, Çikago 2004, f. 115).

⁶³ IFLA. ISBD(A): *International Standard Bibliographic Description for Older Monographic Publications (Antiquarian)* 2006 Revision.

⁶⁴ Me termin *libra të vjetër* kuptohen kryesisht librat e prodhuar para shfaqjes së shtypit me makina në shek. XIX dhe në të përfshihen si librat që kanë qenë botuar për shitje, ashtu edhe ata që janë shtypur në pak kopje, madje edhe në një të vetme, për shpërndarje private ose të kufizuara. Por ISBD(A) mund të përdoret edhe për të përgatitur përshkrime për botime të mëvonshme.

përdoruesin, i cili kërkon përshkrim të hollësishëm për një njësi nga një autor i caktuar ose mbi një temë të caktuar.

*

Si në çdo përshkrim tjetër bibliografik, edhe në rastin e botimeve të vjetra të përfshira në këtë Bibliografi janë zbatuar standardet dhe rregullat përkatëse ndërkombëtare të katalogimit dhe konkretisht standardet e përshkrimit bibliografik ISBD (*International Standard Bibliographic Description*) dhe rregullat anglo-amerikane të katalogimit AACR2 (*Anglo-American Cataloguing Rules*, second edition). Njëkohësisht duhet theksuar se kjo është e para bibliografi shqiptare e hartuar duke mbajtur parasysh edhe ISBD(A) (*International Standard Bibliographic Description for Older Monographic Publications*) me përshtatjet e nevojshme.

Është zbatuar, kështu, rregulli sipas të cilit bibliografi pasqyron çfarë sheh në burimin e informacionit dhe konkretisht në fletën e titullit. Për librat ku fleta e titullit ose informacioni për ndonjë element bibliografik në të kanë qenë të munguar të dhënat janë marrë nga burime të tjera, si kopertina, shpina e librit, titulli i shkurtuar në fletën para faqes së titullit, fletët e tjera paraprijëse, informacioni i shtypur dhe i nënvizuar në pjesën e sipërme të çdo faqeje të librit, fjalët nistore të tekstit, fjalët përmbyllëse të tij etj.; por edhe nga parathëniet, pasthëniet dhe të tjera elemente brenda botimit. Informacioni i marrë nga burime të tjera ndryshe nga këta si edhe të dhënat që janë formuluar nga bibliografi në bazë të analizës së tij, sipas rregullit, janë futur në kllapa katrore [...] në rastet kur ato janë tejshkruar si pjesë e zonës së përshkrimit bibliografik. Përndryshe, një informacion i tillë është dhënë pa kllapa katrore në zonën e shënimeve të bibliografit. Pra, burimi kryesor i të dhënave për përshkrim ka qenë vetë njësia bibliografike, ndërthurur kjo me të dhënat që janë marrë nga studime, artikuj, enciklopedi, site Interneti etj. jashtë botimit - gjithnjë duke i dhënë përparësi një burimi brenda botimit sesa një burimi jashtë tij ose burimit që ka të dhëna më të plota.

Është bërë kujdes dhe është zbatuar kërkesa sipas së cilës i përshkrueshëm është ai burim në botim që është i botuesit. Asnjë pjesë e botimit të përshkruar nuk është marrë në konsideratë si burim i caktuar nëse nuk ka qenë pjesë e botimit si e tillë. P.sh. një kopertinë ose shpinë libri është përdorur si burim të dhënash vetëm nëse ka qenë e qartë se botimi ka dalë nga shtypshkronja dhe ka qarkulluar me atë lidhje.

Në ato pak raste kur është konstatuar që informacioni i dhënë në botim është fiktiv ose i pasaktë, është bërë korrigjimi i tij në kllapa katrore dhe është dhënë shënim shpjegues në zonën e shënimeve të bibliografit.

Në këtë bibliografi retrospektive është zbatuar kërkesa e rëndësishme e ISBD(A) për përshkrimin bibliografik të librave të vjetër: tejshkrimi i elementeve të të dhënave të një botimi përgjithësisht ashtu si ato shfaqen, pa zhvendosje ose ndërrim vendesh ose forma të tjera ndërhyrjesh si ato që praktikohen në bibliografitë korrente sipas AACR2. Në zbatim të kësaj kërkesë, është shmangur ose është modifikuar në këtë bibliografi pikësimi i aplikuar nga BKSh si agjenci bibliografike kombëtare: për të paraprirë ose përfunduar informacionin e dhënë në çdo element a zonë të përshkrimit bibliografik. Kësisoj, transkriptimi jo vetëm i elementeve bibliografike të faqes së titullit, por edhe i pikësimit origjinal në të, ka rezultuar, të themi, në shmangie të pikësimit dhe strukturës së ISBD(M) për faktin e thjeshtë se standardi i përshkrimit në bibliografitë retrospektive ISBD(A) tenton t'i ruajë fjalët dhe renditjen e tyre ashtu siç janë në faqen e titullit, përfshirë edhe pikësimin. Me fjalë të tjera, shenjat e pikësimit në këtë bibliografi janë riprodhuar si në fletën e titullit, duke mos u zbatuar vendosja e tyre sipas rregullave të përshkrimit bibliografik për shkak se është ndjekur parimi i regjistrimit fotografik. Për pasojë, drejtshkrimi dhe alfabeti po ashtu nuk janë mbajtur parasysh, shkronjat e vogla ose të mëdha dhe çdo element-informacioni i fletës së titullit është paraqitur siç rezulton në të.

Standardi ISBD(A) ka të bëjë me përshkrimin e ekzemplarëve të rregullt të materialeve bibliotekare. Ai nuk parashikon situata (jo të pakta në koleksionet e BKSh) në të cilat nuk ekzistojnë të dhëna për botimin. As situata kur duhet të përshkruhet një ekzemplar i dëmtuar dhe me të dhëna cinguar ose të humbura pa ndihmën e një përshkrimi bibliografik të mëparshëm të atij botimi. Në raste të tilla, kur ka qenë e mundur, është përdorur përshkrimi i bibliografive të mëparshme, çfarë është pasqyruar në zonën e shënimeve të bibliografit. Ndërkaq, parregullsitë dhe karakteristikat e veçanta të ekzemplarit që përshkruhet janë shënuar në zonën e përshkrimit të gjendjes fizike të ekzemplarëve. Në rastet kur nuk janë gjetur përshkrime ekzemplarësh të plotë, janë përshkruar ekzemplarët e dëmtuar dhe të paplotë që gjenden në BK, çfarë do të thotë që përshkrimi nuk është deri në fund i besueshëm.

*

Përdorimi i kësaj bibliografie, ashtu si edhe i të tjerave, kërkon disa shënime ndihmuese për përdoruesit (studiuues, lexues të zakonshëm, bibliotekarë të referencave etj.) në formë udhëheqjeje, udhëzimi, sqarimi a këshillimi.

Si në të gjitha bibliografitë, edhe këtu struktura e regjistrimit bibliografik të njëjësive bibliotekare përbëhet prej pesë shtresash:

- | | |
|-------------------------------------|----------------------------|
| A. kryetitulli | Ç. zona e gjendjes fizike |
| B. zona e përshkrimit bibliografik | D. zona e numrit të vendit |
| C. zona e shënimeve të bibliografit | |

A	—	<p>Kristoforidhi, Kostandin ALFAVITAR SHQIP / Prei Konstantinit Kristoforidhit, Elbasanasit / Pa vd, [1867]. 31 f. : me il., [3] fl.; 17 cm., [tirazhi 2000].</p> <p style="text-align: center;">Abetare toskërisht me alfabet grek. Titulli dhe autori marrë nga f. 1 (e panumërtuar). Viti i botimit sipas: Xh. Lloshi, <i>Rreth alfabetit të shqipes</i>, Logos-A, 2008, f. 225. Tirazhi sipas: <i>Kristoforidhi përmes dokumentimit...f. 174</i>. Botuar nga Shoqëria e Broshurave Fetare (RTS-Religious Tract Society), një ent i madh botues britanik i literaturës së krishtere, posaçërisht asaj ungjillore, (themeluar në Londër më 1799). Shoqëria Biblike në Londër ...</p> <p>89 S 41 ka vulën “BIBLIOTHEQUE DE SAMY-BEY FRASCHERI” (edhe turqisht). S 53 T 44 ka vulën “BIBLËJOTEKA KOMBËTARE – TIRANË”.</p> <p>89 S 41 S 53 T 44</p>
B	/	
C	/	
Ç	/	
D	/	

A. *Kryetitulli* (mbiemri dhe emri i autorit ose titulli të veprës pa autor), i cili vjen fill pas numrit rendor të regjistrimit i shtypur me shkronja të zeza, ose **bold** në terminologjinë kompjuterike, për ta dalluar nga pjesa tjetër e tekstit të regjistrimit. Kur nuk ka qenë e mundur të përcaktohet autorësia, regjistrimi ka filluar me titullin e njësisë bibliotekare që përshkruhet si kryetitull. Kështu është vepruar edhe për përkthimet⁶⁵.

⁶⁵ Në rastet e veprave pa autorë është shtypur me **bold** në kryetitull vetëm fjala e parë e titullit të saj.

Kryetitulli, ose elementi hyrës në përshkrim, ka përcaktuar vendin e skedës (këtu të regjistrimit) në renditjen alfabetike të tërësisë së librave brenda një viti botimi. Pra, renditja është kronologjike dhe brenda viteve sipas rendit alfabetik të mbiemrit të autorëve ose shkronjës *nistore* të fjalës së parë të titullit të librit.

Emrat e autorëve në kryetitull janë shkruar sipas standardeve që zbaton BKSh në skedarët e saj tradicionalë dhe elektronikë. Pra, pavarësisht formës me të cilën paraqiten në faqen e titullit të materialit që përshkruhet, por edhe në zonën e përshkrimit bibliografik, në kryetitull ata janë pasqyruar të njësuar, në formën e vet më të zakonshme dhe më të njohur për autorët vendës⁶⁶.

Autorët e veprave anonime si edhe autorët që kanë përdorur pseudonime ose iniciale në kryetitull janë shënuar me emrin e tyre të vërtetë duke dhënë shpjegimet përkatëse dhe burimin e identifikimit në zonën e shënimeve të bibliografit. Në disa raste, kur ka qenë e pamundur që inicialet dhe pseudonimet të “deshifrohen”, ato janë vendosur në kryetitull siç janë në libër.

Emrat e autorëve të huaj të veprave të përkthyer në kryetitull janë shkruar në formën origjinale të gjuhës së autorit, pavarësisht si janë dhënë në burimin e informacionit që përshkruhet. Janë dhënë në alfabet latin për autorë nga vende ku përdoret alfabeti latin; për autorë që përdorin alfabetë të tjera (cirilik, grek, turko-arab) emrat janë transliteruar sipas rregullave dhe standardeve ndërkombëtare.

Kjo ka mundësuar që, brenda një viti, veprat e një autori vendës ose të huaj të grupohen së bashku, ashtu si në skedarin kronologjik të BKSh. Për trajtat e tjera të emrave të autorëve, shpesh mjaft të rëndësishme si burim informacioni ose pika hyrëse në bibliografi, përdoruesit orientohen nga referimet përkatëse në *Treguesin e autorëve*, ku krahas trajtës standarde, janë pasqyruar në formë referencash të gjitha trajtat e tjera të emrave të autorëve të gjetura në faqen e titullit, përfshirë edhe iniciale ose pseudonime.

Në rastin e veprave *apokrifë*, pra me autor të paqartë ose të pasigurt, nuk është mbajtur anësi pro ose kundër. P.sh. për përkthimin e librit “De imitatione Christi” është respektuar zgjedhja e botuesit në shqip, i cili ka dhënë si autor edhe njërin edhe tjetrin prej dy të hamendësuarve, duke i shtypur emrat e tyre me shkronja të zeza: **KEMPIS** dhe **GIOVANNI GERSEN** (regjistrimi nr. 96). Te *Treguesi i autorëve* janë shënuar emrat e të dyve: *Thomas à Kempis* dhe *Giovanni Gersen*.

B. Zona e përshkrimit bibliografik (autor, titull, botues, vend dhe vit botimi, tirazh, çmim etj.), të dhënat e të cilës, si rregull, janë marrë nga fleta e titullit.

⁶⁶ Mes formave të ndryshme të emrit të një autori është zgjedhur ajo më e përdorshmeja.

Kur këto elemente bibliografike kanë qenë të ndara pa përsëritur njëri-tjetrin në dy faqet përballë ose gjenden të shpërndara nëpër libër në faqe të ndryshme, fletë titulli janë konsideruar këto faqe së bashku (shih, p.sh., regjistrimin nr. 68 për *Abetar shqip* 1872 të K. Kristoforidhit).

Është ndjekur parimi i regjistrimit fotografik të të dhënave që gjenden në fletën e titullit; pra, përshkrimi bibliografik nuk është bërë në mënyrë të standardizuar dhe informacioni është riprodhuar në formë *facsimile*⁶⁷.

Edhe pse në kryetitull, siç u tha, janë vendosur në formë të njësuar ashtu siç njihen më shumë, në këtë zonë *emrat e autorëve* janë shënuar në trajtën që është dhënë në materialin që përshkruhet (me emër dhe mbiemër, pseudonim, iniciale si dhe me fjalët që përcaktojnë rolin e tij në hartimin e veprës).

Titujt e veprave në këtë zonë janë transkribuar ashtu siç gjenden në faqen e titullit. Përgjithësisht titujt e librave të vjetër janë shumë të gjatë dhe kompleksë⁶⁸. Pavarësisht kësaj, edhe në raste njësisht të tilla është vepruar sipas ISBD(A) dhe në përputhje me qëllimin e kësaj bibliografie për saktësi në dhënie të informacionit bibliografik.

Kur një element i tillë i rëndësishëm i përshkrimit bibliografik si titulli shfaqet në kopertinë në trajtë të ndryshme nga ajo e faqes së titullit ky fakt është pasqyruar në këtë zonë; po ashtu janë pasqyruar edhe titujt alternativë.

Falë teknologjisë së sotme kompjuterike, disa simbole apo shkronja të veçanta dhe origjinale të përdorura nga autorë të vjetër shqiptarë nuk janë transkribuar,⁶⁹ por janë dhënë si në libër me qëllimin që përdoruesi i kësaj bibliografie të njoftohet për to; p.sh. **CONCIΛ / PROVINTIAAΛI / O / CUNVENDI / ARBENIT / Mbelieꝛune...** ose **GHIELLA / E / S. MVRIS / VIRGHIVR / Scruar mbo viers Arbërist ...** Po ashtu, nuk është transkribuar në botimet e hershme *v* për *u*, theksat janë dhënë ashtu si paraqiten në faqen e titullit etj. Por në disa raste, për arsye të ndryshme, i është ikur parimit të riprodhimit fotografik të informacionit; p.sh. kur shkronjat e munguara në fjalë të titullit janë shtuar në kllapa katrore, p.sh. **ALVANIKI MELISSA / (Bīlietta Sskiypitare) / SYNGRAMMA / [A]LVANO ELLINIKON**.

⁶⁷ Me ndonjë përjashtim. P.sh. kur informacioni që tregon se libri është pjesë e një kolane apo serie botimesh gjendet, si zakonisht, në krye të fletës së titullit ai është spostuar i futur në kllapa (...) dhe është vendosur në nënzonën e serisë pas përshkrimit fizik, siç edhe standardi ISBD e kërkon.

⁶⁸ Duke qenë se titujt e veprave të hershme janë shumë të gjatë dhe të stërholluar, faqet e titullit në to janë plot përpjekjeje për efekte arkaike, ndryshe nga ato të botimeve të kohëve moderne që tentojnë të japin titullin sa më shkurt, me stil sa më konciz duke përdorur hapësirat po aq sa shkronjat.

⁶⁹ Titujt, që për shenjat grafike të veçanta nuk ka qenë e mundur të jepjen me karakteret e disponueshme nga tipografia e kohës, Dh. S. Shuteriqi i ka paraqitur në cliché te *Shkrimet shqipe...* 1976.

Për librat që nuk kanë faqe titulli ky është marrë nga burime të tjera brenda dhe jashtë tyre. Përndryshe ai është sajuar duke u marrë nga rreshtat e parë të tekstit, gjithmonë i futur në kllapa katrore dhe duke e pasqyruar këtë fakt në shënime.

P.sh. regjistrimi nr. 552

[Per Kshnnélla] / Pa vd.

I mungon kopertina dhe fl. tit.

Titulli sipas vjershës me të cilën çelet libri.

Titulli dhe elementet e tjera të informacionit bibliografik të fletës së titullit të njërive të përshkruara janë dhënë në mënyrë lineare, të ndara me vijë të pjerrët (/).

Janë paraqitur në përshkrim edhe elemente të *përgjegjësisë autoriale dytësore* si përgatitës ose kuratorë, përkthyes, autorë të para&pasthënieve etj. Për këtë janë shfrytëzuar kryesisht të dhënat fletës së titullit, por edhe të dhënat e përfuara nga hulumtime në burime të shumta informacioni brenda dhe jashtë librit. Me këtë logjikë janë përfshirë te *Treguesi i autorëve* edhe autorët dytësorë.

Epigrafet, citimet, dedikimet dhe elemente të tjera jobibliografike të kësaj natyre, sipas një praktike të njohur botërore, janë shmangur dhe, pavarësisht se kanë qenë të shtypshkruara në faqen e titullit, nuk janë përfshirë në përshkrim.

Kur kanë qenë në fletën e titullit, janë dhënë edhe të *dhënat e botimit*, si emrat e tipografëve, botuesve, editorëve etj. jo vetëm për shkak të parimit të regjistrimit fotografik të ndjekur në këtë bibliografi, por edhe të rëndësisë së tyre historike dhe kulturore. Këto attribute edhe në historinë e librit shqip kanë qenë të pandara fillimisht; pastaj janë profilizuar si veprimtari më vete. Për të mos rënduar përshkrimin me informacion jo të natyrës bibliografike, si *të dhëna tipografike* janë shënuar vendi i shtypjes dhe tipografi përkatës, por nuk janë shënuar këtu adresat e tyre (rruga, nr. etj.), edhe kur ato kanë qenë në fletën e titullit; ndërkohë janë shënuar adresat e shitësve të librit si i vetmi informacion ose mundësi për të pasqyruar fillimet e këtij elementi të kulturës së librit, pra tregtisë, si hallkë më vete, me rëndësi edhe kjo për historinë e librit shqip.

Për sa i përket *vendit të botimit ose të shtypjes* janë mbajtur trajtat siç gjenden në fletën e titullit, qofshin edhe arkaike ose të huaja (latinisht, greqisht, sllavisht, turqisht etj.) dhe dialektore, pra ato janë tejkshkruar siç janë parë. Kur nuk ka qenë e mundur të përcaktohet vendi i botimit, në nënzonën përkatëse të përshkrimit është shënuar *pa vd.*

Në rastin e librave me të dhëna të botimit false⁷⁰ ose fiktive⁷¹, për të fshehur kryesisht vendin e botimit, janë bërë shënime dhe interpretimet përkatëse. Në librin shqip të periudhës që mbulon kjo bibliografi ka disa pak botime të tilla, të themi “klandestine”, kryesisht për arsye politike në kushtet e pushtimit osman të vendit. Vend botimi fiktiv konsiderohet ai i regjistrimit nr. 324:

Scpataraku, Banucs

HIJA / E / SKANDERBEUT / Mretit Scycpnies / PREI / BANUCS
SCPATARAKUT / Shtypun / NE / ELBASAN⁷² / 1907.

Ose ai i regjistrimit nr. 197:

[Curani, Stefan]

T’ nollunat e Scycpniis / prei / gni Gheghet ci don vënnin e vet / Skenderie⁷³
/ 1898.

Viti i botimit gjithashtu është shënuar si në fletën e titullit. Në rastet kur ka qenë i shtypur me shkronja ose numra romakë, është ndjekur me numra arabë të futur në kllapa katrore, p.sh. M.DC.XXI. [1621]. Kur viti dhe elemente të tjera të rëndësishme të të dhënave të botimit etj. shfaqen në kopertinë ose diku tjetër në trajtë të ndryshme nga ajo e fletës së titullit kjo është shënuar në zonën e shënimeve të bibliografit.

Kur në libër dhe në burime jashtë tij nuk ka qenë e mundur të identifikohet viti i botimit, në vend të tij është shënuar viti i dhënies së lejes për shtyp⁷⁴ ose data e *copyright*-it duke u pasqyruar ky fakt në zonën e shënimeve të bibliografit.

⁷⁰ Një e dhënë konsiderohet false në qoftë se vendi i shtypjes ose i botimit, por edhe tipografi ose botuesi, janë qëllimisht të falsifikuar.

⁷¹ Në qoftë se njëri prej këtyre elementeve është i trilluar ai konsiderohet fiktiv; përzierje të elementeve false dhe fiktive janë të mundshme.

⁷² K. Bevapi dhe A. Ballhysa për Elbananin si vendi ku është shtypur libri konsiderohet *fals*. Sipas tyre ky libër është shtypur në shtypshkronjën e “Zojës së Paperlyeme”, Shkodër. (*Rrezatime të trashëgimisë kulturore shkodrane në fushën e botimeve - “Hija e Skanderbegut” e Banush Shpatarakut – në Shkodra në shekuj*, seminari i 6-të ndërkombëtar 26 nëntor 2005, vëll. II, Shkodër 2006, f. 65-69).

⁷³ Sipas J. Rrotës vendi i botimit Skenderie (Aleksandri) është një fals. (*Për historinë e alfabetit shqyp*, f. 74).

⁷⁴ Duhet mbajtur parasysh që jo gjithmonë data e *imprimatur*-it (lejes për t’u shtypur libri) korrespondon me vitin e botimit. P. sh. leja për shtyp mund të jetë dhënë vërtet në një vit të caktuar, por botimi mund të mos jetë realizuar, për arsye të ndryshme, po në atë vit. Në kushtet e teknologjisë tipografike të atyre kohëve p. sh. nuk mund të mendohet që një libër me *imprimatur* të dhënë në muajin dhjetor të një viti të jetë shtypur brenda po atij viti.

Sipas një praktike të njohur, librat pa vit botimi në fletën e titullit, për të cilët ka qenë e pamundur të sigurohet një informacion i tillë në burime të tjera, janë grupuar në fund të bibliografisë nën emërtimin *Pa vit botimi* duke ndjekur rendin alfabetik.

Në këtë zonë janë pasqyruar edhe të dhënat për përsëritjen e botimit, kryesisht numrat që tregojnë rendin e tij, ndryshimet, ripunimet, përmirësimet etj. në të. Përdoruesi i kujdesshëm do të konstatojë që në këtë bibliografi nuk do të ketë një ndarje qartazi të termave të tillë si *edicion* dhe *botim*, për faktin që kemi nënvizuar më lart se pasqyrimi i të dhënave bibliografike ka ndjekur parimin e regjistrimit fotografik të tyre, siç janë paraqitur në fletën e titullit. Në rast se nocionet *edicion* dhe *botim* dallohen qartazi në kulturën latine⁷⁵ dhe atë anglo-saksone⁷⁶, në terminologjinë përkatëse në gjuhën shqipe ka konfuzion dhe pasaktësi në përdorimin e tyre, madje termi *botim* ngatërrohet me termin *edicion*. Kështu, perceptimi i paqartë i këtyre termave në praktikën tonë botuese, tipografike, madje edhe bibliografike, pasqyrohet edhe te *Fjalori i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë 2002, në të cilin termi *Edicion* nuk është i përfshirë, ndërkohë që kuptimi i tij gjendet te zëri *Botim*⁷⁷. Në tipografi/botime, por edhe në bibliografi, termi *edicion* përfshin të gjithë ekzemplarët e një libri të shtypur në të njëjtin tirazh nga e njëjta radhitje. Një *edicion* mund të përfshijë disa shtypje në të cilat radhitja qëndron e pandryshuar. Në botimet më të vjetra termat *shtyp* dhe *edicion* janë pothuajse sinonimikë, duke qenë se forma ku ishin radhitur shkronjat prej plumbi prishej për t'u ripërdorur pas shtypjes së parë.

Të dhënat fizike (numërtimi dhe formati) janë shënuar sipas dokumenteve bibliotekare që disponon BK. Në raste të rralla, kur të dhëna të tilla nuk ka qenë e mundur të identifikohen (ekzemplarë të cinguar dhe të dëmtuar), ato janë marrë nga përshkrime në bibliografi autoritative, gjithnjë kjo e pasqyruar në zonën e shënimeve.

Numri i faqeve është shprehur ashtu si ka qenë numërtimi i tyre (shifra romake apo arabe, me shkronja). Në qoftë se parathëniet, hyrjet, prologët etj., si edhe pasthëniet, epilogët etj. janë numërtuar më vete (jo në mënyrë të vijueshme), ashtu edhe janë paraqitur: të ndara me presje. Kur ka patur

⁷⁵ *Petit Robert 1: Edition*: 3. tërësia e ekzemplarëve të një vepre të publikuar; seria e ekzemplarëve të edituar njëherësh dhe *Publication*: 1. veprimi i publikimit, procedurë që ka për objekt të bëjë të njohur për të gjithë një vepër.

⁷⁶ *World Book Dictionary*, A Thorndike-Barnhart Dictionary: *Edition*: 1. Të gjitha kopjet e një libri të nxjerra në të njëjtën kohë dhe *Publication*: 1. Libër dhe çdo gjë tjetër e publikuar, 2. shtypja dhe shitja e librave, 3. shitja e parë publike e një libri.

⁷⁷ *Botim*: 3. tërësia e kopjeve të një vepre të shtypura njëherësh. *Botim* i parë (i dytë), *botim* i përmirësuar...

faqe apo fletë të panumërtuara, ato janë numërtuar nga bibliografi dhe janë vënë në kllapa katrore [...]. Numërtimi ka përfshirë të gjitha faqet që kanë tekst të shtypur; rregullisht faqet e bardha nuk janë konsideruar. Për veprat me disa vëllime që janë përshkruar ndaras, numërtimi i faqeve në nënzonën e përshkrimit fizik është dhënë i vijueshëm ose i veçantë për secilin vëllim, pra ashtu si ka qenë në vetë vëllimet. Në këtë zonë është dhënë edhe informacioni i duhur kur në libër ka faqe ose fletë me vizatime, piktura, portrete, figura, harta, facsimile etj., të gjitha këto nën emërtimin *me il*.

Formati i librit është dhënë duke shënuar në cm. lartësinë e tij.

Tirazhi dhe çmimi i librit janë pasqyruar në qoftë se kanë qenë shënuar në libër; kur janë gjetur jashtë tij janë futur në [...]. Përpjekje të veçanta për sigurimin e tyre nuk janë bërë, veçse kur kanë dalë në burime interesimi për elemente kryesore të përshkrimit bibliografik (autor, titull, botues, vend dhe vit botimi etj.).

Gjithnjë në respekt të zbatimit të parimit të regjistrimit fotografik të informacionit të faqes së titullit janë pasqyruar të gjitha raste kur kanë qenë prezent në të shënimet për lejimin e shtypjes: *imprimatur*⁷⁸, që autoritetet kishtarë ose ato laike deklaronin për një vepër pasi e kishin shqyrtuar atë. Në gjuhën bibliografike dhe tipografike terma të ngjashëm që shprehin miratimin ishin edhe "*approbatio*", "*approbatur*", "*admittitur et imprimatur*" që shënoheshin në fillim ose në fund të librit me formulën: "*Con licenza dei Superiori*"⁷⁹. Por nuk janë shënuar terma të tillë si "*Privilegio*"⁸⁰, "*Nihil obstat*"⁸¹, "*Cum permissu superiorum*"⁸² etj., të cilët gjenden jo në faqe të titullit, por në vende të tjera të tij.

C. *Zona e shënimeve të bibliografit ose sheshi i mejdanit* për të, ku jepen të dhëna për informacionin e munguar në fletën e titullit, për burimet e përdorura për sigurimin e tij, të dhëna që lidhen me historinë e botimit të librit etj. Shënimet

⁷⁸ *Imprimatur-i* (lat. "të shtypet"), leja e dhënë nga një autoritet kishtar ose shekullar, zakonisht e shtypur në verso të faqes së titullit të një libri, që tregon emrin e licencuesit dhe datën në të cilën ajo është dhënë duke nënkuptuar që ai (libri) nuk përmban gabime në çështje të doktrinës dhe të moralit katolik, prandaj lejohet të lexohet nga bestarët katolikë. Një *imprimatur* mund të përfshijë deri në tri vula miratuese, çdonjëra e nënshkruar dhe e datuar. Gjendet më shpesh në librat e shtypur gjatë shekujve XVI-XVII. Përdoret ende në botimet doktrinare të Kishës Katolike Romane.

⁷⁹ Hans Tuzzi *Collezione libri antichi, rari, di pregio*, Milano 2000, f. 184.

⁸⁰ Posedimi nga një botues ose tipograf i licensës dhënë nga një autoritet ose agjenci administrative për botimin ("bërjen publike") të një vepre të caktuar.

⁸¹ (lat. "asgjë s'pengon"), shënim që tregon se vepra është shqyrtuar dhe miratuar nga censori i dioqezës pa gjetur në të asnjë gabim doktrinor ose moral.

⁸² Nganjëherë i gjithi ky proces përfundohet me fjalinë *Cum permissu superiorum* (Me lejimin e eprorëve).

janë parë si një mundësi për të plotësuar ose shpjeguar elementet e përfshira në zonën e përshkrimit dhe përmbajnë informacion ose interpretime që paraqesin rëndësi të veçantë në lidhje me elementet bibliografike të librit. Nëse ky punim bibliografik sjell ndonjë risi në veprimtarinë e sotme bibliografike, ajo duhet kërkuar kryesisht në këtë zonë. Madje do të thoja që kjo risi mund të shihet në radhë të parë të kthimi në metodat tradicionale të një Legrandi ose të një Shuteriqi të ngopjes me informacion të kësaj zone. Vetëm se në të mirë të punës së sotme me librin e kësaj periudhe vijnë padyshim dukuri të tilla të rëndësishme, si rritja e studimeve përkatëse në rrafsh mbarëkombëtar dhe më tej; mundësitë dhe komoditeti i komunikimit në një botë ku informacioni nuk njih pengesa kufijsh gjeografikë, ideologjikë etj.; mrekullia e Internetit si burim i pashtershëm informacioni për vepra dhe autorë nga më të ndryshmit; shfrytëzimi on-line i skedarëve elektronikë të bibliotekave brenda dhe jashtë vendit etj.

Kjo zonë përmban informacion kryesisht për autorësinë; për botuesit, përgatitësit e botimit, përkthyesit etj. që nuk përmenden në fletën e titullit; për gjuhën e tekstit kur kjo nuk specifikohet në fletën e titullit; për burimet e informacionit shtesë të botimit; për të dhënat false apo fiktive të tij; për parathëniet, hyrjet, shënime etj.; për kontribues kryesorë të tekstit që nuk sinjalizohen në fletën e titullit etj. Duke mos qenë një bibliografi e llojit *të arsyetuar* (apo *e adnotuar*) në asnjë rast nuk përshkruhet në këtë zonë përmbajtja e veprave.

Ç. *Zona e gjendjes fizike*, në të cilën shënohen veçanësitë fizike të njësisë⁸³ që përshkruhet, si: dëmtime, fletë që mungojnë, lidhje ose vendosje gabim të fletëve, rilidhje, bashkëlidhje me njësi të tjera; shënime të dorëshkuara në faqen e titullit, nëpër margina ose në fund të tij⁸⁴, shënime të prejardhjes (ex-libris, vula të bibliotekave⁸⁵, të ish-poseduesve të librit⁸⁶, autografë të autorëve⁸⁷ etj.).

⁸³ *Njësia* është një entitet konkret, një objekt fizik i vetëm (p.sh. një ekzemplar i një monografie njëvëllimëshe, një audio kasetë etj.) Në kuptimin e përmbajtjes intelektuale dhe të formës fizike, një njësi që demonstron një *manifestim* është e njëjtë me vetë *manifestimin*. Megjithatë mund të ketë ndryshime nga një *njësi* të tjetra edhe kur ato janë shprehje e të njëjtit *manifestim*, kur këto ndryshime janë pasojë e veprimeve të jashtme të prodhuesit të manifestimit, p.sh. dëmtime që ndodhin pasi është prodhuar *njësia*, lidhje e kryer nga biblioteka etj. (IFLA, *Functional Requirements for Bibliographic Records ...* f. 15 dhe 24).

⁸⁴ Bien në sy sidomos shënime të shpeshta të Mithat Frashërit lidhur me blerjen prej tij të botimeve me vlerë: emri i bukinistit prej të cilit është blerë libri, vendi i blerjes, çmimi etj.

⁸⁵ Kryesisht të institucioneve të ndryshme fetare, si ato katolike, të librarisë “Lumo Skendo”, bibliotekës Carnarvon etj.

⁸⁶ Asdreni, Sotir Kolea, Pashko Bardhi, Martin e Mirash Ivanaj, Mitrush Kuteli, Dhimitër S. Shuteriqi etj.

⁸⁷ Çajupi, Gjergj Fishta, Zef Skirò, Leonardo De Martino, Shtjefën Gjeçovi, Karl Gurakuqi etj.

Në këtë zonë janë pasqyruar edhe shënime në të cilat identifikohen dhuruesit e ekzemplarëve të ndryshëm⁸⁸ (shpesh përmes tyre përcaktohet koha në të cilën njëri ose tjetri ekzemplar ka hyrë në koleksionet e BKSh). Këto elemente ndihmojnë përdoruesin të zgjedhë paraprakisht dhe të kërkojë t’i shërbehët ekzemplari i padëmtuar ose ndonjë ekzemplar tjetër që paraqet më shumë interes për punën e tij studimore.

Procesi i identifikimit të këtyre elementeve është realizuar përmes ekzaminimit të hollësishëm të fashikujve, fletëve dhe elementeve të tjera të çdo njësie bibliotekare. Përcaktimi i plotësisë dhe saktësisë së tyre është bërë përmes krahasimit me ekzemplarë të rregullt që gjenden në BKSh. Kur kjo nuk ka qenë e mundur është bërë krahasimi me përshkrime të bibliografive ekzistuese. Ndonjëherë është dashur të bëhet krahasimi i ekzemplarëve faqe për faqe dhe rresht për rresht për të parë nëse ato janë identikë apo variante të të njëjtit tekst.

Në koleksionet e BKSh ka një numër të konsiderueshëm njësisish që nuk janë botime origjinale. Në përshkrimin bibliografik të skedarëve manualë kjo veçori është pasqyruar me terma të tillë, si: fotorapid, kseroks, fotografim, fotokopje etj., terma këto që, në të vërtetë, shënojnë mënyrën ose teknikat e riprodhimit të përdorura në kohë të ndryshme dhe jo vetë procesin. Nisur nga fakti që në një bibliografi nuk interesojnë mënyrat apo teknikat, por procesi vetë, në rastet e këtyre njësisive joorigjinale është shënuar thjeshtë fakti që kemi të bëjmë me riprodhim (në trajtë të shkurtuar *riprodh.*), në kuptimin e termit reprografi: riprodhim dokumentesh ose kopjim me të gjitha mënyrat, përveç shtypshkronjës, si fotografi, fotokopjim, kseroksim, fotorapid, mikrofilmim etj. Në rastet e botimeve të hershme, të cilat BKSh i disponon vetëm të riprodhuara, termi *riprodh.* është vendosur në krye të zonës së shënimeve të bibliografit.

D. *Zona e numrit të vendit* të secilit ekzemplar të librit. Përdoruesi duhet të dijë se elementi i parë në çdo numër vendi është një simbol që tregon fondin, në koleksionet e BKSh, në të cilin gjendet njëri ose tjetri ekzemplar i njësisë bibliotekare të përshkruar.

Konkretisht:

- Simbolet *Ar*, *88*, *88^a*, *88^b*, *88^c*, *89*, *89^a*, *90* dhe *91* tregojnë që ekzemplari ruhet në Fondin e Arkivit të Librit Shqip dhe, si rregull, është më i plotë dhe në gjendje fizike më të mirë se ekzemplarët e tjerë;

- Simbolet *Al*, *79^a*, *80*, *80^a*, *81*, *82*, *83*, *84*, *84^a*, *85*, *86*, *86^b*, *87*, *87^a* dhe

⁸⁸ Për nga sasia dhe vlera e librave të dhuruar BKSh-së përmendim sidomos albanologun e shquar Gustav Weigand, por edhe personalitete vendës si Jani Vruho, Gjergj Pekmezi, Gjerashim e Gjergj Qirjazi etj.

87^b shënojnë ekzemplarët e Fondit të Albanologjisë dhe u shërbehen kryesisht studiuesve të fushave që mbulon albanologjia;

- Simboli *An* tregon se ekzemplari i përket Fondit të Antikuarit;
- Simboli *PP* tregon që ekzemplari është vendosur në *Sallën Paolo Petta* (aneks i Fondit të Albanologjisë);
- Simboli *S* shënon ekzemplarët e vendosur në Fondin e Përgjithshëm të Librit Shqip;
- Simboli *F* (ndjekur nga shifër romake) tregon se njësia është Fjalor;
- Simboli *Fe* edhe ky tregon se njësia është Fjalor;
- Simboli *Mfa* tregon se ekzemplari është mikrofilm i një materiali të Fondit të Arkivit;
- Simboli *Mfs* tregon se ekzemplari është mikrofilm i një materiali të Fondit të Përgjithshëm të Librit Shqip.

Numrat e vendeve janë shënuar sipas skedarëve manualë aktualë të BKSh. Për t'u theksuar se gjatë përgatitjes së kësaj bibliografie paralelisht u punua edhe për një risistemim të ekzemplarëve të çdo titulli respektivisht në fondin Arkiv, Albanologji dhe të Përgjithshëm, pra informacioni i numrave të vendit në këtë zonë është i njëjësuar me atë të skedarëve manualë ekzistues.

*

Bibliografët që kanë patur rastin dhe fatin të merren me punime të kësaj natyre, si edhe studiuesit me përvojë të fushave të ndryshme e kanë të qartë vështirësinë, por edhe mrekullinë e sipërmarrjeve të tilla të rëndësishme. Përtej postulatit për mendjen gjithmonë dyshuese të bibliografit, ata e ndiejnë gëzimin e endjes profesionale në mëdyshjen midis skrupulozitetit që diktojnë rregullat dhe standardet, nga njëra anë, dhe fantazisë apo lirshmërisë për të zgjidhur situatat e diskutueshme, nga ana tjetër, në ballafaqimin me të dhënat bibliografike që librat e vjetër bartin si pjesë e rëndësishme e kulturave kombëtare dhe më tej.

Ky punim nuk mëton të jetë i plotë apo shterues, por besohet të jetë më pranë të qenit i tillë, krahasuar me ata të deritashëm, jo vetëm për faktin se është i vetmi i realizuar sipas qëllimit, objektit, metodologjisë dhe organizimit të një bibliografie të kësaj natyre (retrospektive), por edhe se pasqyron koleksionin më të pasur të librit shqip të periudhës 1555-1912, atë të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë.

Shpresohet që kjo bibliografi, si libër i librave shqip, të zerë vendin e vet

në universin e mjeteve të kërkimit të informacionit bibliografik dhe të provojë vlerën si instrument efektiv dhe i besueshëm për përdoruesit e vet, studiues a bibliotekarë qofshin, në mënyrë që, sadopak, të meritohet mirënjohja e tyre.

*

Në punën time për hartimin e kësaj bibliografie kam patur ndihmën dhe kontributin institucional të Bibliotekës Kombëtare, në kuptimin konkret edhe të mjaft specialistëve të saj: ata nuk kursyen kohën as dijet e tyre dhe, ndonëse nuk mbajnë asnjë përgjegjësi për pasaktësi ose të meta të mundshme të punimit, më qenë të vlefshëm me bashkëpunimin e tyre, ndaj u jam shumë mirënjohës.

U jam mirënjohës punonjësve të Sektorit të Koleksioneve për gatishmërinë e pandërprerë dhe përpjekjet ndër vite për shërbimin e disahershëm të mijëra njësive bibliotekare që u bënë objekt i kësaj bibliografie apo që m'u deshën si burim informacioni për të.

Falënderimet e mia shkojnë për znj. Afërdita Sharxhi, përgjegjëse e Sektorit të Albanologjisë, e cila më besoi ndërmarrjen e një përpjekjeje kaq të rëndësishme dhe me përgjegjësi dhe, gjithashtu, realizoi procesin e transliterimit, duke më ndihmuar, mbi të gjitha, me vërejtje konstruktive profesionale të karakterit redaktorial.

Falënderime të shumta më duhet të shpreh për z. Maksim Gjinaj, përgjegjës i Sektorit të Bibliografisë Kombëtare, për ndjenjën e bashkëpunimit të frytshëm, konsulencën e dobishme dhe informacionin e ofruar në vite të gjata bashkëpunimi nëpër të cilat u shtjell puna për këtë Bibliografi.

Mbi të gjitha, i shpreh falënderime dhe mirënjohje të veçantë Dr. Aurel Plasarit, drejtor i Bibliotekës Kombëtare, jo vetëm për nxitjen dhe përkrahjen, por sidomos për sugjerimet me vizion lidhur me përmirësime në konceptimin e hartimit të një bibliografie të tillë jo pa probleme dhe për informacionet e herëpashershme befasuese prej eruditit me dije pa kufi, sidomos në fushën e kulturës së librit. Veçanërisht vërejtjet e tij në fazën përfundimtare kanë qenë të rëndësishme për shmangie pasaktësish dhe përmirësim të botimit.

Ramazan VOZGA

Nëntor 2010

Bibliografi e burimeve të cituara

ALA glossary of library and information science, Chicago: American Library Association, 1983.

Armstrong, David. *Bibliography for Beginners*, në IOBA (Independent Online Booksellers Association) www.ioba.org.

Belanger, Terry. *Descriptive bibliography*, në *Book Collecting: A Modern Guide*, New York and London: R. R. Bowker, 1977, f. 97-101.

Beratti, D. Préface, në *Bibliographie albanaise*, Description raisonnée des ouvrages publiés en albanais ou relatifs à l'Albanie de 1900 à 1910, Par Henri Guys, Tirana 1938.

Bevapi K. - Ballhysa A. *Rrezatime të trashëgimisë kulturore shkodrane në fushën e botimeve - "Hija e Skanderbegut" e Banush Shpatarakut – në Shkodra në shekuj*, seminari i 6-të ndërkombëtar 26 nëntor 2005, vëll. II, Shkodër 2006.

Blum, Rudolf. *Bibliographia, an inquiry into its definition and designations*, American Library Association 1980.

Bowers, Fredson. *Bibliography, Pure Bibliography and Literary Studies*, në *Papers of the Bibliographical Society of America*, vol. 46 (1952).

Carter, John. *ABC for Book Collectors*, Oak Knoll 1995.

Cole, George Watson. *Bibliographical Ghosts*, The University Chicago Press 1920.

Gaskell, Philip. *A new introduction to bibliography*, Oxford University Press 1972.

Greg Walter W. *Bibliography-an Apologia*, po aty, vol. 13 (1932).
Mbi "Bibliografinë Kombëtare Retrospektive të librit shqiptar 1555-1958", 12. 10. 1988 (dorëshkrim).

Greg Walter W. *The present position of Bibliography*, rev. *The Library*, vol. 11 (1930).

Harris, Neil. *Analytical bibliography: an alternative prospectus*, kurs titulluar "Introduction à la bibliographie matérielle: bibliographie détaillée" mbajtur në Ecole de l'Institut d'Histoire du Livre, Lyon, 5-8 April 2004.

Havu, Sirkka. *Conrad Gesner: father of bibliography*, 71st World Library and Information Congress, Järvenpää, Finland 11-12 August 2005.

Hetzer, Armin – Roman, Viorel S. *Albanien, Ein bibliographischer Forschungsbericht...* München 1983.

IFLA. ISBD(A): International Standard Bibliographic Description for Older Monographic Publications (Antiquarian) 2006 Revision.

IFLA, UBCIM Publications – New Series Vol 19, *Functional Requirements for Bibliographic Records*, K.G. Saur München 1998.

International Encyclopedia of Information and Library Science 2nd. ed. London 2003: Routledge.

Kastrati, Jup. *Për një bibliografi shkencore albanologjike në Buletini i bibliotekave 2-1996*.

Konica, Faik. Rubrikat *Libra të ra dhe Fleta e drejtorit*, në rev. *Albania* [Lumo Skendo], *Për shkrime të haruarë dhe të pa-diturë*, në rev. *Diturija*, 1916, nr. 2.

Lumo Skendo: Rubrikat *Bibliografi* (1909), *Bibliografi shqipëtare. Shtim në radhë të Emile Legrand-it* (1926-1929) dhe *Libra të shtypura në Rumani* (1927) (rev. Diturija Selanik-Bukuresht-Tiranë 1909, 1916, 1926-1929).

Maichel, Karol. *Russian current bibliographies 1772-1917*, rev. *The Library Quarterly*, University Chicago Press, XXVIII (1958).

Maxwell, Robert L. *Doracaku që shpjegon dhe ilustron rregullat anglo-amerikane të katalogimit*, Shoqata Amerikane e Bibliotekave, botim shqip, Çikago 2004.

Mbi “*Bibliografinë Kombëtare Retrospektive të librit shqiptar 1555-1958*”, 12. 10. 1988 (dorëshkrim)

McKenzie, Donald Francis. *Bibliography and sociology of texts*, Cambridge University Press, 1999.

McKerrow, Ronald B. *An Introduction to Bibliography for Literary Students*, Oxford: Clarendon Press 1927.

Petta, Marco. *Appunti di Bibliografia albanese. Opere non segnalate nella Bibliographie Albanaise di Legrand-Gûys dalla Biblioteca Criptense në: Boll. Grott.* 1955.

Petrotta, Gaetano. *Popolo, lingua e letteratura albanese*, Palermo 1932.

Plasari, Aurel. *Alfabeti në Bibliotekë*, në 100-vjetorin e Kongresit të Manastirit, 2008.

Procesverbalet e Konferencës së Përgjithshme, sesioni XIII, UNESCO, Paris 1964, Rezolutat.

Reitz, Joan M. *Dictionary for Library and Information Science*, Libraries Unlimited 2004.

Roques, Mario. *Recherches sur les anciens textes albanais*, Paris 1932. (Bruxelles-London 1896 – 1909).

Rrota, Justin. *Për historin e alfabetit shqyp*, Shkodër 1936.

Spadoni, Carl. *What Historians of the Book Need to Know about Bibliography*, rev. *History of Intellectual Culture*, 2007, Vol. 7, No. 1.

Stokes, Roy B. *Bibliography në Encyclopedia of Library and Information Science*, New York and London 1969, vol. 2.

Tuzzi, Hans. *Collezione libri antichi, rari, di pregio*, Milano 2000.

1555

1. Buzuku, Gjon

[Meshar], pa vd., 1555.

[110 fl.]; 21 cm.

Riprodh.

Autori dhe viti i botimit marrë nga pasthënia. Ekzemplari unik që ruhet në Bibliotekën Apostolike Vatikane (BAV) është mjaft i dëmtuar dhe mungesa e fl. tit. ka bërë që të humbasin të dhëna të tilla bazë për përshkrimin bibliografik, si titulli, shtypshkronja dhe vendi i botimit. Për fat, emri i autorit dhe i të atit, *Gjon biri hi Bdech Bueuchut*, si edhe koha që ka zgjatur puna për të: *20 mars 1554 deri më 5 janar 1555*, janë ngulitur në pasthënien e veprës (shih Mario Roques, *Recherches sur les anciens textes albanais*, Paris 1932, f. 10). Injac Zamputi në studimin *Mbi rrethanat historike të botimit të "Mesharit" të Gjon Buzukut dhe vendin e tij në letërsinë e vjetër shqiptare* shkruan se "duhet t'u jemi mirënjohës atyre personave që e patën në dorë ekzemplarin e Mesharit që na ka tepruar dhe nuk ia grisën të gjitha fletët (...) sikur të mos i ishin grisur fletët e para, ku ishte edhe frontespici, (...) Meshari ynë do të ishte zhdukur tërësisht. Pa atë frontespici, i ka shpëtuar syrit të inkuizitorit dhe bibliotekari nuk ka patur frikë ta mbante" (rev. *Studime filologjike*, nr. 3-1986, f. 194). Ky studiues ka konstatuar se kjo pasthënie është "Proza e parë origjinale që kemi në gjuhën shqipe" (*Çështje të shkrimit dhe të fillimit të letërsisë në gjuhën shqipe*, rev. *Hylli i Dritës*, nr. 1-2, 1995, f. 14). Për Xh. Lloshin, në *A ishte përkthyes Gjon Buzuku?*, kjo pasthënie është "i pari tekst i mirëfilltë shqip, që njohim deri më sot". (*Gaz. Ballkan*, 30 mars 2005, f. 16.)

Çështja e heqjes (zhdukjes) nga qarkullimi të Mesharit të Buzukut mund të quhet e zgjidhur për historinë e librit nëse i referohemi me një lexim analitik librit të dorës *Index Librorum Prohibitorum: cum Regulis*

confectis per Patres Tridentina Synodo delectos, autoritate Sanctiss. D.N. Pii IV., Pont. Max. comprobatus 1569, posaçërisht “Dhjetë rregullave” të imponuar në të (Auel Plasari, *Hyrje në albanologji*, Leksione, Master i Nivelit të Dytë në bibliotekonomi, 2010).

Sipas traditës së historisë së letërsisë shqiptare, por edhe asaj të bibliografisë shqiptare, emri i Gjon Buzukut është vendosur këtu, për arsye, të themi, *extra bibliografike*, në kryetitull të përshkrimit, pra, aty ku, sipas rregullave të përshkrimit bibliografik, vendoset emri i autorit të një vepre. Kështu është vepruar edhe me Lekë Matrëngën, Pjetër Budin dhe Pjetër Bogdanin (shih regjistrimet me nr. 2-5, 7-10). Në kulturat e popujve të vegjël apo me dëshmi të kulturës së shkrimit jo fort të hershme, siç janë një pjesë e popujve të gadishullit tonë, përkthimet, kryesisht ato fetare, konsiderohen fillime të literaturave kombëtare dhe vepra të mirëfillta të kulturave gjegjëse, ndërsa përkthyesit autorë të literaturave kombëtare të këtyre popujve. Në Shqipëri, dhe përgjithësisht Europën Juglindore, përkthimi dhe botimi i literaturës fetare nuk u bë si kudo thjesht nën shtypin e lëvizjes së Reformacionit (Buzuku) apo të Kundërreformacionit (Budi), por edhe i ndikuar nga pushtimi osman, që sillte me vete zaptimin e trojeve dhe rrezikun e islamizimit të jetës shpirtërore në rajon.

Për *Mesharin* Eqrem Çabej shkruan se ai “shënon fillimet e një tradite letrare në Shqipëri” (*Studime gjuhësore*, vëll. VI: *Gjon Buzuku dhe gjuha e tij*, Prishtinë 1977, f. 8) dhe Buzukun e quan *autor* (ashtu si edhe autorët e tjerë të shek. XVII), *prift shkrimtar, shkrimtar me talent, themelues të literaturës shqiptare* etj. (po aty, f. 13, 17, 21).


Studiuesi Xhevat Lloshi ka konstatuar se nuk ka qenë e mundur të përcaktohet origjinali nga është bërë përkthimi i kësaj vepre dhe se “madje mund të kenë qenë disa e në gjuhë të ndryshme”, në dallim nga skema e zakonshme e përkthimit të një teksti të caktuar që do të ndiqnin më vonë Vangjel Mexsi dhe Konstandin Kristoforidhi në përkthimet e tyre të teksteve të shenjta të ritit ortodoks. Po Xh. Lloshi është i mendimit që Buzuku nuk ka vepruar si një përkthyes i zakonshëm dhe veprën e tij e sheh si produkt të një praktike ligjërimore shërbesash të përditshme në kishë duke iu drejtuar pastaj botimeve në gjuhë huaja. (*A ishte përkthyes Gjon Buzuku?*, gaz. *Ballkan*, 30 mars 2005, f. 16.)

Meqë botimit i mungojnë fletët e para, pra edhe fl. tit., siç u tha më lart, atij i mungon edhe titulli. Eqrem Çabej në *Hyrje*, “*Meshari*” i *Gjon Buzukut* (1555), botim kritik, Tiranë 1968, f. 8 sqaron se vepra u thirr kështu nga zbuluesi i saj Gjon Kazazi, më 1740. (Justin Rrota saktëson

si vend të gjetjes bibliotekën e kolegjit të Propagandës Fide në Romë, në *Monumenti më i vjetri i Gjuhës Shqype*, Shkodër 1938, f. 4). U thirr dhe vijon të thirret me këtë titull pavarësisht se vepra përmban, përveç *Mesharit*, i cili zë 2/3 e saj, edhe forma të tjera të literaturës së krishterë katolike, si: elemente të një orologu (libër lutjesh), pjesë nga të ritualit dhe të katekizmit, psalme etj.

Numri i fletëve po ashtu sipas: Çabej, po aty.

Sot ka 94 fl.



Pasthënia e “Mesharit” të Gjon Buzukut: teksti original i fotografuar dhe transkribimi fonetik nga Eqrem Çabej

Shënimi Cod. Vatic. R[accolta] G[enerale] Liturgia, III, 194 është nr. i vendit i të vetmit ekzemplar origjinal në BAV, nga janë bërë dy riprodhimet që gjenden në Bibliotekën Kombëtare (BK).

Hyrja në koleksionet e BK e këtij botimi me rëndësi të posaçme për historinë e gjuhës dhe kulturës sonë lajmërohej në *Vepërij’ e Bibljotekës’ Kombëtare gjatë vitit’ 1929*, Shtyp. “Mbrothësija” Kristo P. Luarasi, Tiranë 1930: “Bibljoteka Kombëtare ubegatua simvjet me një vivëllë, që kujtohet’ se është e para vepërë shqip që doli ndë dritë me anën’ e shtypitë” (f. 7).

Studiuesi francez Mario Roques mendon që për vepra të tilla të mbetura vetëm me një ekzemplar unik është e nevojshme të shënohen edhe riprodhimet e tyre. “Me sa di unë,- shkruan ai,- një kopje e fotografuar bardhë e zi (e Mesharit,-R. V.) është bërë rreth vitit 1910 për Pal Skiroin...; më 1929 tre ekzemplarë të fotografuar bardhë e zi janë bërë me kërkesë të P. Justin Rrotës: njëra gjendet në Shkodër te Françeskanët, një tjetër duhet të jetë në bibliotekën e Tiranës” (*Recherches sur les anciens textes albanais...* f. 18). Për tre ekzemplarë të fotografuar, me porosi që t’ia lidhnin “dy kopje ndë lëkurë, njenën ndë rason”, shkruan vetë J. Rrota (*Ma të parat kopje të fotografueme të Buzukut në Shqipëni, në At Justin Rrota, Për historin’ e alfabetit shqyp dhe studime tjera gjuhësore*, bot. II, Botime Françeskane, Shkodër 2005, f. 57-60).

Lidhur me vendin e botimit, siç thotë Çabej në Studime gjuhësore IV... f. 29 “dijetarët janë ndarë në dy lagje”. Disa si N. Jokli (rev. *Hylli i Dritës*, Shkodër, nr. 3-1930, f. 153), J. Rrota (*Hylli i Dritës*, nr. 1-1930, f. 37; *Hulumtime dhe shenjime mbi Gjon Buzukun në Buletin për Shkencat Shoqërore*, Tiranë 1956-3, f. 183), M. Domi (*Historia e Letërsisë Shqipe*, vëll. I, Tiranë 1959, f. 190), Dh. S. Shuteriqi (*Tekstet shqipe dhe shkrimi i shqipes në vitet 879-1800*, Tiranë 2005, f. 114) mendojnë që libri është shtypur në Shqipëri; të tjerë si J. Tomiq (Hylli i Dritës, nr. 3-1930, f. 144), M. Roques (*Reserches sur les anciens textes albanais...* f. 13), C. Tagliavini (*Rivista d’Albania*, fascicolo I, Aprile 1940, f. 72) në të kundërt, janë të mendimit se ai është shtypur në Itali. Çabej u bashkohet të dytëve: “... në republikë të Shën Markut” (po aty, f. 30).

Numërtimi i fletëve është bërë me shifra romake të paraqitura me shkronja të alfabetit latin dhe ka gabime.

Ka mungesë fletësh, fletë të vendosura gabim dhe fletë të dëmtuara.

Mbi ekzemplarin origjinal të BAV, që është riprodhuar, ka emra personash dhe shënime të shkruara me dorë (postilje interlineare, marginale etj.) në latinisht dhe në shqip (shih Shuteriqi, *Tekstet shqipe...* f. 141-146).

Dy ekzemplarët e riprodhuar të BK nuk janë plotësisht identikë: kanë disa ndryshime, si: ndonjë mungesë fl., vendosje gabim të ndonjëres prej tyre etj.

An XIV D 1 ka vulën “BIBLËJOTEKA KOMBËTARE - TIRANË”. Foto negativ (tekst me shkronja të bardha në sfond të zi). Me lidhje lëkure.

An III C 15 ka vulat “Biblioteka Franciskane-Shkodër” dhe “BIBLËJOTEKA KOMBËTARE - TIRANË”.

An III C 15

An XIV D 1

1592

2. Matrënga, Lekë

EMBSUAME / E CHRÆSTERÆ bææra per tæ Vrtænæ Atæ Ledesmæ / sciochiæriet Iesusit. / E prierræ lætireiet mbæ gluchæ tæ / arbæresciæ pær Lecæ Matrængnæ / Imbsuam i Cullegit Græc tæ. / Romæsæ = DOTTRINA CHRISTIANA / Composta dal Reurende P. Dottor Ledesma / della Compagnia di Giesu. Tradotta di lingua Italiana nell’ Albanese / per Luca Matranga alunno del Collegio Greco, in Roma. / In Roma, Presso Guglielmo Facciotto. 1592. / CON LICENZA DE’ SVPERIORI.

28 f.; 12 cm.

Riprodh.


Titulli paralel shqip dhe italisht.

Aut. në fl. tit. në dy forma: Lecæ Matrængnæ dhe Luca Matranga.

F. [2] Ndjesa e papës.

Shënimi i stampuar në anën e prapme të secilës fletë të riprodh. “R. G. Teol. V 1265 i 2” pasqyron nr. e vendit në BAV të ekzemplarit nga është bërë ky riprodhim. (Kolë Ashta, *Shënime e vërejtje rreth gjuhës dhe leksikut të Lekë Matrëngës*, në: *Buletin për shkencat shoqërore*, Instituti i Shkencave Tiranë, nr. 1-1957, f. 85).

Sipas Matteo Mandalà, *Luca Matranga, E mbsuame e krështerë*, Caltanisseta 2004, f. 71 emri i autorit të veprës origjinale nga Matrënga ka bërë përkthimin është Diego (emri i pagëzimit), por në disa botime të këtij katekizmi ai gjendet edhe në trajtën *Jacob* ose *Giacomo*.



Fl. tit. dhe faqja e fundit e ekzemplarit të fotografuar të katekizmit të Lekë Matrëngës, në të cilën gjendet vula e Bibliotekës Apostolike Vatikane

Pas Buzukut, tradita e përkthimit dhe botimit në shqip nga latinishtja të literaturës së krishterë katolike vijoi në kolonitë e arbëreshëve të Italisë dhe në Veriun e Shqipërisë së pushtuar apo në proces pushtimi. Veprat e përzgjedhura janë kryesisht katekizma si *Dottrina christiana* (të cilën Matrënga e kthen në *E mbsuame e krishterë*) e spanjolit Diego de Ledesma, *Dottrina christiana* e kardinalit Roberto Bellarmino, *Specchio di confessione* e at Emerio de Bonis etj. Siç kemi paralajmëruar te regjistrimi nr. 1, si te përshkrimi bibliografik i *Mesharit*, edhe në këto raste për të njëjtat arsye në kryetitull të përshkrimit janë vënë Lekë Matrënga, Pjetër Budi dhe Pjetër Bogdani (shtu edhe një arsye më domethënëse që përveç koloritit vendës dhe pasthënies te Buzuku, në këto botime gjejmë edhe krijime letrare origjinale në shqip, parathënie, pasthënie, shtesa të ndryshme etj.). Indikacioni për autorët e veprave origjinale nga janë bërë përkthimet mund të merret te *Treguesi i autorëve* në fund të librit, ashtu si për gjithë autorët e tjerë, veprat e të cilëve janë përfshirë në këtë bibliografi.

Sipas Dh. S. Shuteriqit në *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*, Tiranë 1976, nr. 14-16, në BAV ruhen tri dorëshkrime të Matrëngës të përkthimit të kësaj vepre. Në dorëshkrimin 1, i cili nuk shërbeu për t'u riprodhuar në këtë botim, në krye të tij, gjendet një strofë me 8 vargje në latinisht përkthyer në shqip. Kjo poezi fetare është i pari vjershërim i njohur shqip. Studiuesi Selman Riza që i pari që përdori ekzemplarit e fotografuar. Ai ballafaqoi tekstin e shtypur me variantet në dorëshkrim dhe konstatoi se kjo vjershë e përshpirtshme e variantit 1 të dorëshkrimeve mungon te dorëshkrimi 3, i cili ishte riprodhuar te katekizmi që u shtyp më 1592 (*Disa teza mbi tre dorëshkrimet e katekizmit të Matrëngës*, në rev. *Studime Filologjike*, nr. 1-1962, f. 78). Së këtejmi, në punimin e pabotuar *Pesë autorët më të vjetër të gjuhës shqipe* (f. 59), pjesë e të cilit ishte artikulli i mësipërm, botuar në Tiranë vetëm më 2002, Riza kritikon tekstin *Historia e Letërsisë Shqipe*, vëll. I, Tiranë 1959, në të cilin, shkruhet se në libër gjendet edhe “një këngë e përshpirtshme...” (*HLSH*, vëll. 1, 1959, f. 199-200). Megjithëse Shuteriqi citon këtu (*Shkrimet shqipe...* nr. 14-16) përfundimin e Rizës, sipas të cilit kjo poezi nuk u përfshi në botim, çka verifikohet fare lehtë edhe nga konsultimi i ekzemplarit të fotografuar të këtij libri të BK, për çudi, te *Historia e Letërsisë Shqiptare*, Tiranë 1983, vijon të shkruhet se “Aty (te katekizmi i Matrëngës, botuar në Romë më 1592-R. V.) gjejmë edhe të parën vjershë që njohim shqip...”.

Odiseja e botimit, humbjes, gjetjes, rihumbjes, rigjetjes e kështu me radhë e këtij libri është e pashoqe në historinë e librit shqip-dhe të mos

harrojmë se flitet për librin e dytë të botuar në gjuhën shqipe. Më 1909, më se tre shekuj pas botimit, një kopje e këtij libri u gjet në BAV. Ishte viti kur Pal Skiroi rigjeti këtu *Mesharin* e Buzukut; po ashtu zbuloi për herë të parë edhe një ekzemplar të botimit të *E mbsuame e krështerë* të L. Matrëngës. Për të dy këto botime ai arriti të sigurojë nga një riprodhim fotografik.

Kur më 1912 Marco la Piana desh të ribotonte këtë katekizëm u konstatua se ekzemplari që kishte zbuluar P. Skiroi nuk gjendej më në BAV, ndaj edhe ai zgjodhi të ribotojë drsh. 1, i cili ruhej në atë bibliotekë së bashku me drsh. 2 dhe drsh. 3.

Zbulimin për së dyti të këtij ekzemplari e bëri më 1932 albanologu Mario Roques, i cili, krahas përshkrimit të plotë fizik të veprës, bëri riprodhimin diplomatik (nga lat. e re: *diplomaticus*, që ka të bëjë me dokumente origjinale-R. V.) të aparatit të titullit dygjuhësh, të fl. tit., si edhe të shënimit me emrin e tipografit që e shtypi veprën.

Refreni përsëritet: kur më 1964 Matteo Sciambra vendosi të merrej me përgatitjen e ribotimit kritik të drsh. 1 dhe të kopjes së shtypur, zbuloi se ekzemplari i shtypur i BAV ishte zhdukur sërish, mbase këtë herë në mënyrë përfundimtare, ndaj edhe botoi variantet e dorëshkruara. Vetëm më 1979 studiuesi kosovar Fadil Sulejmani mundi të kryejë botimin e parë diplomatik të ekzemplarit të shtypur. (shih M. la Piana, *Il catechismo albanese di Luca Matranga (1592) da un manoscritto Vaticano*, Grottaferrata 1912, f. 6; Roques, *Reserches sur les anciens textes albanais...* f. 19; M. Sciambra, *La “Dottrina cristiana” albanese di Luca Matranga*, Città del Vaticano 1964, f. XXIII-XXIV; F. Sulejmani, *E mbsuame e krështerë e Lekë Matrëngës*, Prishtinë 1979, f. 23-25; M. Mandalà, *Gjurmime filologjike për letërsinë e vjetër arbëreshe*, Tiranë 2006, f. 21-22).

Ekzemplari i fotografuar në pronësi të P. Skiroit, ishte trashëguar nga i nipi Z. Skiroi. Gjatë Luftës II Botërore ky e solli në Shqipëri këtë riprodhim të fotografuar të katekizmit, i cili, pas kthimit të tij në Itali më 1949, mbeti në Tiranë dhe sot ruhet në BK (Sciambra, *La “Dottrina cristiana” albanese...* po aty).

Deri para pak vitesh kujtohej se, pas humbjes së origjinalit në BAV, ekzemplari i fotografuar që gjendet në BK ishte e vetmja dëshmi e botimit të vitit 1592. Por studiuesi arbëresh M. Mandalà në botimin e sipërcituar (f. X) njofton gjetjen në Bibliotekën Angelica (BA) në Romë të një ekzemplari të librit të Matrëngës. Nga krahasimi i librit të shtypur që ruhej në BAV, skeda përshkruese e të cilit gjendet ende atje, me

ekzemplarin e zbuluar në këtë bibliotekë të Romës, Mandalà arrin në përfundimin se ekzemplari i BA në Romë *përkon pikë për pikë* me atë që ruhej dikur në BAV dhe se ato janë identikë në çdo element tipografik (dimensione 10X20 cm., nr. faqesh 28 etj.), çka provon se i përkasin të njëjtit edicion: atij të shtypur në Romë më 1592 nga tipografi Guglielmo Facciotto. Ai vë re se edhe të dhënat e saj bibliografike përputhen me përshkrimin që M. Roques i bën ekzemplarit të BVA. Gjithashtu, struktura dhe përmbajtja e ekzemplarit të BA përputhen plotësisht me ato të ekzemplarit të fotografuar të BK (*Gjurmime filologjike...*, f. 23; *Luca Matranga, E mbsuame...* f. 371). I vetmi ndryshim që kemi vënë re është se në të dytin mungojnë në fillim të tekstit, pra në f. 3, dy shkronja e gjysmë (!): në rreshtin 1 te fjala Mieftræ mungon M-ja, pra ajo paraqitet në formën ieftræ, ndërsa në rreshtin 2 te fjala Imbfuam mungon I-ja dhe këmba e parë e m-së, pra ka mbetur në formën nbfuam.

Në pjesën e poshtme të faqes së titullit gjendet shënimi CON LICENZA DE' SVPERIORI, si një formulë që shtypej në fillim ose në fund të librit dhe që në gjuhën bibliografike dhe tipografike shpreh miratimin apo lejen që autoritetet kishtarë ose ato laike jipnin për publikimin e një vepre pasi e kishin shqyrtuar atë. Ky shënim gjendet në faqe të titullit edhe te librat që u përkasin regjistrimeve nr. 3, 7, 8 dhe 19/1 të kësaj bibliografie.

An V D 4, si ekzemplar i fotografuar nga origjinali, ka vulën “BIBLIOTHECA APOSTOLICA VATICANA”.

An XIV F 30 është i fotokopjuar nga ekzemplari An V D 4.

An V D 4

An XIV F 30

1618

3. Budi, Pjetër

DOTTRINA CHRISTIANA / Composta per ordine della fel. me. / DI PAPA CLEMENTE VIII. / Dal R. P. Roberto Bellarmino Sacerdote della Campagna di GIESV. / Adesso Cardinale / di santa Chiesa del Titole di S. Maria in Via. / Tradotta in lingua Albanese / DAL REVER. DON PIETRO BVDI / da Pietra Bianca. / In Roma, Per Bartolomeo Zannetti, 1618. / Con licenza de' Superiori.

[2] fl., 174 f., 55 fl. (175-229), [2] fl.; 12 cm.

Riprodh.

Përkthimi është bërë nga botimi: Roberto Bellarmino, “Dottrina Cristiana breve”,

1597.

F. 1-4 parathënie e Budit.

Fl. 229 pasthënie.

Fl. 175- 228 19 vjersha fetare përshtatur nga latinishtja ose italishtja; ka prej tyre edhe krijime origjinale në gjuhën shqipe.

Në fletën e titullit është shkruar me dorë: “Auctor dono dedit Bibliothecae Vaticane 29 Januar 1622”. Ka vulën e Bibliotekës Vatikane.

An V D 3



1621

4. Budi, Pjetër

PASECH8RA, / ETREF8EMIT / E Atit Emerio de Bonis mesaa tyera cafsce sci- / me tefruytouscime tescpijrrtit, p[er]ndimete giuhu- / se Arbenesce, eachie maatepere p[er]tat8net chi sya- / ne te Eote mendegiuom giuhu nze tyera lete- / rasc, nkz38em giuheze letine mbegiuhu Tar-/benesce Eotit Dom Pietre Budit prey Gurize / barze, Vpeskepize Sadrimese. = Cioè / SPECCHIO DI CONFESSIONE / del P. Emerio de Bonis, con alcuni discorsi spi- / rituali vtilissimi à quelli che non intendono / altra lingua, che la materna Albanese. Tra- / dotti nella medesima lingua da Monsignor / Pietro Budi Vescouo Sapatense e Sardanense / IN ROMA, Appresso / l' Herede di Bartolemeo Zannetti M.DC. XXI. [1621] SVPERIORVM PERMISSV.

[7], 408 f.; 12 cm.

Riprodh.

Titulli paralel shqip dhe italisht.

Përkthimi është bërë nga botimi i Emerio de Bonis, *Specchio particolare, et generale di confessione*, Verona, 1592.

Sipas Gunnar Svane në *Pjetër Budi, Speculum Confessionis (1621)*, Århus 1986, f. IV, ekzemplari i BAV ka edhe një fletë titulli në latinisht, e cila i mungon këtij riprodhimi.

Fl. 2-6 parathënie.

F. 333-401 pasthënie

F. 403-408 tri vjersha fetare në shqip.

Para fl. tit. gjendet gabimisht, gjithashtu e riprodh., f. 16 e fashikullit *Kush thotë meshë...*, që është bashkëlidhur me *Rituale romanum...*

Kjo vepër, bashkë me *Rituale romanum...* (regjistrimi nr. 5 këtu) dhe fashikullin *Kush thotë meshë...* (në po atë regjistrim), janë fotografuar nga origjinali *R. G. Liturgia, V. 36* në BAV, ku gjenden të bashkëlidhura të trija për nevoja praktike, pavarësisht nga numërtimi më vete i secilës prej tyre, që tregojnë se ato janë botime që kanë qarkulluar edhe veças. Shuteriqi i ka përshkruar këto tri botime sipas kësaj bashkëlidhjeje të dikurshme të BK me nr. vendi An V D 2 (*Shkrimet shqipe...* nr. 28-30).

Aty përfshiheshin *Ritualia Roman...*, *Kush thotë meshë...* dhe *Pasqyra e të rrëfyemit...*

Dikur më vonë është parë e arsyeshme nga BK që ato të çlidhen dhe të rilidhen sipas logjikës së përshkrimit që bën M. Roques, i cili, sipas ekzemplarit të BAV me nr. vendi R. G. Liturgia V. 51, *Ritualin roman...* e përshkruan bashkë me *Kush thotë meshë...*, ndërsa sipas ekzemplarëve të Bibliotekës Mazarine të Parisit 24582 dhe të BVA R. I. V. 2213 *Pasqyrën...* më vete (*Recherches sur les anciens textes albanais...* f. 26-28). Kësisoj, tanimë *Pasqyra...* më vete ka nr. ekzistues të vendit të bashkëlidhjes së vjetër treshe, pra An V D 2, ndërsa *Ritualia roman...* dhe *Kush thotë meshë...* të bashkëlidhur kanë marrë një nr. vendi të ri, An V D 5. Në përshkrim është ndjekur gjendja e re fizike e këtyre tre botimeve në fondin antikuar të BK; pra, janë përshkruar sipas Roques. Ndërsa Shuteriqi, duke mos patur dijeni për këtë procedurë, ka vijuar t'i përshkruajë ato sipas bashkëlidhjes treshe të dikurshme, po ashtu t'i sinjalizojë me nr. e vjetër të vendit (*Tekstet shqipe...* f. 158-162).

Në pjesën e poshtme të faqes së titullit gjendet shënimi SVPERIORVM PERMISSV, i cili ka formën e një dokumenti legal (lejuar nga eprorët). Ky shënim gjendet në faqe të titullit edhe te librat që u përkasin regjistrimeve nr. 5, 6, 9 dhe 11 të kësaj bibliografie.

An V D 2

5. Budi, Pjetër

RITVALE ROMANVM / ET / SPECVLVM CONFSSIONIS / In Epyroticam linguam à PETRO / BVDI Episcopo Sapatense, & / Sardanense translata: / SANCTISSIMI DOMINI NOSTRI / GREGORII XV. / Liberalitate typis data. / ROMÆ, Apud Hæredem Bartholomæie Zannetti, 1621. / SUPERIORUM PERMISSV.

360, 16 f.; 12 cm.

Riprodh.

F. 327- 352 pasthënie e Pjetër Budit.

F. 353-354 vjershë fetare në gjuhën shqipe.

F. 355-356 tjetër vjershë fetare dhe një lutje në latinisht.

Botuar bashkë me këtë vepër, si fashikull më vete, shpjegimi i meshës romane titulluar “Kush thotë meshë këto kafshë i duhetë”. Ky fashikull 16 faqësh pa fl. tit., pra pa vd dhe pa vt, pa *imprimatur* dhe emër shtypshkruesi, është pasqyruar në këtë regjistrim edhe për faktin që u përmend në regjistrimin nr. 4 se pas çlidhjes së bashkëlidhjes së dikurshme të siguruar nga BAV, ai ka vijuar të jetë i bashkëlidhur me *Rituale Romanum*. Por në treguesin e titujve të kësaj bibliografie ai është pasqyruar më vete.

Në pjesën e poshtme të faqes së titullit është shkruar me dorë: “Auctor dono dedit Bibliothecae Vaticanae 29 januar 1622”.

An V D 5

1635

6. Bardhi, Frang

DICTIONARIVM / LATINO EPIROTICVM / Vna / Cum nonnullis vsitationibus / loquendi formulis. / Per R. D. FRANCISCVM BLANCHVM / Epirotam Coll. de Propag. Fide Alumnum. / Romae, Typis Sac. Congr. de Propag. Fide. 1635. / Svpriorvm Permissv.

[8] fl., 2, [1] fl.; 14 cm.

Fl. 3-5 parathënie e autorit

Fl. 6b-7a *Annotationes de lingua, et litteris Epirotarum, seu Albanensiorum.*

Fl. 7b vargje të Stefanus Gasparus kushtuar autorit, si edhe një distik në latinisht.

Fl. 8a vargje në latinisht nga Franciscus Azzopardus dhe Mattheus Dudesius.

Fl. 8b ka *Index capitum*.

F. 1-188 *Dictionarium latino-epiroticum*.

F. 189-222 me radhë *Tegnefunate Latinisct, Talianisct, Arbënisct, e Turgisct; Numeri secundum ordinem, Latinè, et Epiroticè; Emënatë e Prindet, Mascie, e Femënë, Latinisct, Talianisct, Arbënisct, Turgisct; De Anverbijis, quae traduntur apud Epiroticos, sicut etiam apud Latinos; De Praepositionibus Epiroticis...; De Interiectionibus* (të gjitha këto me karakter mësimor); *Prouerbia, & sentetiae Epirotarum; Salutatio Epiroticae Linguae, haec est; Dialogus Interrogationum, & Responsonum Epirotarum dhe Alicae salutationes eiusdem ulchriores praecedentibus.*

Fl. e panumërtuar në fund në njërën anë *Admonitio de erroribus*, në tjetrën *Errata sic corrigenda*.


Me këtë fjalor nis tradita leksikografike shqiptare. Nis me të edhe vargu prej afro 35 botimesh realizuar nga Shtypshkronja e Kongregacionit të Propagandës së Fesë (Propaganda Fidei), të cilat zënë një periudhë mbi dy shekuj e gjysmë nga viti 1635 deri nga fundi i shek. XIX (Justin Rrota, *Për historin e alfabetit shqyp*, Shkodër 1936, f. 69). Studiuesi Peter Bartl vëren se ky fjalor ishte “ndër prodhimet e para të shtypshkronjës shumëgjuhëshe të Kongregacionit Propaganda Fide, themeluar më 1626” (*Shqiptarët, nga Mesjeta deri në ditët tona*, Tiranë [2008], f. 95).

An I T 5/2 ka shënime të shkruara me dorë pothuajse në të gjitha faqet.

An IV R I ka vulën “Collegium S. Francisci Xaverii Scodrae”.

An I T 5/1-2

An IV R 1



1636

7. Budi, Pjetër

DOTTRINA / CHRISTIANA / Composta per ordine della fel. me. / DI PAPA CLEMENTE VIII. / Dal R. P. Roberto Bellarmino Sacerdo- / te della Compagnia di GIESV. / Che poi fu Cardinale di Santa Chiesa del Titolo / di S. Maria in Via. / TRADOTTA IN LINGVA ALBANESE / DAL REVER. DON PIETRO BVDI / da Pietra Bianca. / IN ROMA / Nella Stampa della Sac. Cong. de Propag. Fide, 1636. / CON LICENZA DE' SVPERIORI 288 f., [1] fl.; 14 cm.

Bot. 2, me disa ndryshime.

An V D 21

1664

8. Budi, Pjetër

DOTTRINA / CHRISTIANA / Composta per ordine della fel. me. / DI PAPA CLEMENTE VIII. / Dal R. P. Roberto Bellarmino Sacerdote / della Campagnia di GIESV. / Che poi fu Cardinale di Santa Chiesa del titolo / di S. Maria in Via. / TRADOTTA IN LINGVA ALBANESE / DAL REVER. DON PIETRO BVDI / da Pietra Bianca. / IN ROMA, / Nella Stampa della Sac. Cong. de Prop. Fide 1664. / CON LICENZA DE' SVPERIORI. 288 f.; 14 cm.

Bot. 3, me disa ndryshime nga bot. 2.

An XIII G 30 ka vulën “Prof. Dr. G. Weigand. Leipzig”, si dhe etiketën ku është daktilografuar “E fali Zoti Profesor Doktor / Gustav Vajgand (Weigand) / Lëpiskë / Dimëruar 1929”. (*Gazeta Vullneti*, Tiranë, 15 janar 1930 (nr. 20), f. 4 njofton se albanologu Gustav Weigand i dhuroi Bibliotekë Kombëtare 81 botime, të gjitha me vlerë, ndër të cilët edhe ky libër i rrallë i Pjetër Budit).

An XII E 27 i mungon fl. tit.

An XIII G 27 ka shënimin “Zotit Prof. Karl Gurakuqi për kujtim të udhëtimit në Siçilië – Pashkët të vitit 1940. XVIII Drejtori i Seminarit Italo – Arbresh të Palermo-s”.

An II E 1

An IX S 8

An XII E 27

An XIII G 25

An XIII G 26

An XIII G 27

An XIII G 29

An XIII G 30

1685

9. Bogdani, Pjetër

- CVNEVS / PROPHETARVM / DE CHRISTO / SALVATORE MVNDI, / ET EIVS EVANGELICA VERITATE, / ITALICE, / ET EPIROTICÈ CONTEXTA, / Et in duas Partes diuisa / A PIETRO BOGDANO / MACEDONE / SACR. CONGR. DE PROP. FIDE ALVMNO. / Philosophiæ, & Sacræ Theologiæ Doctore, olim / Episcopo Scodrensi, & Administratore / Antibarensi; nunc verò / ARCHIEPISCOPO SCVPORVM, / AC TOTIVS / REGNI SERVIÆ / ADMINISTRATORE / PARS PRIMA. / PATAVII, M. DC. LXXXV. [1685] / EX TYPOGRAPHIA SEMINARII. / OPERA AVGVSTINI CANDIANI. / SVPERIORVM PERMISSV. [26] fl., 182 f. : me il.; 30 cm.

Titulli është shtypur pjesërisht me të zezë, pjesërisht me të kuqe, ndërsa teksti në dy kolona: majtas italisht dhe djathtas shqip.

Lidhur me vendin e botimit është vënë re se që nga viti 1635 me *Fjalorin* e Bardhit dhe 140 vite në vijim të gjithë librat shqip u realizuan në shtypshkronjën e Propaganda Fide-s, me përjashtim të kësaj vepre të Bogdanit që u shtyp në Padova (Peter Bartl, *Shqiptarët...*, f. 95).

Në hyrje të veprës në 26 fletë të panumërtuara janë 23 materiale, si: parathënie; mendimet e recensentëve Andrea Bogdani dhe Gjon Klerikati në latinisht dhe të Gjon Bogdanit dhe Nikolla Bratiçit në italisht, të cilat “paraqesin një dukuri të rrallë në ndërmarrjet botuese të kësaj kohe” (Engjëll Sedaj, *Pjetër Bogdani dhe vepra e tij në Pjetër Bogdani, Çeta e Profetëve (I) Cuneus Prophetarum*, Prishtinë 1989, f. 27); vjersha dhe kushtime nga autorë të ndryshëm në shqip, italisht dhe sllavisht. Mes tyre edhe parathëniet e autorit “Të primitë përpara letterarit”, “Avertimenti per leggere correttamente in lingua albanese” dhe “Al Benigno lettore”. Veçojmë përkushtimin kardinalit Gregor Barbadikut, i cili ka vendosur botimin e librit, si edhe poezinë në gjuhën shqipe të Bogdanit për nder të Andrea Zmajevičit, të cilit ia kushton krejt këtë vepër të tij. Të shpërndara në të dy pjesët e librit gjenden gjithashtu 11 poezi të autorit, përkthime dhe origjinale.

- DE VITA IESV CHRISTI / SALVATORE MVNDI, / ET EIVS EVANGELICA VERITATE, / ITALICE, / ET EPIROTICÈ CONTEXTA, / Et in duas Partes

diuisa / A PIETRO BOGDANO / MACEDONE / SACR. CONGR. DE PROP. FIDE ALVMNO. / Philosophiæ, & Sacræ Theologiæ Doctore, olim / Episcopo Scodrensi, & Administratore / Antibarensi; nunc verò / ARCHIEPISCOPO SCVPORVM, / AC TOTIVS / REGNI SERVIÆ / ADMINISTRATORE / PARS SECVND. / PATA VII, M.DC.LXXXV. / [1685] EX TYPOGRAPHIA SEMINARII. / AVGVSTINI CANDIANI. / SVPERIORVM PERMISSV. [2] fl., 162 f. : me il., [13] fl.; 30 cm.

Pjesa e dytë e veprës.

Edhe këtu titulli është shtypur pjesërisht me të zezë, pjesërisht me të kuqe, ndërsa teksti në dy kolona: majtas italisht dhe djathtas shqip.

Në fund të librit vijnë me radhë Treguesi i lëndës, të dhëna për vjetërsinë e Bogdanëve, një letër e papës për Andrea Bogdanin dhe alfabetet arab, epirot, armen, latin, grek, hebraik dhe sirian.

An II C 1-1 dhe An II C 1-2 janë përkatësisht pjesa I dhe pjesa II e veprës.

An V A 10 dhe An IV A 13 janë bashkëlidhje e të dy pjesëve në një, pavarësisht se secila me numërtim më vete.

An II C 1-1

An II C 1-2

An V A 10

An IV A 13

1691

10. Bogdani, Pjetër

- L' INFALLIBILE VERITA' / DELLA CATTOLICA FEDE, / DIMOSTRATA SINO ALL' EVIDENZA / ad ogni qualità di Persone ; / CAVATA DALL' ALTO FONTE DELLE DIVINE SCRITTURE, / PER OPERA DI MONSIGNOR / PIETRO BOGDANO / ARCIVESCOVO DI SCOPIA, / Et Amministratore di tutto il Regno di Servia, Dottor di Filosofia, / e Sacra Teologia, / IN CUI TRATTANDOSI / DELLA NULLITÀ DELLE TRE PRIMARIE SETTE / Ebrea, Maomettana, e Pagana, si stabilisce l'unità della nostra Fede sotto il Romano / Pontefice, confutandosi con l' Antiche Eresie, le Moderne di Lutero, Calvi - / no e suoi seguaci ; s'abbate lo Scisma de Greci, e si estirpa /

l'Incredulità degli Ateisti / OPERA UTILISSIMA / Ad ogni stato di persone / EBREE, MAOMETTANE, E PAGANE PER CONOSCERE / l' errore in cui vivono. Necessaria à Greci, ed à chiunque vive sotto il Giogo / Turchesco, per saper come ben vivere. Dilettevole à Cattolici per / confermarsi nella Santa Fede, / spiegata in due copiose lingue Italiana, e Schiava; adornata / con molte Figure in Rame. / ET IN DUE PARTI DIVISA. / CONSACRATA / AL Serenissimo, & Eminentissimo Principe / FRANCESCO MARIA / De Medici Cardinale di S. Chiesa. / IN VENETIA. Per Girolamo Albrizzi. M.DC.XCI. [1691] / Con Licenza de' Superiori, e Privilegio. [17] fl., 182 f.; 32 cm.

Teksti italisht dhe shqip; i njëjtë me atë të botimit të parë.

Në fletët hyrëse të panumërtuara, mes të tjerash, parathënia e botimit të parë “Të primitë përpara letterarit”.

Në pjesën e poshtme të faqes së titullit gjendet shënimi *Con Licenza de' Superiori, e Privilegio*, pjesa e dytë e të cilit tregon posedimin nga botuesi ose tipografi të licencës dhënë nga një autoritet përkatës për botimin (“bërjen publike”) të veprës.

- L' INFALLIBILE VERITA' / DELLA CATTOLICA FEDE, / DIMOSTRATA / Nella Vita di / GESV CHRISTO / E nella Dichiaratione del suo / SANTO EVANGELO / PER OPERA DI MONSIGNOR / PIETRO BOGDANO / ARCIVESCOVO DI SCOPIA, / Et Amministratore di tutto il Regno di Servia, Dottor di Filosofia, / e Sacra Teologia, / PARTE SECONDA. / In Venetia, Per Girolamo Albrizzi. M.DC.XCI. [1691] / Con Licenza de' Superiori, e Privilegio. [1] fl., 162 f. , [1] fl.

Ribot. i “Cuneus Prophetarum...”. Studiuesi arbëresh Gaetano Petrotta mendon se kjo vepër e Bogdanit ka qenë shtypur vetëm një herë në Padova më 1685 dhe se më 1691 “për arsye komerciale” me titull të ndryshuar, po ashtu me ndonjë ndryshim të lehtë në renditje të faqeve, është paraqitur si botim i ri i botuesit Albrizzi në Venedik. Madje, ai shprehet se një ribotim i kësaj vepre po nga Albrizzi në Venedik më 1702, përshkruar nga Émile Legrand në *Bibliographie albanaise*, Paris Athenes 1912, nr. 85, që nuk gjendet në koleksionet e BK, nuk është gjë tjetër veçse “një shtyp i ri i simuluar i veprës në fjalë”, pra një *fals* (*Populli, gjuha dhe letërsia shqiptare*, Tiranë 2008 - viti i botimit të veprës në italisht: 1932 - , f. 105).

An II B 8 ka në fund shënimin me laps “Maisonneuve, Paris 1921, fr. or 280 Lumo Skendo”. Shënime të tilla në mjaft libra, disa herë edhe të shoqëruara me emrin e Lumo Skendos, provojnë që albanologu dhe bibliofili i shquar shpesh ka bërë blerje në Europë për pasurimin, sidomos me literaturë albanologjike, të koleksioneve të BK.

An II B 8

An V A 18



Gravurë nga botimi: autori që lutet dhe një version i shkurtuar i titullit të librit

1706

11. **CONCIAM** / PROVINTIAALI / O / CUNVENDI / ARBENIT / Mbeliezone nde viett gnai mije / sctat cint e tre. / NDENE CLEMENTIT / I GNIMI³ZIETMI / PAPE PRETIMA³IT / ROMÆ, Typis Sac. Congregationis de Propaganda / Fide. Anno MDCCVI [1706] / SUPERIORUM PERMISSU. 115 f.; 20 cm.

Përkthim selektiv i botimit në gjuhën latine botuar po atë vit në Romë (Engjëll Sedaj, *Teksti burimor latinisht i Kuvendit të Arbnit dhe përkthimet e tij*, në *300 vjetori i Kuvendit të Arbnit*, Shkodër 2009, f. 55). Sedaj pohon se “çështja e botimeve të *Kuvendit të Arbnit* ... është një temë e gjerë” (po aty, f. 54).

Sipas J. Rrota, *Për historin e alfabetit shqyp...* f. 34 “shkrimtari qi e përpiloi” materialin e këtij botimi ka qenë Vinçenc Zmajeviçi, ndërsa “qortimet e shtypit” i ka bërë Francesco Maria da Lecce.

Sipas Vinçenc Malaj, *Kontributi i françeskanëve në letërsinë shqipe në: Letërsia si e tillë, probleme të vlerësimit të trashëgimisë sonë letrare*, Tiranë 1996, f. 175, përkthyes i botimit ishte Egidio Quinziano d'Armento.

Ka vulën “COLLEGIUM S. FRANCISCI XAVERII SCODRAE”.

An IV G 14

1731

12. **AKOLOUTHIA**/TĪS OSIAS MYROVLYTIDOS KAI THAVMATORGOU / THEODŌRAS / TĪS EN THESSALONIKĪ / Nyn prōton typōtheisa, Synerge'ia 'epimeleia kai dapānē tōn Kuriōn / Theologe ierēōs kai 'Rizou Geōrgiou, diā psychikīn autōn sōtirian. / 'Aferotheisa mēn tī perifanestātī Thessalonikī echousī 'antileptora kai prosātīn tīn rītheisan 'agian, kai di 'ákran autōn enlábeian / Diorthōtheisa dē ōs 'efikton parā tou aidesimōtātou kai logiōtātou / 'en ieromonáchois ky, ky Grīgoriou / Moschopolitou. / E'n Moschopolei. / 1731 / Parā Grīgoriō ieromonácho tō Kōnstantinou. 62 f.; 20 cm.

Riprodh.

F. 3-4 ka parathënie e Grigor Voskopjarit.

Sipas Dr. Aurel Plasarit shtypshkronja e Voskopojës ungrit, pas përpjekjesh të gjata, nga murgu Joan Kostandini më 1720. Megjithëse është quajtur “e dyta” në Perandorinë osmane mbas asaj të Stambollit, Plasari sqaron se “në të vërtetë, ajo i bie të jetë e dyta historikisht, por është e vetmja në Perandori, mbasi kur ngrihej ajo, shtypshkronja e Stambollit, e themeluar më 1627 nga Kiril Lukaris, nuk punonte” (*Fenomeni Voskopojë*, Tiranë 2000, f. 43). Deri më 1769 kjo shtypshkronjë ka realizuar mbi 50 libra (*Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, Tiranë 1985, f. 1069).

Ka shënimin me laps “Dhuruar nga M. D. Peyfuss”.

An IX F 27

1741

13. **AKOLOUTHIA** / TŌN AGIŌN / PENTEKAIDEKA IEROMARTYRŌN / Tōn 'Epi 'Ioulianoū Toū paravátou Martyrīsantōn 'en Tiverioupolei / Tī koinōs 'Epikalouménī Stroumnitzī. / NEŌSTI KAINŌ TYPŌ EKDEDOMENĪ / Dapānī mēn tīs Sevasmias Monīs Toū 'en 'Agiois Patrōs ĩmōn Naoum. / Toū Thavmatourgou. / Diorthōsei dé toū logiōtātou Kyriou Michaīl Toū Gkōras. / Kai 'afierōtheisa Par'aftoū Tō / Makaritōtatō 'Archiepiskopō Tīs / prōtīs 'Ioustinnianīs 'Achreidōn Kyriō Kyriō / 'IŌASAF. 'En Moschopolei, / 1741 / Parā Grīgoriō 'Ieromonachō tō Kōnstantinidī. 31 f.; 29 cm.

Renditur e dyta në përmbledhjen me shtatë libra botuar në Voskopojë.

F. 13 dhe 14 shtypur gabimisht 31 dhe 41.

Ky libër bën pjesë, bashkë me gjashtë të tjerë që mbajnë vitin 1742 dhe që përkruhen më poshtë, në botimin e njohur të Voskopojës ku janë përmbledhur shtatë *akoluthi* (shërbesa). Përshkrimi i këtij botimi përbën vërtet një “problem bibliografik”. Disa bibliografë e trajtojnë atë si njësi bibliografike më vete dhe e përshkruajnë si të tillë (Legrand, *Bibliographie hellenique*, tome premier, Paris 1918, nr. 286). Por bibliografë të tjerë gjejnë elemente të mjaftueshme për t'i regjistruar këto *akoluthi* si botime të veçanta, rrugë që është ndjekur edhe këtu.

An I A 20

1742

14. **KLĪMĪS** / AKOLOUTHIA / TOÛ EN AGIOIS PATROS ĪMŌN / KLĪMENTOS 'Archiepiskopou 'Achridōn / Neōsti kainō tȳpō ekdedomēnī, synlechtheisa 'ektōn syngrammātōn / toū te Dīmītriou toū chōmatinoū, kai toū Kavásila, 'Archiepiskopōn / Toū avtoū thronou chrīmatisántōn / Dapānī men tīs sevasmias monīs Toū 'en agiois Patrōs ĩmōn / Naoum toū Thavmatourgou, kai tōu typografou. / Diorthōsei dé toū logiōtātou 'en 'Ieromonáchois, Ky Grīgoriou. / Kai par'aftoū 'Aferōtheisa tō Makariōtatō 'Archiepiskopō tīs / Prōtīs 'Ioustinnianīs 'Achreidon Kyriō Kyriō 'IŌASAF. / Parā Grīgoriō 'Ieromonachō tō Kōnstantinidī 'En Moschopolei. / 1742. [2] fl., 50 f.; 29 cm.

Renditur në krye në përmbledhjen me shtatë libra botuar në Voskopojë. Studiuesi Max Demeter Peyfuss është i mendimit se ky botim mban një datë të gabuar (*Shtypshkronja e Voskopojës, 1731-1769: shtypja e librave dhe adhurimi i shenjtoreve në Patrikanën e Ohrit*, Tiranë 2002, f. 109).

Fl. tit. e dëmtuar.

An I A 20

15. **MENI** I'OUNIŌ, K'. / MNĪMĪN EPITELOUMEN / Toŭ ōsiou kai Theofōrou Patros ĩmōn. / NAOUM / TOU THAVMATORGOU TOU EN TŌ LIVANISKŌ DIAVOLEŌS Keiménou [1742].
22 f.; 29 cm.

Numërtimi fillon nga f. 51 deri në f. 70, plus [1] fl.
Renditur e pesta në përmbledhjen me shtatë libra botuar në Voskopojë.
Viti i botimit sipas: Max Demeter Peyfuss, *Die Druckerei von Moschopolis*, 1731-1769, 2., verbesserte Auflage, böhlauWien 1996, f. 126.

An I A 20

16. **MENI** I'OUNIŌ, V'. / MNĪMĪN EPITELOUMEN / Toŭ Agiou I'eromartyros / E'RASMOU / TOŪ EN TĪ A'CHRIDI [1742].
9 f.; 29 cm.

Numërtimi fillon nga f. 18 deri në f. 26 (numërtuar gabimisht 29).
Renditur e katërta në përmbledhjen me shtatë libra botuar në Voskopojë.
Viti i botimit sipas: Peyfuss, *Die Druckerei von Moschopolis...* f. 124.

An I A 20

17. **TĪ** KV'. / TOU MAIOU MĪNOS / PSALLOMEN TĪN AKOLOUTHIAN / Toŭ Agiou Iōānnou toŭ Vladimīrou / kai Thavmatourgoŭ [1742].
17 f.; 29 cm.

Numërtimi i faqeve 32-35 dhe 5-17.

Renditur e treta në përmbledhjen me shtatë libra botuar në Voskopojë.
Viti i botimit sipas: Peyfuss, *Die Druckerei von Moschopolis...* f. 122.

An I A 20

18. Voskopojari, Grigor

AKOLOUTHIA / TOŪ / A'GIOU O'SIO / MARTYROS NIKODĪMOU / TOŪ Martyrīsantos en tī Pólei Velagradōn, Kata tò / apsth E'tos. Iouliō i. / POĪĪTHEISAPARA toŭ én'Ieromonakois GRĪGORIOU/MOSCHOPOLITOU [1742].
12 f.; 29 cm.

Renditur e gjashta në përmbledhjen me shtatë libra botuar në Voskopojë.
Viti i botimit sipas: Aurel Plasari, *Një kodik i panjohur për Shën Nikodhimin e Beratit*, në rev. *Bibliothecae* 5, Tiranë 2004, f. 17.

I mungojnë dy faqet e fundit.

An I A 20

19. Voskopojari, Grigor

MĪNĪ I'OU LIŌ / AKOLOUTHIA / TŌN AGIŌN EPTARIOMŌN / Poiīthesia Para tou on I'eromonachois Grīgoriou Moschopolitou [1742].
11 f.; 29 cm.

Renditur e fundit në përmbledhjen me shtatë libra botuar në Voskopojë.
Viti i botimit sipas: Peyfuss, *Die Druckerei von Moschopolis...* f. 129.

I mungon faqja e fundit.

An I A 20

1743

19/1. **Kazazi, Gjon Nikollë**

BREVE COMPENDIO / DELLA / DOTTRINA / CRISTIANA / tradotta in lingua Albanese per / l'utilità , e iftruzione dei Fan- /ciulli di quella Nazione / Da un Nazionale del Regnio di Servia / Alunno della S. Congregazione. / In Roma , MDCCXLIII. [1743] Nella Stamperia / della S. Congr. De Propaganda Fide. / Con licenza de' Superiori.
46 f., 13 cm.

Riprodh.

Aut. në referencën e censorëve (f. 3).

An 15 D 1

1744


20. **AKOLOUTHIA** / TOÛ E'N A'GIOIS / PATROS ĪMŌN VĪSSARIŌNOS / A'rchiepiskopou Larissīs tou ThavmatourgoÛ. / Typōtheisa 'analōmasi mèn Tou paneirōtatou, Kai Theoprovlitou Mītro / politou Larissīs Kyriou Kyriou I'AKŌVOU / kai tou Panosiōtatou Īgouménou tou Ī'rou Monastīriou Dousikou Kyriou / I' erotheu. / 'Epimeleia dé kai 'epidiorthōsei tou Logiōtatou 'en 'Ieromonachois Kyriou Grīgoriou Moschopolitou. / E'n Moschopolei / 1744.

II , 28 f.; 29 cm.

Fl. panum. para teksti hyrje.

An II C 18 ka shënimin “Pronje i Manastirit “Shën-Pjetër” Vithkuqit (Korçe) Dhuruare në “Biblioteken Kombetare” prej: Perkujdestarit Manastirit Vangjel Turtulli Korçe 20-4-937”.

An XI A 7 riprodh.; ka numërtim të pasaktë faqesh (32).



Fl. tit. me autografin e kujdestarit të manastirit të Shën Pjetrit, Vithkuq

An II C 18

An III B 8

An XI A 7

An XI A 10

An XI C 25

1750

21. **[Kavaljoti, Theodor]**

OKTŌĪCHOS / NEOSTI. / Metatypotheisa kai diorthōtheisa Parà K. Theodōrou Anastasiou tou ek Moschopoleos. / En tīs Typografio touŌ OsioÛ kai Theōfarou Patros ĩmōn Naoum touŌ ThavmatourgoÛ. Tō en tō Divanites ... pōleos keimenou. / En Moschopolei, [1750].

7 f.; 17 cm.

Riprodh.

Aut. sipas: Peyfuss, *Die Druckerei von Moschopolis...* f. 131.Viti i botimit sipas: *Albanica I*, Biblioteka Kombëtare, Tiranë 1998, f. 379.

Ka shënimin me laps “Dhuruar nga M. D. Peyfuss”.

An IX D 31

1760

22. **Kavaljoti, Theodor**

EISAGŌGĪ GRAMATIKĪS. / Para touŌ Aidesimōtatou kai Ellogimōtatou Didaskalou tes en Moshopolei neōsti idrytheisīs A'kademias kai Megalou Prōtopapa, kai 'Ierokīrykos touŌ Agiōtatou Thrōnou tīs Prōtīs I'oustinianīs A'chreidōn kai tīs Theosōstatou Politeias Moschopōleōs kyriou Theōdrou Anastasiou Kavalliōtou Moschopolitou, synarmotheisa eis efchēreian tōn Prōtopeirōn. / Nyn prōton typois ekdotheisa dapānī touŌ entimōtātu, kai chrīsimōtātu Kyriou 'Antōniou chatzī Geōrgiou BoÛe efpatridou Moschopoleōs. / En tī Typografia touŌ ōsiou, kai Theofōrou Patros ĩmon NaoÛm touŌ ThavmatourgoÛ. / En Moschopolei 1760.

[5] fl., 142 f.; 15 cm.

Konsiderohet i fundit botim i realizuar në Voskopojë (Peyfuss, *Shtypshkronja e Voskopojës...* f. 142).

Fl. tit. e riprodh.

An I T 7

1762

23. Variboba, Jul

GHIELLA / E / S. M▼RIIS // VIRGHI▼R / Scruar mbo viers Arbërist caa gnë Prift puru i / Arbëres për ndeert asaj Regin e për spass / të atire divotrave, cia së duan të chën / doghën chënc' namurije; ma duan / të ðeen chënc' Spirituaal. mbë / trij manerës: mbë Calimeer, / mbë canghiell' e mbëgn' / atër fort chbdimmi Lë - / tist; VIRGINE BELLA. / ROMM' MDCCLXII. [1762] / ME LECENZ T▼ P. MAISTRIT / Scitten Mbussat caa Noffi. [36] fl.; 16 cm.

Riprodh.

Emri i autorit në *Imprimatur* f. 7.

F. 3-4 dhe 5-6 parathënie dhe kushtim lexuesit të shkruara nga autori.

Në pjesën e poshtme të faqes së titullit është shtypur shënimi ME LECENZ T▼ P. MAISTRIT (pra, në shqip) që tregon lejen për botim dhënë nga një autoritet kishtar (Padre Maestro del Sagro Palazzo Apostolico). Shih: Giulio Variboba *Vita della Beata Vergine Maria*, Edizione critica e traduzione italiana a cura di Vincenzo Belmonte, Rubbettino Editore 2005.

Ka anëshkrime gati të palexueshme, të cilat tregojnë se ekzemplari i riprodhuar “ka qenë i Francesco Macrisë, pastaj i Giovanni Baffas, i cili ia dha Demetrio Camardas” (Shuteriqi, *Tekstet shqipe...* f. 287).

An V C 4

1802

24. Adam Haxhi (Voskopojari), Dhanil

EISAGŌGIKI DIDASKALIA / Periéchousa Lexikòn Tetráglōsson tōn tessárōn koi / nōn Dieléktōn itoi tīs aplīs Romaikīs, tīs én MoisiaVlachikīs, tīs Voulgarikīs kai tīs 'Alvanitikīs. Syntetheisa mèn èn archī charin evmatheias tōn Filologōn al / loglōssōn neōn parà toū Aidesimōtatos, kai Logiōtatos Di / daskalou, Oikonomoū, kai 'Ierokīrykos Kyriou Daniīl tou ek Moschopoleōs. Kallyntheisa dè eptafxintheisa tī pro / sthīkī tineōn chreiōdōn kai preiergeias axiōn, kai evla / vōs afierōtheisa tō Panierōtātō, kai Logiōtātō / Mītrōpolitī Pelagōnneias, Ypertimō, kai E / xarchō pásīs Voulgarakīs Makedonias Kyriou / KYRIOU NEKTARIOŌ / TŌ EK MOUNTANIŌN / Oū kai tois aneilōmasi typis ekdédotou di òfēleian / tōn Eparchiōtōn avtoū. En étei Sōtīriō [Venedik] aōv', 1802.

[4] fl., 92 f.; 25 cm.

Fl. 1^o titulli i riprodhuar më sipër.

Fl. 1^o dy vjersha në greqisht.

Fl. 2^o & v^o kushtesë Nektarinit, metropolit i Pelagonisë.

Fl. 3^o & v^o vjershë në greqisht.

Fl. 4^o vargje lavdëruese për metropolitin Nektarin.

Fl. 4^o v^o ka një shënim gjithnjë në greqisht.

F 1-36 ka një fjalorth a libër bisedimesh me 1070 fjalë dhe 235 fraza nga jeta e përditshme në greqisht, vllahisht, bullgarisht dhe shqip,- të gjitha me shkronja greqisht-, organizuar në katër kolona.

F. 37-91 përmbajnë një doktrinë të krishterë të shkurtër, njohuri në fizikë dhe matematikë etj. në greqisht.

F. 92 ka një listë me ndreqje gabimesh.

(Përshkrimi kryesisht sipas Legrand, *Bibliographie albanaise*, nr. 121, por edhe Kastrati, *Historia e albanologjisë*, vëll. 1, f. 486-489).

Vendi i botimit sipas: Domi, *Historia e Letërsisë Shqipe*, vëll. I, 1959, f. 312.

Në Venedik ishte botuar më 1770 edhe *Protopeiria* e Th. Kavaliotit. Pas rrënimit të Voskopojës më 1760, autorët voskopojarë u detyruan t'i botojnë në Perëndim veprat e tyre të këtij karakteri: fjalorë në të cilët krahas greqishtes vendoseshin gjuhët popullore të vllahëve, shqiptarëve etj. Lind pyetja: Pse në Venedik dhe jo në Greqi? Ngaqë Kisha greke e konsideronte gjuhën e saj të shenjtë, ndërsa gjuhët e tjera në rajon “vulgare” dhe kësisoj nuk toleronte botime të tilla? Po atëherë, si

shpjegohet që në Venedik dërgoheshin për t'u botuar edhe libra të kishës (shërbesa) në greqisht si disa akoluthi, ekzemplarë të të cilëve gjenden edhe në koleksionet e BK (*Akolouthia tou agiou o' siomartyros Nikodemou tou Néou...* Venecia 1781, ribotim i botimit të Voskopojës të vitit 1742; *Akolouthia tou agiou endoxou vasileos kai megalomartyros Iōannou tou Vladimirou...* Venecia 1858, ribotim i botimit të Voskopojës të vitit 1774)?

Shënojmë gjithashtu që Peyfuss përmend një letër të 13 prillit 1793, botuar më 1925 nga studiuesi bullgar I. Snegarov, në të cilën Dhanili kërkon t'i sjellin sa më parë pjesën bullgarisht, sepse do ta dërgonte dorëshkrimin për shtyp në Venedik-është fjala për një fantomë, botimin e parë të supozuar të këtij libri më 1794 (*Shtypshkronja e Voskopojës...* f. 59).

Al 5 B 41 riprodh. i litografuar në letër speciale joacide dhe të qëndrueshme.

Al 5 B 42-43 riprodh. të fotokopjuara të Al 5 B 41.

Të tre ekzemplarëve u mungojnë fl. 3 r^o, f. 5-36, 55-60, 73-83, 85, 89 dhe 91.

Në faqen e fundit ka dy vula:

“Kaiserliche Koenigliche Hofbibliothek” dhe “K. K. HOF BIBLIOTHEK WIEN”.



Al 5 B 41

Al 5 B 42

Al 5 B 43

1824

25. **TO KATA MATTHAION / EVANGELION / TOU KYRIOU KAI SŌTĪROS ĪMŌN / ĪĪSOU CHRISTOU, / DIGLŌTON / APDO-ELLĪNIKON KAI ALVANĪTIKON. = OUNGILLI / I ĪĪSOU CHRISSTOIT / ZOTIT SĒNĒ KIĒ NA SSPĒTOI / SI KONTRĒ SSKROUAN SSĒNT MATTHAIUUA / MPĒ DDI NGIOUHĒ / GKĒRKISSTĒ EDE SSKIPĒ / KORFOI / EN TĪ TYPOGRAFIA TĪS DIOIKĪSEŌS / 1824.**

[2], 188 f.; 17 cm.

Fl. tit. dhe teksti greqisht dhe shqip me alfabet grek.

Përkthyes i këtij ungjilli, botim i Shoqërisë Biblike të Londrës, është Vangjel Meksi, ndërsa redaktor Grigor Gjirokastriti (Shuteriqi, *Shkrimet shqipe...* nr. 260). Me të nisin botimet në shqipe të BFBS (British and Foreign Bible Society), një komitet protestant i ngritur më 1804 me moton: Bibla për gjithë botën, i njohur ndryshe edhe si Shoqëria Biblike e Londrës. Botimi u realizua nën kujdesin e Shoqërisë Biblike Joniane në Korfuz (Lloshi, *Vangjel Meksi, përkthyes i parë i suksesshëm i Dhjatës së Re shqip*, në: *Vangjel Meksi. Përkthyesi i parë i Dhiatës së Re*. Materialet e sesionit shkencor mbajtur pranë Akademisë së Shkencave, dhjetor 1999, Tiranë 2000, f. 18). Për herë të parë në gjuhën shqipe botohej një Ungjill i plotë (po ai, po aty, f. 28).

88 R 133 ka vulën “BIBLËJOTEKA KOMBETARE TIRANE”

88 R 133

87 S 18

1827

26. **Ī KAINĪ / DIATHĪKĪ / Tou Kyriou kai Sŏtĭros ĩmŏn / ĪĪSOU CHRISTOU / DIGLŌTTOS, / TOUTESTI / GRAIKIKĪ kai ALVANĪTIKĪ = DGIATA / E RE / E Zotit sonë kë na shpĕtoi / ĪĪSOU CHRISTOIT / MPĒ DI GIOUHĒ, / dó mē thĕnĕ / GERKISHTE, èdè SHKIPĒTARTZE / MEROS PRŌTON, / Periechon tous Evangelistas kai tās Praxeis / tŏn Apostŏlon. / KORFOI / EN TĪ TYPOGRAFIA TĪS DIOIKĪSEŌS / 1827.**

486 f.; 22 cm.

Pjesa I.

Studiuesi Xh. Lloshi ve në dukje se para se të lidheshin fashikujt e shtypur, Isaac Lowndes, sekretar i Shoqërisë Biblike Joniane, i shkruante Londrës: “Kryepeshkopi (Grigor Gjirokastriti-R. V.) ka thënë disa herë që do të ishte mirë që Dhiata të ndahej në dy vëllime... meqë shqiptarët e kanë zakon t'i mbajnë librat me vete në gji” (*Vangjel Meksi, përkthyes i parë...* f. 32), sugjerim që, siç shihet, është pranuar.

Fl. tit. dhe teksti greqisht dhe shqip me alfabet grek.

Përkthyes i këtij botimi të Shoqërisë Biblike të Londrës është Vangjel Meksi, ndërsa redaktor Grigor Gjirokastriti (Shuteriqi, *Shkrimet shqipe...*

nr. 260). Përkthimi i Meksit u bë nga versioni i vjetër në greqishten e re përkthyer nga Maximus Galipoli dhe botuar për herë të parë në Gjenevë më 1638 (po ai, po aty f. 37).

Botim shumë i rrallë. Xh. Lloshi sjell një “fakt kureshtar” lidhur me përkthimin e këtij botimi shqip, sipas të cilit një misionar i Shoqërisë Biblike sinjalizon nga Manastiri më 1875 Komitetin në Londër se ai ishte i mbushur me kllapa, që kushedi se ç’përmbajnë. Studiuesi sqaron që “Meksi e Gjirokastriti, ashtu si më pas Kristoforidhi, i kanë shtuar disa fjalë, ose për të ruajtur ndërtimin e fjalive sipas ndërtimit të shqipes ose për t’u mos u keqinterpretuar teksti. Me terminologjinë e sotme, - vijon ai, - disa raste të tilla janë *përkthim brenda gjuhës*”. Por kjo bëri që qarkullimi i librit të ndalohej nga Komiteti, i cili vendosi të fshiheshin në kopjet ende të pasitura fjalët për të cilat kishte vërejtje (po aty, në po atë faqe).

Ka shënime të shkruara në greqisht. Ka të shkruar emrin *Pano Lito* dhe nënshkrimin e tij.

90 A 216

27. **Ī KAINĪ** / DIATHĪKĪ / Tou Kyriou kai Sofiros ĩmōn / ĪĪSOU CHRISTOU / DIGLŌTTOS, / TOUTESTI / GRAIKIKĪ kai ALVANĪTIKĪ = DGIATA / E RE / E Zotit sonë kë na shpëtoi / ĪĪSOU CHRISTOIT / MPĒ DI GIOUHĒ, / dó mè thēnē / GERKISHTĒ, èdè SHKIPĒTARTZE / MEROS DEFTERON. / Periechon tas Epistolàs / kai tĭn Apokalypsin. / 1827. f. 487- 839; 22 cm.

Pjesa II.

Titulli dhe teksti greqisht dhe shqip me alfabet grek.

Përkthyes i këtij botimi të Shoqërisë Biblike të Londrës është Vangjel Meksi, ndërsa redaktor Grigor Gjirokastriti (*Shkrimet shqipe...* nr. 260).

Ka shënimin “Për kuitim: sot u-bê vlesa-fejesa - ime me të bijën e Thanas Kabilit Parthenopi. 10 shkurt - e Diellë 1918 28 - Janar - alla Greca. Thoma P. Pano. U ndodhë: përveç motravet të babait dhe motravet e vëllait të nënës me gjithë fëmijë edhe Pilo Njockua, Çome Karecua e Vangjel Koçi e Gole Kabili. Qemo Panopriifti Ginokastre”. Ka edhe shënime të tjera në greqisht.

Ar 123 B 4

28. **Ī KAINĪ** / DIATHĪKĪ / Tou Kyriou kai Sōtīros ĩmōn / ĪĪSOU CHRISTOU / DIGLŌTTOS, / TOUTESTI / GRAIKIKĪ kai ALVANĪTIKĪ = DGIATA / E RE / E Zotit sonë kë na shpëtoi / ĪĪSOU CHRISTOIT / MPĒ DI GIOUHĒ, / dó mè thēnē / GERKISHTĒ, èdè SHKIPĒTARTZE / EPISTASIA / GRĪGORIOU / Archiepiskopou tīs Evvoias. / KORFOI / EN TĪ TYPOGRAFIA TĪS DIOIKĪSEŌS / 1827. 839 f.; 22 cm., [tirazhi 2000].

